

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEMA
APLIKIMI DHE ZBATIMI I SANKSIONEVE PENALE NDAJ TË MITURVE
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË
PERIUDHËN E VITEVE 2009-2018

Kandidati
THERANDA SELIMI

Mentor
PROF. DR. BESA ARIFI

Tetovë, Prill 2020

Deklaratë e kandidatit

“Vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi.”

Deklaroi

Theranda Selimi

Rezyme

Delikuenca e të miturve, si pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm, paraqet sjellje negative dhe të papranueshme të personave të mitur, e cila shprehet nëpërmjet veprimeve konkrete të cilat i tejkalojnë standardet shoqërore, vlerat dhe normat e sjelljes, si dhe cenojnë dispozitat penalo-juridike. Analiza e kësaj problematike imponon më shumë lloje dhe qasje të organizimit kundër këtij lloj kriminaliteti, nga të cilat si më kyçe theksohen: interesi më i mirë i fëmijës dhe respektimi i të drejtave të tij, pluraliteti i masave dhe sanksioneve të parapara të cilat mund t`ju shqiptohen fëmijëve, partneriteti midis shërbimeve sociale dhe institucioneve për zbatimin e sanksioneve penale ndaj fëmijëve, rritja e cilësisë së punës me fëmijët d.t.th mbrojtja nga recidivizmi. Në kuadër të këtyre qasjeve të identifikuara, vëmendje e veçantë në këtë punim do t`i kushtohet masave institucionale, konceptit dhe standardeve të shërbimeve sociale, metodave për mbrojtjen e delikuentëve të mitur, mënyrat e evaluimit dhe rritjes së cilësisë etj.

Fjalët kyçe: delikuenca e të miturve, sanksionet penale, riedukimi, risocializimi, familja, institucione

Përmbajtja

Hyrje

I . Formulimi i problemit dhe qasja metodologjike

1. Lënda e hulumtimit
2. Hipotezat
3. Metodatat e hulumtimit
4. Qëllimet e hulumtimit

II. Nocioni, faktorët për shfaqjen dhe karakteristikat fenomenologjike të delikuencës së të miturve

1. Nocioni i delikuencës së të miturve
2. Në veçanti për faktorët për shfaqjen e delikuencës së të miturve
 - 2.1. Faktorët biologjik-sociologjik
 - 2.2. Faktorët psikologjik
3. Vëllimi, dinamika dhe karakteristikat fenomenologjike të delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën e viteve 2009-2018

III. Zhvillimi i trajtimit juridiko penal ndaj të miturve

IV. “Ombrella” e standardeve ndërkombëtare dhe regjionale

1. Dokumentet e Kombeve të Bashkuara
 - 1.1. Konventa për të drejtat e fëmijëve e Kombeve të Bashkuara e vitit 1989
 - 1.2. Udhëzimet e OKB-së për parandalimin e delikuencës së të miturve-Direktivat e Riadit
 - 1.3. Rregullat minimale standarde të OKB për të drejtat e të miturit- Rregullat e Pekinit
 - 1.4. Rregullat e OKB-së për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria-Rregullat e Havanës
 - 1.5. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për masat alternative të dënimit me burgim të vitit 1990-Rregullat e Tokios
2. Rekomandimet e Këshillit të Europës
3. Dokumentet tjera ndërkombëtare dhe regjionale të rëndësishme për drejtësinë e fëmijëve

V. Pozita juridike e delikuentëve të mitur ne legjislacionin vendas

VI. Sistemi i sanksioneve penale dhe ekzekutimi i sanksioneve ndaj fëmijëve kryes të veprave penale

1. Masat edukuese
 - 1.1. Masat disiplinore
 - 1.1.1. Qortimi
 - 1.1.2. Dërgim në qendër
 - 1.2. Masat e mbikëqyrjes së përforcuar
 - 1.2.1. Masat e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes
 - 1.2.2. Masat e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes përkujdesëse
 - 1.2.3. Masat e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e qendrës
 - 1.3. Masat e enteve
 - 1.3.1. Dërgim në institucion edukativ-përmirësues
 - 1.3.2. Dërgim në shtëpi edukative-përmirësuese
 - 1.3.3. Ndërprerja e zbatimit, ndryshimi dhe vendimmarrja e sërishme lidhur me masat edukuese
2. Dënimet ndaj fëmijëve
 - 2.1. Burgu për fëmijë
 - 2.2. Dënimi me para
 - 2.3. Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik
 - 2.4. Dëbimi i të huajit nga vendit
3. Masat alternative
 - 3.1. Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse
 - 3.2. Ndërprerja me kusht e procedurës
 - 3.3. Puna në dobi të përgjithshme
4. Masat e sigurisë
 - 4.1. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor
 - 4.2. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri
 - 4.3. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolikëve dhe narkomanëve

VII. Praktikrat e institucioneve kompetente për ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj fëmijëve

Konstatime përmbyllëse

Rekomandime

Bibliografia

Hyrje

Ekzistojnë më shumë determinanta shoqërore të cilat pozitën e të miturve në shoqëri e përcaktojnë në mënyrë të veçantë. Në botën bashkëkohore, në të cilën karakteristikë kryesore e jetës është dinamika në ndodhitë e përditshme, këta determinanta fitojnë rëndësi të veçantë kur hulumtohet ndikimi i tyre ndaj gjeneratës së re, pozitën e saj në shoqëri dhe kushtet për zhvillimin e saj.

Determinanta e parë të miturit i përcakton si shtresë të veçantë shoqërore e cila në të gjitha segmentet e trajtimit të saj (krijimin e kushteve për zhvillim, edukim dhe socializim) zë një pozitë të veçantë në shoqëri dhe kërkon angazhim të veçantë nga ana e shoqërisë dhe institucioneve. Determinanta e dytë ka të bëjë me faktin e pamohueshëm se mungesa e angazhimit të shoqërisë ndaj fëmijëve ndikon në përfshirjen e tyre në kriminalitetin e të miturve. Dhe, determinanta e tretë është e ndërlidhur me vetë nocionin e rinisë. Nocioni i rinisë si në raportet juridike ashtu edhe në ata shoqërore, identifikohet me nocionin papjekuri, persona në zhvillim për nga aspekti biologjik, psikologjik dhe intelektual të cilët nuk e ka arritur shkallën e zhvillimit e cila i bën të aftë të mbajnë përgjegjësi dhe vetë t'i zgjidhin problemet.

Duke u nisur nga karakteristikat biologjike, psikologjike dhe sociologjike të fëmijëve mund të vijmë në përfundim se këta persona posedojnë dallime dhe specifika nga personat e rritur. Shikuar nga aspekti biologjik, këta persona nuk e kanë arritur zhvillimin e plotë biologjik dhe pjekurinë biologjike. Ata janë në fazë të disa ndryshimeve kyçe në organizëm, të cilat manifestohen me reagime të numërta në natyrën e tyre të brendshme, e jo rrallë dhe në botën e jashtme. Shikuar nga aspekti psikologjik fëmijët nuk janë në gjendje ta kuptojnë peshën e veprave të tyre, e as të gjykojnë për to. Puberteti si fazë bio-psikologjike kontribuon në mosdëgjueshmëri tek fëmijët e mitur, dëshirë për mëvetësi, vetëbesim dhe faktorë tjerë të cilët shpesh janë edhe vendimtare për sjelljen delikuyente të fëmijëve. Nga aspekti sociologjik, këta persona edhe krahas dëshirës të involvohen në jetën shoqërore si qytetarë të barabartë, ata nuk posedojnë pavarësi, ata moralisht dhe materialisht janë të lidhur me prindërit ose kujdestarët.

Andaj në dokumentet ndërkombëtare, veçanërisht në Konventën për të drejtat e fëmijëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, insistohej në obligime të posaçme të shteteve dhe shoqërisë për ndihmë, kujdes, mbrojtje, edukim dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e lirë të tyre.

Në literaturën bashkëkohore nga fusha e drejtësisë, sociologjisë, pedagogjisë, psikologjisë dhe punës sociale delikuenca e të miturve zë hapësirë gjithnjë më të madhe. Duke e pasur parasysh ndërlikueshmërinë e fenomenit të delikuencës së të miturve si dukuri shoqërore negative dhe implikimet e saja negative në fushën e kriminalitetit, Republika e Maqedonisë së Veriut në mënyrë vazhdueshme po ndërmerri masa për ristrukturimin dhe organizimin e shërbimeve në funksion të rritjes së efikasitetit në luftimin dhe pengimin e kriminalitetit tek të rinjtë. Në bazë të këtyre specifikave në teorinë juridiko-penale, gjegjësisht në legjislacionin penal, kësaj kategorie të personave ju jepet trajtim i veçantë në procedurë dhe masat juridiko-penale dhe masat e risocializimit

Njohja e vëllimit, por edhe të karakteristikave tjera fenomenologjike të këtij lloji të kriminalitetit paraqitet si parakusht për ndërmarrjen e masave për preventivë dhe risocializim. Qëllimi për të cilin shqiptohen dhe zbatohen masat/sanksionet ndaj fëmijëve është që nëpërmjet ndihmës dhe mbrojtjes, aftësimin dhe zhvillimit të përgjegjësisë personale të arrihet edukimi, riedukimi dhe zhvillimi i tyre.

KAPITULLI I

Formulimi i problemit dhe qasja metodologjike

1. Lënda e hulumtimit

Lëndë e këtij punimi do të jetë hulumtimi në cilin drejtim zhvillohet progresi i mbrojtjes (edukimi, riedukimi dhe zhvillimi i drejtë) i fëmijëve të cilët janë të përfshirë në veprime të cilat me Kodin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të parapara si vepra penale.

Në veçanti lëndë hulumtimi në këtë punim do të jetë:

-vëllimi dhe dinamika e kriminalitetit, si dhe grupimi në bazë të llojit të veprave penale të kryera, grupmoshës, shkallës së arsimimit dhe gjinisë së kryesve në intervalin kohor dhjetëvjeçar 2009-2018;

-analiza e strukturës së sanksioneve penale të cilat u janë shqiptuar fëmijëve në bazë të Ligjit për të drejtën e të miturve dhe Ligjit për drejtësi për fëmijë në periudhën e viteve 2009-2018;

-kushtet e zbatimit të sanksioneve të shqiptuara ndaj në pajtim me Ligjin për zbatimin e sanksioneve dhe standardet ndërkombëtare;

Mënyra e zbatimit të sanksioneve penale ndaj fëmijëve do të analizohet përmes raporteve të organeve kompetente të cilat veprojnë në fushën e mbrojtjes, ndihmës dhe përkrahjes së fëmijëve dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve të cilët gjenden nëpër institucione për të konstatuar nëse dënimi, gjegjësisht masa edukuese e shqiptuar e realizon qëllimin e saj, dhe nëse shteti ka aftësi të përballet me problemin e delikuencës së të miturve.

Hulumtimi territorial do të përfshijë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të dhënat do të merren nga Enti shtetëror për statistikë për të gjitha gjykatat e shtetit.

2. Hipotezat

-Hipoteza e përgjithshme:

Sistemi efikas i drejtësisë për fëmijë varet nga implementimi i plotë i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale

-Hipoteza të veçanta:

Hipotezat e veçanta kanë të bëjnë me supozimet e ekzistimit të mangësive të caktuara, gjegjësisht:

-gjykatësit gjatë shqiptimit të sanksioneve nuk e shfrytëzojnë sistemin e plotë të masave dhe sanksioneve ndaj fëmijëve të cilat ua ofron Ligji për drejtësi për fëmijë

-kushtet e funksionimit në institucionet ku zbatohen sanksionet penale ndaj fëmijëve ndikojnë ndaj procesit të risocializimit, ndaj gjendjes së tyre psiko-sociale dhe kontribuon për paraqitjen e recidivizmit

-kuadri i punësuar në institucionet për zbatimin e sanksioneve penale ndaj të miturve është jo adekuat

-mjetet financiare dhe resurset për zbatimin e Ligjit për drejtësi për fëmijë janë të pamjaftueshme

3. Metodatat e hulumtimit

Gjatë hulumtimit do të përdoren metodatat në vijim: krahasuese, historike, statistikore, analiza dhe sinteza e përmbajtjes.

Nëpërmjet metodës hulumtuese historike do të analizohet zhvillimi i trajtimit juridiko-penal të të miturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nëpërmjet metodës hulumtuese statistikore do të analizohet vëllimi, dinamika, struktura e kriminalitetit tek fëmijët dhe struktura e sanksioneve penale të shqiptuara.

Metodën hulumtuese krahasimore do ta shfrytëzojmë gjatë analizës së Ligjit për të drejtën e të miturve të viti 2007 dhe Ligjit për drejtësi për fëmijë të vitit 2013, si dhe krahasimit të dokumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me drejtësinë për fëmijë dhe zgjidhjet ligjore të Ligjit për drejtësi për fëmijë.

Theks i veçantë i kushtohet zbatimit të sanksioneve penale ndaj fëmijëve në aspekt të analizës së respektimit të kornizës ligjore, trajtimit të fëmijëve nëpër institucioneve, kushteve në të cilat zbatohen sanksionet ndaj fëmijëve.

4. Qëllimi shkencor

Qëllimi shkencor i këtij hulumtimi përbëhet në krijimin e një pasqyre më të gjerë dhe më të thellë për gjendjen e delikuencës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2009-2018, gjegjësisht njoftimin me karakteristikat e këtij fenomeni. Periudha kohore e përcaktuar në këtë mënyrë mundëson hapësirë të mjaftueshme të perceptohen karakteristikat e kriminalitetit tek fëmijët, si në aspekt të ndryshimit të ligjit, ashtu edhe në aspekt të ndikimit të lëvizjeve të përgjithshme shoqërore-ekonomike dhe politike, proceset dhe ndryshimet në shoqërinë tonë.

KAPITULLI II

Nocioni, faktorët për shfaqjen dhe karakteristikat fenomenologjike të delikuencës së të miturve

1. Nocioni i delikuencës së të miturve

Shikuar historikisht kriminaliteti si formë e mosrespektimit të normave sociale, e ndjek shoqërinë që nga fillimet e saja. Ai e rrezikon jetën dhe trupin, integritetin, liritë dhe të drejtat e njeriut, sigurinë e tij jetësore, shkakton dëme materiale të cilat e pengojnë zhvillimin e shoqërisë. Kriminalitetin e karakterizojnë dy veçori dhe atë: individualiteti i saj (vepra penale dhe kryesi i saj), si dhe shuma e dukurive individuale të tilla në hapësirë të caktuar në kohë të caktuar me të cilën karakterizohet masoviteti i saj¹.

Kriminaliteti përfaqëson dukuri shoqërore e cila e përfshin shumën e përgjithshme të veprave penale në një kohë dhe vend të caktuar. Me nocionin kriminalitet nënkuptohen të gjitha aktivitetet të cilat i rrezikojnë dhe cenojnë pasurinë, vlerat, raportet dhe interesat e personalitetit dhe shoqërisë, e të cilat në dispozitat juridiko-penale të një vendi konsiderohen si vepra penale për një periudhë kohore të caktuar. Ajo i rrezikon vlerat themelore në një shoqëri dhe kjo veçori quhet rrezik shoqëror.

Delikuenca e të miturve, si pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm, paraqet sjellje negative dhe të papranueshme të personave të mitur, e cila shprehet nëpërmjet veprimeve konkrete të cilat i tejkalojnë standardet shoqërore, vlerat dhe normat e sjelljes. Me delikuencë të të miturve nënkuptojmë sjelljet antishoqërore dhe antiligjore të personave të moshës së mitur². Delikuenca e të miturve është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim të hollësishëm shkencor. Ajo gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin jetojnë të miturit

Në teori ekzistojnë tre grupe të kuptimit të nocionit delikuencë e të miturve. Sipas grupit të parë delikuenca e të miturve paraqet: sjelljen e të rinjve e cila për pasojë ka shkeljen e

¹ Nikolić-Ristanović, Vesna; Konstantinović- Vilić Slobodanka, Kriminologija, Beograd, 2018, fq. 23-24

² Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq.224

normave të legjislacionit penal. Definimi i këtillë ka mangësi serioze në aspekt të faktit se nuk bën dallim midis kriminalitetit të të rriturve dhe fëmijëve³. Grupi i dytë delikuencën e të miturve e përcakton në kuptim më të gjerë, duke e definuar si: vepra penale të kryera nga ana e fëmijëve si dhe të gjithë ata sjellje të personave të mitur të cilat janë në kundërshtim me rregullat juridike të një shteti të caktuar. Dhe grupin e tretë e përbëjnë mendimet sociologjike-kriminologjike sipas të cilëve: delikuenca e të miturve, krahas shkeljes së normave juridike, e përfshin edhe atë sjellje të fëmijëve të cilën rrethi shoqëror-kulturor e konsideron si të papranueshme.

Një nga definicionet që ka gjetur zbatim më të gjerë në teori është definicioni i autorit Jashoviq sipas të cilit: me nocionin delikuencë e të miturve nënkuptojmë ajo sjellje të shkeljes e një individi, një grupi të të rinjve e cila është kundërshoqërore, gjegjësisht sjellje shoqërore e papranueshme me të cilat shken normat juridike dhe morale në një shoqëri të caktuar dhe të cilat, kur ajo është shoqërisht e dukshme, shkakton reagim shoqëror spontan dhe të organizuar me qëllim që të mbrohen vlerat dhe të mirat shoqërore, si dhe vetë kryesit e një veprë të tillë⁴.

Delikuenca tek të rinjtë zakonisht ka një fazë paraprake që fillon me sjellje asociale nga mosha e pubertetit 11-13 vjeçare. Sjelljet asociale të fëmijëve në këtë moshë mund të jenë të llojllojshme, si p.sh ikje nga shtëpia, ikje nga orët e mësimit, kryeneçësi, fyerje dhe sharje, mosbindje dhe mosdurim, rrahje, vjedhje, etj. Në qoftë se në këtë moshë nuk merren masa të duhura për mënjanimin e tyre, ato dalëngadalë rriten dhe bëhen potencial optimal për delikuencë të vërtetë.

Duke u nisur nga aspekti i politikës kriminale, nocioni i delikuencës së të miturve duhet të definohet në mënyrë të qartë dhe precize. Preciziteti është e një rëndësie të veçantë gjatë përcaktimit të masave të politikës kriminale, e deri diku edhe të risocializimit, andaj ajo duhet të jetë e privuar nga çfarëdo lloj difuziteti dhe relativiteti⁵.

Siç përmendëm më lartë i mituri është person i një kategorie të veçantë të moshës dhe me cilësi të veçanta bio-psiqike, e cila nga të rriturit dallohet për nga shkalla e pjekurisë

³ Арнаудовски, Љупчо, Криминологија, Штип, 2007 fq.87.

⁴ Нанев, Лазар, Кошевалиска, Олга, Малолетничко казнено право, Штип, 2018, fq. 12

⁵ Сулејманов, Зоран, Македонска криминологија, Скопје, 2000, fq. 589

emocionale dhe intelektuale. Kufiri i poshtëm në të drejtën penale paraqet një “hyrje” në zonën e kriminalitetit. Me kufirin e poshtëm të përgjegjësisë penale nënkuptojmë numër të caktuar të viteve të jetës të domosdoshme që në person të mund të konsiderohet i aftë për të qenë subjekt i së drejtës penale dhe kundër tij të mund të iniciohet procedura penale. Vendosja e kësaj rregulle ka kuptim më të gjerë, në kuptim që kufiri mbi të cilin i mituri hyn në zonën penale duhet të jetë e afërt me kufirin kur ai bëhet subjekt i të drejtave dhe obligimeve tjera (aftësia për të lidhur martesë, aftësia për të lidhur marrëdhënie pune etj.). Shtete të ndryshme në legjislacionet e veta kanë paraparë moshë të ndryshme të përgjegjësisë penale tek të miturit. Kështu Austria ka paraparë moshën 14 vjeçare, Belgjika moshën 16 vjeçare (vetëm për vepra penale në trafik dhe vepra të rënda penale, Bullgaria moshën 14 vjeçare, Kroacia moshën 14 vjeçare, ndërsa nga moshë 16 vjeçare mund të shqiptohet edhe masa e burgut, Danimarka moshën 15 vjeçare, Spanja moshën 14 vjeçare, Turqia moshën 12 vjeçare, Suedia moshën 15 vjeçare (vetëm për vepra të rënda penale), Qiproja moshën 10 vjeçare, ndërsa nga moshë 14 vjeçare mund të shqiptohet edhe masa e burgut, Kroacia moshën 14 vjeçare, ndërsa nga moshë 16 vjeçare mund të shqiptohet edhe masa e burgut, Rusia moshën 16 vjeçare, ndërsa për vepra penale të rënda moshën 14 vjeçare. Nga të dhënat e theksuara më lartë mund të konstatojmë se në praktikën ligjvënëse të shteteve të ndryshme ka qasje të ndryshme për klasifikimin e shkelësve të ligjit, por zakonisht bëhet dallimi midis fëmijëve të moshës nga 14 deri 16 vjet dhe fëmijëve nga moshë 16 deri 18 vjet. Kjo ndarje bazohet në zhvillimin anatomik dhe psikik, gjegjësisht pjekurisë mentale të strukturave të caktuara të popullatës së të miturve, gjegjësisht bazën reale për përputhshmërinë e mundshme të raportit të tyre ndaj miratimit dhe respektimit të normave juridike, morale dhe shoqërore.

2. Në veçanti për faktorët për shfaqjen e delikuencës së të miturve

2.1. Faktorët biologjik-psikologjik

Delikuentët e mitur dallohen nga të rriturit për nga shkalla e zhvillimit biologjik dhe pjekurisë emocionale. Aktiviteti i tyre kriminal nuk është, si në rastet e kriminelëve madhor,

pasojë e një dëshire të fortë dhe të paramenduar, por fajësia dhe përgjegjshmëria shprehet në formë të veçantë. Faktori i personalitetit konsiderohet karakteristik dhe trajtohet në mënyrë të veçantë. Ky faktor sqarohet nëpërmjet specificitetit të ndryshimeve trupore dhe psiqike të cilat janë karakteristike për adoleshencën, gjegjësisht për periudhën midis fëmijërisë dhe moshës madhore.

Teoritë biologjike dhe psikologjike fokusohen tek karakteristikat gjenetike dhe tiparet e tjera të personalitetit, të cilat i vendosin disa adoleshentë në rrezik për të shkelur ligjin.

Në literaturën psikologjike jepen mendime se adoleshenca paraqet periudhë të rinisë e cila fillon nga mosha 12-13 vjeçare, dhe përfundon me pjekurinë-rreth moshës 24-25 vjet. Në këtë periudhë personi gjendet në evoluim të vazhdueshëm dhe nën ndikimin e faktorëve të trashëgimisë dhe rrethit, që të riun e bëjnë më të ndryshëm nga të rriturit, së bashku me dukuritë përcjellëse të cilat për personin madhor mund të konsiderohen patologjike, tek popullata e kësaj moshe konsiderohen normale. Ndryshimet në sjellje reflektohen në mosmarrëveshje me familjen dhe rrethin shoqëror, në të cilën i riu gjen shkak për ndonjë sjellje asociale, por të cilat mund të bëhen model për identifikim negativ të përhershëm.

Faktorët biologjik janë lëndë e hulumtimit të teorive biologjike dhe antropologjike në kriminologji. Bëhet fjalë për: determinantat organike, trashëgiminë, faktorët e lindur dhe faktorët antropologjik. Determinantat organike paraqesin faktorë endogjen kriminogjen të cilët manifestohen me çrregullime organike të cilat konsiderohen si shkaqe të rëndësishme për sjelljet kriminale. Antropologët, në anën tjetër, i trajtojnë si anomali të lindura ose të përfituara të natyrës psikologjike. Çështjet e trashëgimisë janë gjithmonë të pranishme tek kriminologët për të cilët më me rëndësi është trashëgimia gjenetike, andaj veçanërisht studiohen gjenet, kromozomet dhe ADN-ja. Teoria e kromozomeve është e lidhur me atë se çrregullimi i thelbit të qelive (kromozomeve) përmbajnë gjene dhe janë bartës të vetive trashëguese, dhe ata prodhojnë sjellje jonormale. Nga hulumtimet e realizuara tek personat e dënuar është konstatuar se në mesin e kryesve të veprave kriminale tek gjinia mashkullore shpesh paraqiten kombinimet XY të kromozomeve Y të cilët janë të lidhura me sjelljet kriminale veçanërisht veprat e dhunshme⁶.

⁶ Nikolić-Ristanović, Vesna; Konstantinović- Vilić Slobodanka, Kriminologija, Beograd, 2018, fq. 272

Themeluesi i teorisë biologjike të kriminalitetit, Qesaro Lambrosio (1835–1909) sugjeronte se kriminelët kanë disa tipare gjenetike, biologjike dhe hormonale që i bëjnë të ngjashëm me paraardhësit e qenies njerëzore dhe që udhëheqin ose kanë një ndikim të fortë mbi tendencat e tyre kriminale. Lambrosio fokusohet në tiparet fiziologjike: “kriminelin i lindur veçohet me nofulla të qitura, me kokë të mprehtë e të gjatë dhe ballë të qitur”, në përmasat dhe proporcionet e kokës, në anormalitetet fizike si tregues të predispozitës kriminale⁷.

Psikoanalistët pretendojnë se sjelljet deviante janë simptoma të përvojave traumatike të fëmijërisë, të cilat nuk janë zgjidhur në kohën dhe mënyrën e duhur. Shumë sjellje deviante dhe kriminale, si përdorimi i drogës, ose përfshirja në akte të dhunshme, janë më shumë impulsive, sesa racionale dhe mund të nxiten nga tipare fizike, ose psikologjike jo normale, si hiperaktiviteti, niveli i ulët i inteligjencës, çrregullime gjenetike ose hormonale. Për shkak se sjelljet kriminale vihen re tek të miturit nga të gjitha përkatësitë racore, etnike dhe socio-ekonomike, përfaqësuesit e kësaj teorie i shikojnë këto sjellje më shumë si funksione të karakteristikave biologjike, të shqetësimeve psikologjike apo vonesës mendore, sesa pasoja të faktorëve socialë, si varfëria, diskriminimi ose përjashtimi social.

Teoritë e hershme të psikoanalizës si Jung dhe Frojd u përpoqën të shpjegojnë personalitetin, dhe si rrjedhojë sjelljen njerëzore përmes klasifikimit të përbërësve të tij. Zhvillimi i shëndetshëm i përbërësve të personalitetit (id, ego, superego) ndodh herët përmes ndërveprimit prind-fëmijë, dhe këto përvoja janë të rëndësishme për sjelljen e të rriturit. Përjetimi i ngjarjeve të dhimbshme ose traumatike gjatë fëmijërisë së hershme mund të nxisë sjelljet kriminale në adoleshencë dhe moshën e rritur. Sipas teorisë psikoanalitike, të miturit e angazhuar në sjellje kriminale nuk kanë zhvillim të mjaftueshëm të egos dhe superegos. Meqenëse superegoja moraliste është e dobët, adoleshenti do të synojë të plotësojë nevojat parësore dhe impulsive të idit, pa u penduar dhe pa vlerësuar ndjenjat e interesat e të tjerëve⁸.

Teoritë moderne të tipareve pohojnë se sjelljet kriminale kontrollohen nga përbërja biologjike dhe psikologjike (mendja), të cilat edhe pse nuk përcaktojnë, rrisin predispozitën për sjellje kriminale. Në librin e tij, Rimland (2008) thekson se sjelljet antisociale të të miturve janë

⁷ Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2008, fq. 78

⁸ Çilingiri Julinda, Vlerësim i faktorëve të rrezikut si parashikues të sjelljeve antisociale dhe delinkuente të të miturve në qarkun e Durrësit, Tiranës, Elbasanit, Tiranë, 2016, fq. 20

më shumë të lidhura me tiparet e trashëguara fizike dhe mendore, mbi të cilat ata nuk kanë asnjë lloj kontrolli, sesa me zgjedhjet personale⁹. Tek delikuentët e mitur hasen veti si egocentrizmi, mosekzistimi i ndjenjës së përgjegjësisë, mungesa e qëllimeve dhe planeve për jetë, adaptimi i vështirë, gënjeshtrat patologjike, gjendjet e neurozës, impulsiviteti¹⁰. Në periudhën e adoleshencës të shpeshta janë rastet e gjendjeve psikopatike. Gjenda e neurozës tek të rinjtë mund të ndikojë në dy lloje të sjelljes: ekspanzive dhe të inhibuara. Në rastin e parë, ekziston një sferë e gjerë e sjelljeve-nga dëgjueshmëria e plotë, deri te ajo agresive dhe kriminaliteti klasik.

2.2. Faktorët social

Në shoqërinë tonë në kushtet e tanishme i riu akoma nuk mund ti kënaqë nevojat e tij ekzistenciale, nuk mund ta zbulojë identitetin e tij dhe orientimin e vlerave, prandaj dhe bëhet i armiqësuar, pasiv dhe i paaftë për t'iu përshtatur ndryshimeve shoqërore të kësaj kohe. Shoqëria e çorganizuar, e armiqësuar dhe anemike, nuk mund që të rinjve t'ju mundësojë t'i realizojnë qëllimet e tyre me mjete legale për shkak të pozitës së tyre të marginalizuar në shoqëri, andaj gjithnjë numër më i madh i të rinjve kalojnë në destruktizëm ose konformizëm¹¹.

Në literaturën kriminale në mesin e faktorëve të veçantë për delikuencën e të miturve numërohen ndikimi i familjes, shkolla, koha e lirë, mjetet e komunikimit masiv dhe personaliteti i të miturit¹²

Rrethi familjar është elementi primar i socializimit në të cilin atmosfera emocionale në mënyrë të drejtpërdrejtë pasqyrohet edhe në zhvillimin intelektual dhe psikologjik të fëmijës.

Në legjislacionin pozitiv të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të rregulluara të drejtat dhe obligimet e prindërve, mbikëqyrja ndaj të drejtave prindërore, mundësitë për

⁹ Çilingiri Julinda, Vlerësim i faktorëve të rrezikut si parashikues të sjelljeve antisociale dhe delinkuente të të miturve në qarkun e Durrësit, Tiranës, Elbasanit, Tiranë, 2016, fq. 20

¹⁰ Nikolić-Ristanović, Vesna; Konstantinović- Vilić Slobodanka, Kriminologija, Beograd, 2018, fq. 226

¹¹ Алексоски, Стеван, Криминологија, Штип, 2009, fq.105

¹² Jašović, Žarko, Kriminologija maloletničke delvikencije, Beograd, 1991, fq. 232-273

kufizimin dhe marrjen e të drejtave prindërore, por edhe përgjegjësisë penale në qoftë se është lënë pas dore obligimi për kujdes dhe edukim dhe braktisja e fëmijës.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut në nenin 40 thekson prioritetin e të drejtave dhe obligimeve të cilat prindërit i kanë në aspekt të përkujdesjes dhe edukimit të fëmijëve, ndërkaq Ligji për familjen („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 80/1992...150/2015) më nga afër i rregullon obligimet e prindërve në aspekt të kujdesit, ruajtjes, edukimit, arsimimit, zhvillimit të shprehive të punës, si dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të fëmijëve.

Çdo formë e krizës në raportet familjare dhe prishjes së harmonisë martesore mund të pasqyrohet në zhvillimin emocional të fëmijës në lloje të ndryshme të çrregullimeve. Një përqindje e madhe e delikuencës së të miturve tek fëmijët të cilët janë rritur në shtëpi për fëmijë pa prindër interpretohen fillimisht me mungesën e edukatës prindërore, gjegjësisht asaj familjare. Në faktorët familjar të cilat luajnë rol të rëndësishëm numërohen edhe situata materiale, punësimi, raporti dhe kujdesi i prindërve, kushtet e banimit dhe ngjashëm. Në faktorët të cilët kontribuojnë për delikuencë tek fëmijët duhet të numërohet edhe shkyçja sociale si koncept multidimensional e cila është pasojë e varfërisë dhe papunësisë të cilat kanë ndikim ndaj popullatës së re, sistemit të vlerave, qëndrimeve, mundësive dhe aftësive të tyre¹³.

Krahas familjes, shkolla paraqet institucion në të cilat zhvillohen proceset më të rëndësishme të socializimit të personalitetit dhe aftësimi për funksione shoqërore dhe të punës. Nga organizimi përmbajtës programore dhe procesi arsimor kryesisht varet edhe zhvillimi i të rinjve dhe sjellja e tyre shoqërore.

Kur të miturit nuk janë të interesuar për programin shkollor, ata shumë shpesh manifestojnë agresivitet në shkollë dhe jashtë saj. Agresivitet paraqet secili përdorim i forcës. Mund të jetë në formë të kërcënimit ose të përfshijë përdorimin e forcës, e drejtuar ndaj vetes, ndaj një personi tjetër, ose ndonjë bashkësie tjetër. Përfundon, ose mund të përfundojë me lëndim fizik, dëm psikik, me çrregullim të zhvillimit ose me humbje.

¹³ Лажетик-Бужаровска, Гордана; Нанев, Лазар; Кошевалиска, Олга, Меѓународни документи за спроведување на малолетничката правда, Современи текови во постапувањето со малолетниците, Кавадарци, 2012, fq.37

Roli i mediave në preventimin e delikuencës së të miturve është shumë i rëndësishëm. Mjetet e komunikimit masiv kanë ndikim të madh në formësimin e personalitetit. Përmbajtje të caktuara kanë rol të fuqishëm edukativ ndaj të rinjve, duke ndikuar për orientimin pozitiv të tyre dhe formësimin e sjelljes së tyre në drejtim pozitiv.

Megjithatë, i njohur është edhe fakti se mediat, veçanërisht në kohëve të fundit, të frymëzuara nga interesat komerciale gjithnjë më shumë i plotësojnë përmbajtjet e tyre me programe në të cilat dominojnë përmbajtjet e dhunshme, vrasje, paraqitja e detajeve përshkruese gjatë kryerjes së veprave penale. Shumë studiues kanë arritur në përfundimin se të rinjtë që shohin dhunë, priren të sillen më agresivë dhe të dhunshëm, veçanërisht kur ata provokohen. Kjo është kryesisht, karakteristikë e djemve të moshës nga 8 deri në 12 vjet, të cilët janë më të ndjeshëm ndaj ndikimeve të tilla. Filmata që shfaqin veprime të dhunshme—filmata aksion, nxisin dhe energjia agresive mund të transferohet në jetën e përditshme, duke e shtyrë një individ të përfshihet në aktivitet të tilla “aksion” fizik edhe në rrugë. Televizioni mund të portretizojë dhunën e përditshme të kryer nga prindërit ose bashkëmoshatarët . Dhuna e përshkruar në media është joreale, kështu që pasojat e sjelljes së dhunshme shpesh duken të papërfillshme.

Përmbajtjet lidhur me mënyrat e lehta për të përfituar para si dhe plasimi i përmbajtjeve të rrejshme dhe ngjashëm, gjithashtu ndikojnë negativisht tek të rinjtë. Me praninë e këtyre përmbajtjeve dhe ndikimin e tyre ndaj të rinjve vështirësohet realizimi i socializimit tek personat e rinj dhe zhvillimi i proceseve pozitive kulturore në shoqëri.

Me paraqitjen e rrjeteve sociale (Facebook, Twitter, Telegram dhe ngjashëm), arritshmëria deri te informimi për ngjarje të ndryshme (pozitive dhe negative) është aktuale. Për fat të keq, për çdo ditë, për shkak të mospasjes së mekanizimit tërësisht kualitativ për filtrimin e përmbajtjeve jopërkatese, që përmbajnë dhunë, vulgaritet dhe ngjashëm, ekspozimi i këtyre përmbajtjeve është me të vërtetë i madh.

Nga analizat e shumta të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u konstatua se një pjesë e shkaqeve, të cilat kontribuojnë për sjellje delikuede tek fëmijët, janë si vijojnë: pamundësia për tu kënaqur nevojat themelore të fëmijëve, dobësimi i funksionit bazë të familjes, vështirësitë në arritjen e pjekurisë emocionale

dhe sociale, mungesa e vetërespektit, ndikimi negativ i moshatarëve, dëshira për dominim, mosrespektimi i autoritetit, shfrytëzimi i paorganizuar i kohës së lirë, do të thotë qëndrimi i tyre më i gjatë në hapësirat për zbavitje dhe objektet hoteliere ku janë të ekspozuar numrit të madh të ndikimeve negative¹⁴.

3. Vëllimi, dinamika dhe karakteristikat fenomenologjike të delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut së periudhën e viteve 2009-2018

Në këtë pjesë do të paraqitet dimensionimi fenomenologjik i delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë së Veriut së periudhën kohore 2009-2018 nëpërmjet analizimit të të dhënave të Entit shtetëror për statistikë.

Gjatë analizës së të dhënave lidhur me vëllimin e veprave penale të kryera nga ana e fëmijëve duhet të merret parasysh fakti se nga viti 2007 me hyrjen në fuqi të Ligjit për të drejtën e të miturve, e pastaj me hyrjen në fuqi të Ligjit për drejtësi për fëmijë në vitin 2013 tek fëmijët e moshës 14-18 vjet në masë të madhe zbatohet edhe parimi i oportunitetit në ndjekjen penale. Kështu në bazë të nenit 17 të Ligjit për drejtësi për fëmijë për veprën e fëmijës mbi 14 vjet që me ligj është paraparë si vepër penale ose kundërvajtje, organet dhe institucionet kompetente sipas rregullës nuk ngrejnë procedurë gjyqësore, që të shmanget ndikimi i dëmshëm mbi fëmijën. Procedura gjyqësore sipas rregullës ngritet vetëm në rastet e parapara si vepër penale me ligjin për drejtësi për fëmijë, nëse fëmija mbi 14 vjet ka kryer vepër që është paraparë si vepër penale për të cilën shqiptohet dënim me burg prej tri vitesh ose dënim më i rëndë, ose në rastet kur qëllimi i masave ose sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj nuk mund të arrihet pa procedurë të tillë.

Gjithashtu në bazë të nenin 75 të Ligjit për drejtësi për fëmijë pas kallëzimit për veprim që me ligj është paraparë si vepër penale të kryer nga fëmija mbi 14 vjet, për të cilën është

¹⁴ Kultura juridike, doracak i përgatitur nga PH International, në kuadër të Programit për socializim juridik, me mbështetje financiare nga Departamenti Amerikan i Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe shkencës dhe Ministrinë për punë të brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2013, fq. 30

përcaktuar dënim në para ose dënim me burgim deri në tre vjet, prokurori kompetent publik mundet që:

- të mos ngritë procedurë para gjykatës edhe pse ekzistojnë dëshmi se e ka kryer veprimin që me ligj është paraparë si vepër penale, nëse konsideron se nuk do të ishte e përshtatshme të zhvillohet procedurë duke marrë parasysh natyrën e veprimit që me ligj është paraparë si vepër penale dhe rrethanat në të cilat është kryer, jetën e mëparshme të fëmijës dhe cilësitë e tij personale, si dhe kur zbatimi i dënimit dhe masës edukuese është në rrjedhë,

- kushtimisht ta prolongojë ngritjen e procedurës para gjykatës në kohë prej gjashtë muajsh me kusht që në këtë afat të mos kryejë veprim tjetër që me ligj është paraparë si vepër penale dhe ta kompensojë dëmin ose në mënyrë tjetër t'i përmirësojë pasojat e dëmshme të shkaktuara me kryerjen e veprës dhe

- të mos ngritë procedurë nëse në bazë të raportit të qendrës konstaton se është arritur marrëveshje ndërmjet fëmijës dhe familjes së tij dhe të dëmtuarit për kthimin e dobisë pronësore, kompensimin e dëmit ose përmirësimin e pasojave të dëmshme nga vepra.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhëna për numrin e personave të paraqitur si kryes të veprave penale nga viti 2009 deri 2018.

Tabela 1.

Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Fëmijë	1 519	1 244	1 163	1 001	1 005	972	772	587	578	554
Persona madhor	30404	30004	31284	31860	34436	37164	26 069	20 502	8220 5	19779
Gjithsej	31923	31248	32447	32861	35441	38164	26841	21089	21160	20353

Kështu në vitin 2009 janë paraqitur gjithsej 31923 persona si kryes të veprave penale nga të cilët 1519 fëmijë, në vitin 2010 janë paraqitur 31248 si kryes të veprave penale, nga të cilët 1244 fëmijë, në vitin 2011 janë paraqitur 32447 persona si kryes të veprave penale, nga të cilët 1163 fëmijë, në vitin 2012 janë paraqitur 32861 persona si kryes të veprave penale nga të cilët 1001 fëmijë, në vitin 2013 janë paraqitur gjithsej 38164 persona nga të cilët 1005 fëmijë, në vitin 2014 janë paraqitur 38164 persona si kryes të veprave penale nga të cilët 972 fëmijë. Në vitin 2015 vërehet rënie e konsiderueshme numrit të personave të paraqitur si kryes të

veprave penale, kështu që në këtë vit janë paraqitur 26841 persona si kryes të veprave penale nga të cilët 772 janë fëmijë. Ky trend i rënies vazhdon edhe në vitet 2016, 2017 dhe 2018. Kështu në vitin 2016 janë paraqitur 21089 persona si kryes të veprave penale nga të cilët 587 fëmijë, në vitin vitin 2017 janë paraqitur 21160 persona si kryes të veprave penale nga të cilët 578 fëmijë dhe në vitin 2018 janë paraqitur 20353 persona si kryes të veprave penale nga të cilët 554 fëmijë.

Ndjekja e kriminalitetit në një seri të gjatë kohore, lejon të konstatohet trend i rënies. Kjo tendencë ka të bëjë si me kriminalitetin e të rriturve, po ashtu edhe kriminalitetin e fëmijëve. Nga të dhënat e paraqitura më lartë mund të konstatojmë se në vitin 2018 numri i fëmijëve të paraqitur si kryes veprave penale paraqet 64% më pak nga numri i fëmijëve që janë paraqitur si kryes të veprave penale në vitin 2009

Trendi i këtillë i uljes së numrit të veprave penale të kryera është rezultat i rënies së natalitetit dhe emigracionit të popullatës në shtet.

Në tabelën e dytë paraqitet numri i përgjithshëm i personave ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale në periudhën 2009-2018.

Tabela 2.

Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Fëmijë	748	547	722	556	473	461	348	468	368	330
Persona madhor	9801	9169	9810	9042	9539	11683	10312	8 172	6 273	5 857
Gjithsej	10549	9716	10532	9598	10012	12144	10660	8640	6641	6187


Në vitin 2009 numri i fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale paraqet 7% të numrit të përgjithshëm të personave të dënuar, në vitin 2010 kjo përqindje ulet në 5,6 %. Në vitin 2011 kjo përqindje shënon rritje në 6,8%, ndërkaq në vitin 2012 shënon rënie në 5,7%, në vitin 2013 kjo rënie vazhdon dhe atë në 4,7%. Në vitin 2014 numri i fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale paraqet 3,8% të numrit të përgjithshëm të personave të dënuar, në vitin 2015 kjo përqindje shënon rënie në 2,8%. Në vitin 2016 numri i fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione paraqet 5,7% të numrit të përgjithshëm të personave të dënuar, në vitin 2017 kjo përqindje arrin në 5,8% dhe në 2018 ulje të vogël në 5,6%.

Në tabelën numër 3 paraqiten të dhëna lidhur me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të dënuar në periudhën dhjetëvjeçare 2009-2018, si dhe për llojin e veprave penale sipas grupimit të tyre.

Tabela 3.

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	748	547	722	556	473	461	348	468	368	330
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	49	59	79	43	39	47	43	70	29	44
Vepra penale kundër lirive dhe te drejtave te njeriut dhe qytetarit	4	1	5	1	5	-	2	7	2	2
Vepra penale kundër nderit dhe autoritetit	1		2				1	7		
Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor	14	7	12	8	5	14	13	2	2	2
Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve	6	7	15	7	12	4	7	13	7	10
Vepra penale kundër financave publike qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	4	13	7	9	3	3	5	1	1	2
Vepra penale kundër pasurisë	547	403	513	409	353	267	198	257	251	188
Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës	2	1	6	4	4	6	2	4	2	2
Vepra penale kundër sigurisë në trafikun publik	46	35	39	26	24	14	28	22	32	25
Vepra penale kundër drejtësisë	20	1	1	1	-	-	3	2	2	0
Vepra penale kundër rendit dhe qetësisë publike	45	16	35	43	25	100	42	79	37	53
Vepra të tjera penale	10	4	8	5	3	6	4	4	3	2

Grafikon 1.



Nga tabela numër 3 dhe grafikon 1 i paraqitur mund të konstatojmë se në periudhën nga viti 2009 deri 2018 fëmijëve u janë shqiptuar sanksione penale kryesisht për vepra penale kundër pasurisë. Në vitin 2009 nga numri i përgjithshëm i sanksioneve të shqiptuara ndaj fëmijëve 73% kanë qenë të shqiptuara për vepra penale kundër pasurisë. Në vitin 2010 kjo përqindje ngel e njejtë, në vitin 2011 ulet në 71%, në vitin 2012 shënon një rritje të vogël dhe atë 73%, në vitin 2013 arrin 74%, ndërsa nga viti 2015 shënon rënie në 56% dhe në 2016 shënon 54%. Në vitin 2017, 68% e sanksioneve penale ndaj fëmijëve janë shqiptuar për vepra penale kundër pasurisë dhe në vitin 2018 kjo përqindje arrin 56%.

Duke u nisur nga fakti se veprat penale kundër pasurisë mbizotërojnë edhe në pasqyrën e përgjithshme fenomenologjike të kriminalitetit, lirisht mund të supozojmë se pjesëmarrja e vërtetë e fëmijëve në veprat penale kundër pasurisë është akoma më e madhe veçanërisht duke pasur parasysh deliktet më të lehta të cilat rrallë paraqiten.

Më tej me përqindje më të vogël vijojnë veprat penale kundër rendit dhe qetësisë publike (pjesëmarrja më e ulët shënohet në vitin 2010 dhe atë 2,9%, ndërsa më e larta në vitin

2014 dhe atë 21%), veprat penale kundër jetës dhe trupit (pjesëmarrja më e ulët shënohet në vitin 2009 dhe atë 6,5% ndërsa më e larta në vitin 2016 dhe atë 14%) dhe veprat penale kundër sigurisë në trafikun rrugor (pjesëmarrja më e ulët shënohet në vitin 2016 dhe atë 3,0% ndërsa më e larta në vitin 2017 dhe atë 8,6%).

Ndërkaq me numër shumë më të vogël vijojnë veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, veprat penale kundër nderit dhe autoritetit, veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, veprat penale kundër shëndetit të njerëzve, veprat penale kundër financave publike qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, veprat penale kundër drejtësisë dhe veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës.

Në tabelën nr. 4 do të paraqiten të dhëna për shkollimin e fëmijëve të ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale në periudhën 2009-2018

Tabela 4.

Viti	Gjithsej	Fillor	I mesëm	I lartë	Të dhëna të panjohura	Nuk ndjek mësimin
2009	748	51	416	/	19	262
2010	547	50	275	3	20	199
2011	722	63	367	1	17	274
2012	556	48	317	2	15	174
2013	473	25	210	0	47	191
2014	461	22	315	2	7	115
2015	348	30	158	0	13	147
2016	468	16	249	4	116	83
2017	368	5	114	0	118	131
2018	330	22	130	/	26	152

Nga tabela mund të konstatojmë se një numër i konsiderueshëm i fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale nuk e ndjekin mësimin edhe përkundër faktit se shkollimi fillor dhe i mesëm është i detyrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në vitin 2009 35% të veprave penale janë kryer nga fëmijë të cilët nuk e ndjekin mësimin, në vitin 2010 ky numër arrin 36%, në vitin 2011 ky numër arrin 37%, në vitin 2012 ky numër arrin 31%, në vitin 2013 ky numër arrin 40%, në vitin 2014 ky numër arrin 25%, në vitin 2015 ky numër


arrin 42%, në vitin 2016 ky numër arrin 24%, në vitin 2017 ky numër arrin 35% dhe në vitin 2018 ky numër arrin 46%.

Në tabelën numër 5 paraqiten të dhëna lidhur me numrin e përgjithshëm të fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale në periudhën dhjetëvjeçare 2009 -2018 si dhe grupimit të tyre sipas moshës.

Tabela 5.

	Numri i përgjithshëm i sanksioneve të shqiptuara	Fëmijë ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione nga mosha 14 deri 16 vjet	Fëmijë ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione nga mosha 16 deri 18 vjet
2009	748	210	538
2010	547	162	385
2011	722	220	502
2012	556	140	416
2013	473	123	350
2014	461	107	354
2015	348	73	275
2016	468	119	349
2017	368	112	256
2018	330	73	257

Grafikon 2.



Nga tabela mund të konstatojmë se në periudhën 2009-2018 më shumë sanksione penale u janë shqiptuar fëmijëve nga mosha 16 deri 18 vjet, njëkohësisht ky numër na shërben


si tregues së fëmijët e moshës nga 16 deri 18 vjet përfshihen më shpesh në veprime kriminale. Nga numri i përgjithshëm sanksioneve penale të cilat u janë shqiptuar fëmijëve, fëmijëve të grup moshës 16 deri 18 vjet u janë shqiptuar 71% e sanksioneve në vitin 2009, 70% në vitin 2010, 69% në vitin 2011, 74% në vitin 2012, 73% në vitin 2013, 76% në vitin 2014, 79% në vitin 2015, 74% në vitin 2016, 69% në vitin 2017 dhe 77% në vitin 2018.

Në tabelën numër 6 paraqiten të dhëna lidhur me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të dënuar në periudhën dhjetëvjeçare 2009 -2018 si dhe grupimin e tyre sipas gjinisë së kryesve.

Tabela 6.

	Numri i përgjithshëm i fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale	Fëmijë të gjinisë femërore	Fëmijë të gjinisë mashkullore
2009	748	39	709
2010	547	20	527
2011	722	22	700
2012	556	9	547
2013	473	24	449
2014	461	16	445
2015	348	22	326
2016	468	29	439
2017	368	14	354
2018	330	17	313

Grafikon 3.



Nga të dhënat e tabelës mund të konstatojmë se në vitin 2009 fëmijët e gjinisë femërore kanë marrë pjesë me 5,2% në kryerjen e veprave penale nga ana e fëmijëve, në vitin 2010 kanë marrë pjesë me 3,6%, në vitin 2011 kanë marrë pjesë me 3,0%, në vitin 2012 kanë marrë pjesë me 1,6%, në vitin 2013 kanë marrë pjesë me 5,0%, në vitin 2014 kanë marrë pjesë me 3,4%, në vitin 2015 kanë marrë pjesë me 6,3%, në vitin 2016 kanë marrë pjesë me 6,1%, në vitin 2017 kanë marrë pjesë me 3,8 % dhe në vitin 2018 kanë marrë pjesë me 5,1%.

KAPITULLI III

Zhvillimi i trajtimit juridiko penal ndaj të miturve

Faktin që delinkuenti i mitur është shumë më i ndryshëm se ai rritur në kuptim biologjik, psikologjik dhe sociologjik, e drejta penale e ka ndier që kohëve të vjetra e këndej. Kjo në fillim ka qenë e shprehur vetëm në aspektin e dënimit, gjegjësisht delikuentët e mitur kanë qenë të dënuar me të njëjtat dënime si edhe të rriturit, me atë që ndaj tyre është vepruar në mënyrë më të butë.

Tek sistemet më të vjetra juridike, qysh para paraqitjes së të drejtës romake, mund të gjenden vetëm fundamente të posaçme në aspekt të veprimit ndaj fëmijëve delikuent. Në këtë kuptim, e drejta e hershme kineze dallon tre faza të përgjegjesisë së të miturve: kryesi nën shtatë vjet është liruar nga dënimi plotësisht, kryesi nga mosha shtatë deri dhjetë vjet është propozuar para mbretit për falje, ndërkaq ndaj fëmijës në rast të kryerjes së veprës penale për të cilën nuk ka qenë i paraparë dënimi me burg ka mundur të dënohet vetëm me dënim me para. Tek grekët i gjejmë edhe idetë e para për përgjegjësi. Aristoteli p.sh, i llogarit të përgjegjshëm vetëm personat madhor, ndërsa fëmijët në aspekt të përgjegjesisë i barazon me kafshët për shkak të konstituimit të tyre të pamjaftueshëm psikik¹⁵.

Duke hedhur një vështrim historik, lidhur me trajtimin ligjor të të miturit, do të vërejmë që daton hershëm, që me Kodifikimin e Justinianit, ku është vendosur një kufi ligjor, mes të miturit („*impuberes*“), nga i rrituri („*puberes*“), që është mosha katërmëdhjetë vjeç¹⁶. Sipas Kodit të Justinianit fëmijët deri në moshën shtatë vjeçare („*infants*“) kanë qenë penalisht absolutisht të papërgjegjshëm dhe nuk janë dënuar; fëmijët nga mosha shtatë deri dhjetë vjet („*infantiaeproximi*“) janë llogaritur penalisht të papërgjegjshëm, por me përjashtim kanë mundur të dënohen varësisht nga aftësitë e tyre intelektuale. Fëmijët nga mosha 10 deri 14 vjet („*pubertatiproximi*“) i janë nënshtruar përgjegjesisë penale. Ndërkaq, personat deri 25 vjet („*puberesminorsviginti quinqueannis*“) edhe krahas faktit që kanë qenë penalisht të

¹⁵ Нанев, Лазар, Кошевалиска, Олга, Малолетничко казнено право, Штип, 2018, fq. 28

¹⁶ Kamboski Vllado, E drejta penale: pjesa e përgjithshme, Shkup, 2006, fq. 1085

përgjegjshëm, kanë mundur të dënohen më lehtë¹⁷. Ka pasur raste kur as kjo nuk është bërë: kështu nëse gjykata ka fituar bindjen se bëhet fjalë për të mitur veçanërisht të “ligë”, të udhëhequr nga maksima “malitia supplet aetaten” ka mundur ta dënojë dhe në masë të njëjtë si edhe kryesin madhor.

Në mesjetë për herë të parë Kodi penal i njohur si “Karolina” (1532) parasheh ndalesën e dënimit e vdekje ndaj të miturve deri në moshën katërbëdhjetë vjeçare për vjedhje ose ndonjë vepër tjetër të ngjashme. Kodi penal i Maria Tereza (1768) për fëmijët deri në moshën katërbëdhjetë vjeçare nuk parasheh dënime, ndërsa Kodi penal Toskan të cilin e përgatiti Bekarie (1786) për fëmijët deri në moshën dymbëdhjetë vjeçare ndalon zbatimin e sanksioneve.

Kodi penal revolucionar francez i vitit 1791 fut ne rend të ditës çështjen e aftësisë së të miturit për përgjegjësi penale, duke e futur “disernementin” si ndryshim në drejtim te dyfishtë: duke futur kufi në mes të moshës madhore dhe asaj të mitur në 16 vjet, dhe e dyta “disernementimi” u bë kusht për dënimin e të miturit dhe zhvillimit shpirtëror i cili mundëson të kuptohet rëndësia e veprës, gjegjësisht veprimi pa vetëdije, pra mendjelehtësia si bazë për dënim më të butë. Ai bëhet bazë për dënim më të butë, mirëpo edhe e hap rrugën për futjen e një sistemi të dënimit të të miturve i cili do të nisët nga ideja për edukim dhe e cila do të sjellë më pak represion për dallim nga dënimet ndaj të rriturve. Këtë orientim e pranojnë edhe legjislacionet tjera kështu që hapin rrugën ndaj reformave në të drejtën penale ndaj të miturve¹⁸.

Më vonë, nëpërmjet praktikës së gjykatave në ShBA filluan të merren me problemin e kufirit të moshës dhe aftësinë për të qenë të përgjegjshëm, për futjen e një sistemi të veçantë të sanksioneve-masave edukuese dhe parashikimin e procedurës së veçantë. Në ShBA paraqiten gjykatat e para të posaçme për të mitur dhe atë gjykata e parë është themeluar në Çikago në vitin 1899, ndërkaq deri në vitin 1910 gjykata për fëmijë kanë ekzistuar në 35 shtete amerikane¹⁹.

¹⁷ Нанев, Лазар, Кошевалиска, Олга, Малолетничко казнено право, Штип, 2018, fq. 28

¹⁸ Институт за социолошки и политичко-правни истражувања, Малолетничкиот криминалитет во транзицијата на Република, Скопје, 2007, fq.44

¹⁹ Нанев, Лазар, Кошевалиска, Олга, Малолетничко казнено право, Штип, 2018, fq. 28,

Ideja për përkujdesje dhe edukimin e delikenteve të mitur bëhet gjithnjë më mbizotëruese e cila sjell deri në zbatimin e procedurës penale ndaj të miturve edhe të institucioneve tjera të përkujdesjes, siç janë organet sociale, me çka edhe vetë procedura merr në elementet e saja karakteristika të reja. Këta ide veçanërisht u përhapën dhe përparuan në vendet skandinave.

Shikuar historikisht teksti i parë ligjor i cili fëmijët i trajton si kategori të veçantë është sjellë në Norvegji në vitin 1896 dhe me të ju ofrohet mbrojtje fëmijëve të braktisur.

Një valë e re e reformave në të drejtën penale paraqitet në gjysmën e dytë të shekullit 19-të, në erën e zhvillimit të shpejtë industrial të shoqërisë borgjeze dhe të gjitha ndryshmet në raportet shoqërore që i solli ajo. Në këtë periudhë u përhap mendimi se për sjelljen kriminale fajtor është edhe shoqëria e cila nuk i ka krijuar kushte për jetë. Çështja e pozitës së të miturit në të drejtën penale mbahej vazhdimisht aktuale dhe trajtohej në aspekt të kufirit të moshës, sistemit të masave edukuese, nëse është e nevojshme që të miturit të nxirren nga sistemi i përgjithshëm i të drejtës penale në legjislacion të veçantë etj. Vëmendja ishte kthyer nga ajo që sistemi i ri i sanksioneve ndaj të miturve-masave edukuese si të formësohen dhe nëpërmjet zbatimit të tyre jo-represiv të sigurohet socializmi dhe risocializimi i të miturit.

Fillimi i shekullit të njëzetë është koha e reformave në legjislacionet në vende të caktuara në të cilat bëhen përpjekje që më nga afër dhe më qartë të caktohet pozita e kryesve të mitur të veprave penale, në mënyrë që në ligjet penale parashihen dispozita të veçanta për mënyrën e veprimit ndaj të miturve, vazhdimisht diskutohet dhe bëhen ndryshime në kufirin e moshës lidhur me përgjegjësinë penale ose zbatimin e një lloji të caktuar të sanksioneve. Kjo tendencë vjen në shprehje në më shumë legjislacione evropiane nëpërmjet krijimit të ligjeve të veçanta për të mitur: në vitin 1962 në Suedi, përpunohen në mënyrë të veçantë kushtet dhe mënyra për zbatimin e secilit sanksion ndaj të miturve. Ligji anglez për të mitur i vitit 1963 parasheh që fëmijët mbi 14 vjet janë penalisht të përgjegjshëm por për ata parashihet sistem i veçantë i sanksioneve. Karakteristikat themelore të sistemit anglosakson të së drejtës penale për të mitur janë: përcaktimi i nocionit të gjerë të delikuencës së fëmijëve, zhvillimi i sistemit të masave jashtë sistemit tradicional penalo-juridik dhe ekzistimin e gjykatave të posaçme për fëmijë. Këtë orientim e pranojnë edhe Danimarka dhe Norvegjia, si dhe Gjermania e cila në vitin

1953 sjell Ligjin për gjykatat e të miturve, ndjesa në vitin 1990 zgjerohet edhe zbatimi i ndërmjetësimit. Në Francë e drejta penale e të miturve u ndryshua dhe plotësua në vitin 1992 me atë që pranohet ideja e një ligji të veçantë për të miturit, i cili njëkohësisht do të sigurojë edhe mbrojtjen e të miturve. Mund të thuhet se këto janë paraprijëse të krijimit të “Ligjeve mbi drejtësinë e të miturve” të cilat e lëshojnë konceptin e pengimit retributiv dhe represiv të kriminalitetit të të miturve, mbrojtjen e të miturve nga represioni i shoqërisë, zbatimin e drejtësisë restorative, ndërsa kujdesin ndaj gjeneratave të reja e transferojnë mbi shoqërinë. Ndryshimet janë rezultat i instrumenteve ndërkombëtare të cilat insistojnë në implementimin e metodave për integrim social të të rinjve, organizimin e programeve të posaçme të specializuara dhe ndihmës ndaj fëmijëve në shkolla me qëllim të integritit dhe socializimit më të mirë të tyre. Në frymën e pohimit të Franz Liszt se politika e mirë sociale është politika kriminale më e mirë, aktual është perceptimi se e një rëndësie më të madhe për paqen sociale është të promovohet politika kriminale e cila është e drejtuar nga preventimi i sjelljes antisociale dhe kriminale, zhvillimi i masave alternative, mbajtja llogari për nevojat e viktimave dhe përkrahja e tyre, riintegrimi i kryesve të veprave penale, metodat e posaçme të veprimit me delikuentët e mitur, si dhe roli restaurues i gjykatave dhe burgjeve²⁰.

²⁰ Лажетик-Бужаровска, Гордана; Нанев, Лазар; Кошевалиска, Олга, Меѓународни документи за спроведување на малолетничката правда, Современи текови во постапувањето со малолетниците, Кавадарци, 2012, fq.19

KAPITULLI IV

“Ombrella” e standardeve ndërkombëtare dhe regionale

Dokumentet dhe standardet ndërkombëtare paraqesin një mbështetje esenciale të drejtimit në të cilin duhet të lëvizë, qëllimin ku duhet synuar dhe bazën në të cilën duhet të mbështetet korniza juridike dhe politikat në aspekt të ndërtimit të një shoqërie humane dhe inkluzive, e cila ju jep një shans të dytë fëmijëve me probleme edukuese dhe me sjellje të çrregulluar.

Normat dhe standardet ndërkombëtare e sublimojnë orientimin e ri të metodave dhe mjeteve për preventimin e delikuencës së fëmijëve. Korpusi i të drejtave universale të njeriut të pranuar, përfshin edhe të drejta “speciale” për fëmijët, duke shprehur me këtë përcaktimin për mbrojtje të përfortuar dhe zhvillimin e fëmijëve duke eliminuar të gjithë faktorët e rrezikut.

Në 30 vitet e fundit, standardet e drejtësisë ndërkombëtare për të miturit janë zhvilluar nga Kombet e Bashkuara në nivel ndërkombëtar dhe Këshilli i Europës në nivel rajonal.

1. Dokumentet e Kombeve të Bashkuara

1.1. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve

Nga konventat e shumta të cilat përmbajnë dispozita për të drejtat e të miturve rëndësi të posaçme ka Konventa për të drejtat e fëmijëve, e miratuar nga ana e Asamblesë së përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1989. Konventa për të drejtat e fëmijës e vitit 1989 është Konventë e pranuar thuajse nga të gjitha shtetet. Ajo parasheh një spektër të gjerë të të drejtave të fëmijëve dhe i obligon shtetet nënshkruese që ti mbrojnë të njejtat. Shtetet janë të obliguara rregullisht të dorëzojnë raporte në aspekt të implementimit të këtyre të drejtave deri të Komiteti për të drejtat e fëmijëve, i cili përgatit “konstatime përmbyllëse” në aspekt të gjendjes konkrete më këta të drejta në shtetin e caktuar. Komiteti për të drejtat e fëmijës ka dhënë edhe 24 Komentet të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e

fëmijëve të parapara në Konventë²¹. Komenti i përgjithshëm nr. 10 i vitit 2007 ka të bëjë me fëmijët në konflikt me ligjin dhe jep udhëzime plotësuese në aspekt të moshës më të ulët të përgjegjësisë penale, sipas të cilit: Komiteti e konsideron si ndërkombëtarisht të papranueshme moshën më të ulët se 12 vjet të përgjegjësisë penale.

Në vitin 2000 Asambleja e përgjithshme e Kombeve të bashkuara miratoi edhe dy protokolle fakultative: Protokollin që ka të bëjë me involvimin e fëmijëve në konfliktet e armatosura dhe Protokollin që ka të bëjë tregtinë me fëmijë, eksploatimit të fëmijëve në prostitucion ose pornografi.

Në vitin 1993 kjo konventë u ratifikua edhe nga shteti ynë, ndërkaq në vitin 2003 u ratifikuan edhe dy protokollet fakultative. Me ratifikimin e Konventës dhe protokolleve fakultative të saj, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut u obligua të sigurojë përmbushjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në vitin 2011 miratohet protokoli fakultativ i Konventës për të drejtat e fëmijëve lidhur me procedurat e komunikimit, i njejti hyri në fuqi në vitin 2014.

Dispozitat juridike lidhur me të drejtat e fëmijës janë të parapara në pjesën e parë (nenet 1 deri 41), pjesa e dytë ka të bëjë me mekanizmat dhe instrumentet për zbatimin e obligimeve të ndërmarra nga ana e shteteve anëtare të kësaj Konvente (nenet 42 deri 45) dhe pjesa e tretë ka të bëjë me obligimet formale dhe kushtet në lidhje me aderimin ndaj Konventës me nënshkrimin e saj (nenet 46-54). Në konventë janë paraparë risi esenciale si për shembull: ajo e parasheh të drejtën e “pjesëmarrjes” së fëmijëve, që ka të bëjë me të drejtën që ata të jenë të informuar lidhur me të drejtat e veta, si dhe përmban çështje të cilat paraprakisht nuk kanë qenë lëndë e ndonjë instrumenti ndërkombëtar, siç është e drejta e rehabilitimit të fëmijëve viktime të cilët kanë vuajtur forma të ndryshme të trajtimit të vrazhdë dhe eksploatimit.

Sipas Konventës, fëmijë është çdo qenie njerëzore e cila nuk ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet, nëse në bazë të ligjit që ka të bëjë me fëmijën, nuk arrihet më parë (neni 1). Konventa përmban sistem të të drejtave të fëmijëve dhe e thekson interesin e tyre si primar në të gjitha

²¹https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/TBSearch.aspx?Lang=en&TreatyID=5&DocTypeID=11

aktivitetet të cilat i ndërmarrin institucionet publike ose private, gjykata ose organet tjera: shteti ka obligim për mbrojtjen dhe përkujdesjen e të miturit që është e domosdoshme për zhvillimin e tyre. Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente i respektojnë dhe sigurojnë të drejtat e parapara në konventë nën juridiksionin e tyre, pas asnjë lloj diskriminimi (neni 2). Në ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me fëmijët rëndësi primare kanë interesat e fëmijëve (neni 3). Kjo dispozitë ka karakter parimor dhe ka konsekuenca të rëndësishme edhe në aspekt të modelit të drejtësisë së fëmijëve: në aspekt të luftimit të kriminalitetit, në të cilën padyshim është dominant interesi publik për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, prioriteti i interesit të fëmijës duhet të jetë vendimtar në aspekt të metodave dhe mjeteve të reagimit të inspiruar nga nevoja e ndihmës ndaj fëmijës dhe mbrojtjes së tij²².

Konventa përmban: të drejtën e jetës e cila fitohet me lindje, të drejtën e shtetësisë, të drejtën që fëmija ta di kush janë prindërit e tij dhe të drejtën e përkujdesjes nga ana e tyre: të drejtën e ruajtjes së identitetit të tij, duke përfshirë shtetësinë, emrin dhe lidhjet familjare e kështu me radhë. Të gjitha këta të drejta të definuara në mënyrë shumë precize janë lëndë e degës familjare, të punës dhe degëve të tjera të drejtësisë. Zbatimi i tyre ka rëndësi për të drejtën penale si “ultima ratio” në raport me degët e lartpërmendura të së drejtës.

Konventa ju imponon shteteve anëtare në mënyrë eksplicite ta respektojnë garancat në vijim: Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara me të drejtën nacionale ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer; prezumimin e pafajësisë, të drejtën e informimit dhe mbrojtjes me ndihmën e përfaqësuesit ligjor, të drejtën e gjykimit fer dhe të paanshëm, të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor, të drejtën për të propozuar dëshmitarë në mbrojtje të tij, të drejtën e ankesës dhe të drejtën e mbrojtjes së privatësisë në të gjitha fazat e procedurës.

Konventa në nenin 37 ndalon shqiptimin e dënimit me vdekje dhe burgimit të përjetshëm për fëmijët, dhe kërkon që arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një mjet i fundit dhe për periudhë kohore sa më të shkurtër. Gjithashtu, ajo ndalon heqjen arbitrare të lirisë dhe merr masa për sigurimin e

²² Камбовски, Владо, Компаративна анализа на малолетничкото законодавство, Скопје, 2006, fq. 34

ndihmës ligjore. Për këtë arsye, duhen përdorur një sërë masash si alternativa të kujdesit institucional, për të siguruar që fëmijët të trajtohen në një mënyrë të duhur për mirëqenien e tyre proporcionalisht për kushtet e tyre dhe shkeljet. Aty ku përdoret dënimi, fëmijët duhet të kenë të drejtën të trajtohen me respekt e humanizëm, duhet të mbrohen nga dëmi dhe kanë të drejtën për kujdes shëndetësor dhe shkollim.

Në bazë të nenit 40 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijët e akuzuar për shkelje të ligjit duhet të trajtohen në një mënyrë që është në përputhje me dinjitetin të tyre dhe e vlerat e personit dhe e cila forcon respektin e tyre për të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Ky nen është i rëndësishëm për modelin e sanksioneve, pasi që parasheh të sigurohet procedimi me fëmijët në mënyrë që është në interes të tyre dhe që është përkatës për rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, në ligjet nacionale duhet të parashihen mundësi të ndryshme siç janë: kujdesi, këshillimi, mbikëqyrja, përfaqësimi juridik, dënimi me kusht, strehimi, arsimimi dhe programet e edukimit profesional²³.

1.2. Udhëzimet e OKB-së për parandalimin e delikuencës së të miturve-Direktivat e Riadit

Udhëzimet e Kombeve të bashkuara për parandalimin e delikuencës së të miturve të vitit 1990 “Direktivat e Riadit” i definojnë standardet për parandalimin e delikuencës së të miturve, duke e përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve për të cilët konsiderohet se janë në rrezik nga delikuenca e të miturve, si dhe masat që duhet ndërmarrë për eliminimin e rreziqeve të këtilla.

Bëhet fjalë për rregulla të cilat e përfshijnë “fazën paraprake të konfliktit” dhe përmbajnë masa dhe standarde për mbrojtjen e fëmijëve në situatë të “rrezikut social” që përbëhen nga modalitete të ndryshme të: preventimit të hershëm dhe intervenimit mbrojtës të drejtuar nga familja, sistemi arsimor, bashkësia dhe mjetet e komunikimit masiv. Udhëzimet e Riadit parashohin t`ju kushtohet vëmendje e veçantë fëmijëve të cilët: janë të lëshuar nga ana e

²³ Камбовски, Владо; Велкова Татјана, Малолетничка правда, Скопје, 2008, fq.61

prindërve, janë të lënë pas dore, janë të maltretuar, janë të ekspozuar drogës, janë të marginalizuar dhe janë të ballafaquar me rrezikun për të qenë në konflikt me ligjin.

Këta rregulla e zgjerojnë rolin që duhet ta kenë sektorët e ndryshme shoqërore, si për shembull familja, bashkësia, mediat dhe sistemi arsimor, në aspekt të pengimit të delikuencës së të miturve në mesin e të rinjve të cilët janë në rrezik. Zemra e këtij dokumenti është kreu që titullohet “procesi i socializimit” që fokusohet tek përfshirja e familjes, arsimimi, roli qendror i komunitetit dhe programet parandaluese të bazuara në bashkësi.

Përfshirja e familjes është paraparë në rekomandimin 12: “Duke qenë se familja është njësi qendrore, përgjegjëse për socializimin fillestar të fëmijëve, përpjekjet qeveritare dhe ato sociale duhet të ruajnë integritetin e familjes, përfshirë edhe familjet e zgjeruara duhet që të ndiqen. Shoqëria ka një përgjegjësi të asistojë familjet në kryerjen e kujdesit dhe mbrojtjes dhe në sigurimin e mirëqenies fizike dhe mendore të fëmijës”. Për këtë qëllim qeveritë duhet të ndërtojnë politika ndihmëse për rritjen e fëmijës në një ambient familjar të qëndrueshëm, ndërkaq familjeve në nevojë të shërbimeve për të arritur këtë qëllim duhet t’u sigurohet një shërbim i tillë.

Edukimi është fokusi i dytë i “procesit të socializimit”. Rekomandime janë dhënë lidhur me zhvillimin e jetës kulturore, emocionale dhe psikologjike të fëmijëve. Direktivat specifikojnë se sistemet arsimore dhe edukuese duhet të kërkojnë që të punojnë bashkërisht me familjet dhe organizata e komuniteteve, si dhe rekomandojnë eliminimin e masave disiplinore të ashpra nëpër shkolla, veçanërisht ndëshkimet trupore.

Në rekomandimin 32 përcaktohet se: “Shërbimet dhe programet e bazuara në komunitet të cilat i përgjigjen nevojave sociale, problemeve, interesave dhe shqetësimeve të personave të rinj dhe që ofrojnë një këshillim të përshtatshëm dhe veprime konkrete drejtuese për të rinjtë dhe familjet e tyre duhet të zhvillohen ose të forcohen, në ato vende që ekzistojnë”.

Kujdes i veçantë t’i kushtohet fëmijëve pa shtëpi dhe theksohet se organizatave vullnetare që sigurojnë shërbime për të rinjtë duhet tu jepet ndihmë financiare dhe çdo ndihmë tjetër nga ana e shtetit.

Gjithashtu inkurajohet pjesëmarrja e të rinjve. Theksohet se duhet të krijohen dhe të forcohen organizatat e të rinjve në nivel lokal dhe organizatat e tilla duhet të përfshihen në menaxhimin dhe vendimmarrjen brenda komunitetit.

Mediat gjithashtu theksohen veçanërisht kur bëhet fjalë për proceset e socializimit dhe integritit të cilat duhet ta nxisin dhe shfaqin procesin pozitiv të të rinjve. Theksohet nevoja e organizimit të një numri gjithnjë më të madh të kampanjave të cilat do të ndikojnë në zvogëlimin e përdorimit të alkoolit dhe drogës, si dhe minimizimin e emitimit të programeve ku përshkruhet dhuna dhe eksploatimi i të rinjve.

1.3. Rregullat minimale standarde të OKB për të drejtat e të miturit-Rregullat e Pekinit

Rregullat minimale standarde të OKB për të drejtat e të miturit (Rregullat e Pekinit) janë miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33 më 29 nëntor 1985. Në parimet e përgjithshme (1.5) posaçërisht është theksuar se drejtësia për delikuencën e të miturve duhet kuptuar si pjesë përbërëse e procesit të zhvillimit nacional të çdo shteti dhe njëkohësisht në këtë mënyrë të kontribuoj për mbrojtjen e të rinjve dhe mbajtjen e qetësisë në rendin shoqëror. Duke ngelur në pozitën e parimit të ligjshmërisë në raport me definimin e nocionit të delikuencës së të miturve rregullat parashohin kufij të vjetërisë së epërme dhe të poshtme, të jenë të rregulluara në secilin sistem penalo-juridik me pëlqimin e specifikave ekonomike, sociale, politike dhe kulturore të çdo shteti. Në raport me tërheqjen e kufirit të poshtëm të moshës është e theksuar kërkesa ajo të mos mund të përcaktohet shumë ulët dhe në përcaktimin e saj të merren parasysh pjekuria emotive, mentale dhe intelektuale.

Rregullat që kanë të bëjnë me sistemin e së drejtës penale (rregullat 5-9) si prioritet e përcaktojnë mirëqenien e të miturit dhe parimin e proporcionalitetit sipas të cilit duhet gjithmonë me siguri të konstatohet se masa e ndërmarrë kundër delikuentit të mitur do të jetë në raport me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe gjendja e kryesit. Princiipi i proporcionalitetit për dallim prej të rriturve nuk nënkupton dënim të merituar që i përgjigjet peshës së veprës së kryer, por masa të individualizuara për të cilën rëndësia e veprës ka

funkcion të moskalueshmërisë së kufirit të epërm, por zgjedhja e masës varet ekskluzivisht nga gjendja e personalitetit të të miturit. Sipas rregullës nr.7 të drejtat themelore procedurale si prezumimi i pafajësisë, e drejta e informimit për arsyet e akuzës, e drejta e heshtjes, e drejta e përfaqësuesit ligjor, e drejta e pranisë së prindërve ose kujdestarit, e drejta e ballafaqimit dhe parashtrimit të pyetjeve dhe e drejta e ankesës deri te gjykata më e lartë duhen të jenë të garantuara në të gjitha fazat e procedurës. Poashtu në procedurë duhet të mbrohet i mituri prej publikut me qëllim që t'i iket ndikimit negativ potencial që mund të shkaktoj publiciteti, potencimi dhe etiketimi i kryesit (rregulla nr.8).

Rregulla shumë restriktive janë vendosur në aspekt të paraburgimit në pritje të gjykimit, i cili zbatohet si masë e fundit dhe me afat më të shkurtër të mundshëm, me respektimin e standardeve dhe garancave të OKB-së për veprimin me të burgosurit dhe të paraburgosurit dhe me kujdesje të posaçme, mbrojtje dhe ndihmë specifike (sociale, edukuese, profesionale, psikologjike, mjekësore dhe fizike). Të miturit mbahen në paraburgim të ndarë nga të rriturit. Atje ku është e mundur paraburgimi mund të zëvendësohet me masa alternative si: mbikëqyrje intensive, vendosje në familje ose institucion edukativ, gjegjësisht shtëpi për kujdesje (rregulla nr.13).

Rregullat të cilat kanë të bëjnë me shqyrtimin e rastit dhe marrjes së vendimit e rregullojnë procedurën para gjykatës dhe llojin e sanksioneve juridiko-penale. Kështu, procedurën që e zhvillon organi duhet të jetë në interesin më të mirë të fëmijës dhe duhet t'i mundësohet fëmijës të marrë pjesë në procedurë dhe të shprehet lirshëm (rregulla nr.14). Gjatë procedurës i mituri ka të drejtën e përfaqësuesit ose ka të drejtë të parashtojë kërkesë për ndihmë juridike falas, ndërsa prindërit ose tutorët kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurë dhe organi kompetent mund të kërkojë që ata të jenë të pranishëm në interes të të miturit.

Rregullat për risocializim përmes trajtimit jashtë institucional (23-25) e rregullojnë çështjen për kontrollin ndaj zbatimit të masave jashtë institucionale dhe për ndryshimin e vendimeve të masave të tilla, si dhe për sigurimin e ndihmës së nevojshme lidhur me strehimin, arsimimin ose trajnimin profesional me qëllim që të lehtësohet procesi i riintegrit.

Për lirimin me kusht janë të parapara kushte më liberale, ndërkaq të miturit të cilët janë liruar me kusht duhet të marrin ndihmë dhe duhet të mbikëqyren nga ana e organit kompetent dhe të kenë përkrahje të plotë nga bashkësia (rregulla nr.28).

Rregullat përmbajnë edhe një pjesë të dedikuar punës hulumtuese, si bazë për planifikim, formulim të rregullave dhe vlerësimit, rishqyrtimin periodik të trendit të delikuencës së të miturve dhe përparimin e sistemit penalo-juridik ndaj të miturve (rregulla nr.30)

1.4. Rregullat e Kombeve të bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria -Rregullat e Havanës

Rregullat e Kombeve të bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria të vitit 1990 (Rregullat e Havanës) paraqesin një tërësi parimesh të cilat vlejné për çdo person të mitur të privuar nga liria, në cilindo institucion, me të cilat sigurohet përparimi i zhvillimit dhe mirëqenies së tyre. Këta rregulla definojnë standardet për kushtet materiale në rast të privimit nga liria, për mbrojtjen e të miturve derisa janë në paraburgim ose të burgosur, si dhe programet arsimore, profesionale dhe ata të punës. Rregullat theksojnë se burgosja duhet të jetë një masë e mjetit të fundit për periudhën minimale të nevojshme. Rregulla nr.12 parasheh që privimi nga liria, duhet të bëhet në kushte dhe në rrethana të tilla që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut për të miturit. Të miturve të privuar duhet tu ofrohen aktivitete dhe programe të cilat promovojné shëndetin, respektin e tyre, ndjenjën e përgjegjësisë dhe zhvillojnë potencialin e tyre për të qenë anëtarë produktivë të shoqërisë. Rregulla nr. 17 parasheh të shmangët paraburgimi për aq kohë sa është e mundur dhe të zbatohet përjashtimisht për rrethana të jashtëzakonshme. Të miturit të arrestuar duhet t'i sigurohet e drejta e ndihmës juridike falas, si dhe komunikimi i rregullt me këshilltarin e tij juridik, gjatë së cilës duhet të garantohet privatësia dhe konfidencialiteti në komunikimin e tyre.

Rregulla të veçanta janë të parapara për menaxhimin me institucionet për të miturit. Të gjitha njoftimet lidhur me të dhënat ligjore, të dhënat mjekësore dhe të dhënat lidhur me masat disiplinore, duhet të arkivohen në dosje individuale konfidenciale e cila mbahet nga personat zyrtar. Pas lëshimit të institucionit nga ana e fëmijës, dosja mbyllet dhe shkatërrohet

pas kalimit të periudhës së caktuar. I mituri mund të pranohet në institucion vetëm me vendim valid gjyqësor ose administrativ. Pas pranimit të fëmijës në afat sa më të shkurtër i mituri duhet të intervistohet dhe të përgatitet raport psikologjik dhe social me të cilin do të identifikohen faktorët relevant për përcaktimin e llojit special dhe shkallës së përkujdesjes, si dhe programit përkatës për të miturin. Parashihet se të miturit duhet të jenë të ndarë nga të rriturit në institucion. Parashihet të themelohen institucione të dedikuara për numër të vogël të të miturve. Numri i të miturve të përkujdesur në institucion duhet të jetë sa më i vogël me qëllim që të mundësohet trajtimi individual. Institucionet për paraburgim të të miturve duhet të jenë të decentralizuara me qëllim që të mundësojë kontaktin e të miturve me familjet e tyre.

Dizajni i objektit të institucioneve duhet të jetë i tillë që të sigurojë privatësi, mundësi për shoqërim me bashkëmoshatar dhe t`ju mundësojë zhvillimin e aktiviteteve sportive, aktiviteteve tjera fizike dhe aktiviteteve të lira.

Rregullat të veçanta janë paraparë lidhur me arsimimin, aftësimin profesional dhe punën. Secili i mitur i cili është në moshë që i takon arsimimi i detyrueshëm ka të drejtë ta ndjekë mësimin në institucionet shkollore jashtë institucionit për të mitur, ose në kuadër të vetë institucionit nëse shkollimi i tillë mundësohet. Të miturve të cilët janë analfabet ose kanë probleme kognitive ose vështirësi gjatë mësimit duhet t`ju sigurohet e drejta për arsimim special. Diplomat ose çertifikatat arsimore të cilat u janë dhënë të miturve gjatë trajtimit të tyre institucional nuk guxojnë të kenë informata për trajtimin e tillë. I mituri ka të drejtë për arsimim profesional për profesione të cilat do ta përgatisin për punësim në të ardhmen.

Me rregullat janë rregulluar edhe: rekreimi, mundësimi i praktikimit të religjionit, përkujdesja mjekësore, njoftimi në rast të sëmundjes, lëndimit ose vdekjes së të miturit, kontaktet me rrethin më të gjerë, procedura disiplinore, ankesa dhe kthimi në bashkësi.

1.5. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për masat alternative të dënimit me burgim -Rregullat e Tokios

Në aspekt të masave alternative të dënimit me burgim (masat e mosarrestimit) vëmendje meritojnë edhe Rregullat e Tokios, të cilat na ndihmojnë të përfitojmë një pasqyrë të

plotë të masave alternative të dënimit me burgim. Rregullat e Tokios paraqesin dokument kyç në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare për drejtësinë për fëmijë. Miratimi i tyre ndërlihet me Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për preventimin e delikuencës së të miturve (Rregullat e Riadit) dhe rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e fëmijëve të privuar nga liria (Rregullat e Havanës). Duke pasur parasysh trendet e drejtësisë për fëmijë të cilët imponojnë zhvillimin e diversitetit dhe zbatimin e masave duke iu shmangur shqiptimit të dënimit me burg, të gjitha legjislaturat bashkëkohore duhet të angazhohen për promovimin e principeve të tyre²⁴.

Rregullat e Tokios definojnë mbrojtjen minimale juridike dhe të drejtat të cilat i takojnë fëmijës gjithmonë kur ka rënë ndesh me ligjin, gjegjësisht paraqesin një përmbledhje të parimeve për zbatimin e masave alternative, të cilat duhet të zbatohen ndaj fëmijëve që kanë rënë ndesh me ligjin “në të gjitha fazat e procedurës penale”. Rregullat e Tokios janë të klasifikuara në tetë kategori: parimet e përgjithshme, faza para gjykimit, faza gjykimit dhe shqiptimit të aktgjykimit, faza pas shqiptimit të aktgjykimit, zbatimi i masave alternative të trajtimit institucional, ekipi i të punësuarve, vullnetarë dhe resurse tjera të bashkësisë dhe hulumtimit, planifikim dhe formulim të politikave dhe vlerësim.

Në fazën e gjykimit dhe shqiptimit të aktgjykimit, gjykatës duhet t'i mundësohet ta shfrytëzojë raportin e përpiluar për statusin social të kryesit para se të sjellë vendim. Gjykata gjatë vendimmarrjes duhet tu marrë parasysh nevojën e fëmijës për riedukim, mbrojtjen e interesave të komunitetit dhe interesave të viktimës. Ndër masat e propozuara të përfshira me Rregullat e Tokios janë: sanksionet verbale (qortim ose vërejtje), dënimi me kusht në liri, dënimi me para, dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, konfiskimi, probacioni, puna në dobi të përgjithshme, dërgimi në qendër disiplinore, paraburgimi shtëpiak dhe të tjera.

Këto rregulla parashohin që sistemi i drejtësisë të përmbajë në masë të konsiderueshme të sanksioneve në komunitet si në fazën para procedimit gjyqësor, ashtu edhe pas shqiptimit të dënimit, të shmanget sa më shumë nga dënimi me burgim në rastet e panevojshme, shkelësit e

²⁴ Лажетик-Бужаровска, Гордана; Нанев, Лазар; Кошевалиска, Олга, Меѓународни документи за спроведување на малолетничката правда, Современи текови во постапувањето со малолетниците. – Кавадарци, 2012, fq.37

ligjit të japin llogari në komunitet dhe shmangien nga proceset formale kur kjo është e mundur (drejtësia restauruese), inkurajimi i përfshirjes së komunitetit në zbatimin e sanksioneve në komunitet. Rregullat e theksojnë nevojën e shteteve nënshkruese t'i pranojnë masat e mosarrestimit me të cilat arrihet balanc ndërmjet të drejtave të secilit delikuent veçmas, të drejtat e viktimave dhe kujdesi i shoqërisë për sigurinë e përgjithshme dhe preventimin e kriminalitetit.

Rregullat e Tokios i definojnë masat e mbrojtjes juridike dhe të drejtat të cilat i takojnë fëmijës gjithmonë kur atij i përcaktohen masa të mosarrestimit. Rregullat gjithashtu, nxisin shfrytëzimin e masave të cilat zbatohen para gjykimit (masat e diversionit) me dhënien e autorizimeve prokurorisë, e në bashkëpunim me policinë dhe organet tjera, ta lirojnë kryesin ose t'i përcaktojnë zbatimin e masës përkatëse alternative. Rregullat sugjerojnë zbatimin e formave të caktuara të mosarrestimit të cilat mund të zbarohen dhe parashohin standarde minimale për zbatimin e tyre. Rregullat e Tokios nxisin edhe ndërmarrjen e masave ndaj fëmijës pasi e ka mbajtur dënimi me burg që t'i ndihmohet për riintegrimin e ti më të suksesshëm dhe atë: strehim në institucione ku do t'i ofrohet ndihma për risocializim (*half-wayhouses*), lirim me qëllim të punë ose arsimimit, lirim me kusht, dënime më të shkurtra dhe falje. Që të sigurohet fleksibilitet më i madh në pajtim me natyrën dhe peshën e shkeljes ligjore të kryer, e me qëllim që të shmangët shfrytëzimi i panevojshëm i dënimeve me burg, sistemi i legjislacionit penal duhet të sigurojë spektër të gjerë të masave të mosarrestimit. Numri dhe lloji i masave të mosarrestimit duhet të përcaktohet ashtu që edhe më tej do të jetë i mundshëm dënimi përkatës. Masat e mosarrestimit duhet të zbatohen në pajtim me principin e intervenimit minimal.

Sipas rregullave të Tokios, parashikimi, definimi dhe realizimi i masave të mosarrestimit rregullohet me ligj. Zgjedhja e masave të mosarrestimit bazohet në kritere të përcaktuara për natyrën dhe peshën e shkeljes ligjore dhe për personalitetin e shkelësit të ligjit, për qëllimin e dënimit dhe të drejtat e viktimës. Organet gjyqësore dhe organet tjera kompetente duhet të kenë të drejtë diskrecionale t'i ndjekin të gjitha fazat e procedurës gjyqësore dhe të sigurojnë përgjegjësi të plotë të të gjithë anëtarët në proces në pajtim me ligjin.

Vendimet për zbatimin e masave alternative të dënimit me burgim (masat e mosarrestimit) i nënshtrohen revizionit nga ana e gjykatës ose ndonjë organi tjetër kompetent, e me kërkesë të shkelësit të ligjit. Shkelësit e ligjit kanë të drejtë të parashtrijnë kërkesë dhe të parashtrijnë ankesë deri të gjykata ose ndonjë organi tjetër kompetent lidhur me çështjet të cilat ndikojnë në realizimin e të drejtave të tyre, e që janë në lidhje me zbatimin e masave alternative të dënimit me burgim (masat e mosarrestimit). Duhet të sigurohet mekanizëm përkatës për parashtrimin e kërkesës ose parashtrimin të ankesës dhe në qoftë se kjo është e mundur për procedimin e ankesave të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht. Gjithmonë duhet të mbrohet dinjiteti i shkelësve të ligjit të cilëve u janë shqiptuar masat alternative të dënimit me burgim (masat e mosarrestimit). Gjatë zbatimit të masave alternative (masat e mosarrestimit) të drejtat e shkelësve të ligjit nuk duhet të kufizohen në masë më të madhe nga ajo që e ka paraparë masave alternative të dënimit me burgim (masat e mosarrestimit) organi kompetent i cili e ka sjellë vendimin fillestar lidhur me atë masë. Gjatë zbatimit të masave alternative të dënimit me burgim (masat e mosarrestimit) respektohet e drejta e privatësisë së shkelësit të ligjit si dhe e drejta e privatësisë së anëtarëve të familjes së tij. Të dhënat personale të shkelësit të ligjit janë të natyrës konfidenciale dhe nuk janë të qasshme për personat tjerë. Qasje deri të këta të dhëna kanë vetëm personat të cilët janë të involvuar drejtpërdrejtë në zgjedhjen e rastit ose persona të tjerë të autorizuar.

2. Rekomandimet e Këshillit të Europës

Rekomandimi R(87)20²⁵ për reagimin social ndaj delikuencës së të miturve të Komitetit të ministrave të Këshillit të Europës i miratuar në vitin 1987 i thekson kërkesat në vijim: të gjitha masat ndaj tyre duhet të kenë karakter edukativ, pasi që bëhet fjalë për persona në zhvillim; reagimi social ndaj delikuencës së të miturve duhet t'i marrë parasysh personalitetin dhe nevojat specifike të fëmijës, ndërsa trajtimi i specializuar duhet të bazohet në Konventën për të drejtat e fëmijës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare; sistemi i sanksioneve duhet të inspironet nga edukimi dhe integrimi social si qëllim kryesor dhe sa është e mundur më shumë,

²⁵http://archivio.transnazionalita.isfol.it/file/CoE_Rec_R87-20%20Eng.pdf

të heqë dorë nga masat të cilat përbëhen nga heqja e lirisë; masat ndaj fëmijëve duhet të zbatohen në rrethin natyror të tyre dhe duhet të përfshihet komuniteti, veçanërisht në nivel lokal. Trajtimi institucional duhet të ketë sa më pak kufizime dhe të jetë i lokuar sa më afër familjes. Për rastet kur duhet të shqiptuar heqja e lirisë, preferohet sistemi në gjysmë liri dhe lirimi me kusht; gjykatësi duhet t'i arsyetojë shkaqet e shqiptimit të dënimit me burg për fëmijë; gjatë mbajtjes së dënimit me burg për fëmijë, fëmijët duhet të jenë të ndarë nga të rriturit, programi për risocializim duhet të bazohet në trajnim edukativ dhe profesional, e duhet të krijohen kushte për ndihmë edukative pas lirit dhe ndihmë për riintegrimin e fëmijës. Gjithmonë kur është e mundur, burgju për fëmijë duhet të zëvendësohet me masa alternative të tipit: mbikëqyrje dhe ndihmë probacioni, aksion intensiv edukativ, riparim të dëmit të shkaktuar me veprën penale dhe punë në dobi të përgjithshme.

Rekomandimi për mënyrat e reja të trajtimit të delikuencës së të miturve Rec(2003)20²⁶ të Komitetit të ministrave të Këshillit të Europës të vitit 2003 pëmban përcaktime të reja penale-politike në kërkim të përgjigjes për problemet e zhvillimit të shpejtë të saj në përgjithësi, e veçanërisht rritja e formave të dhunshme të saj, nga të cilat rëndësi të veçantë ka kërkesa për zgjerimin e përgjegjësisë së sjelljes delikuede të fëmijës edhe ndaj prindërve të fëmijës, si dhe zbatimi i masës së reparacionit të viktimave nëpërmjet procedurës së ndërmjetësimit. Rekomandimet vënë në fokusin e interesit edhe trajtimin e veçantë të kategorive të posaçme të fëmijëve në konflikt me ligjin, siç janë recidivistët, përdoruesit e drogave dhe alkoolit dhe pjesëtarët e grupeve të organizuara të fëmijëve nën moshën 14 vjeçare. Mënyrat e reja paraqesin një spektër të gjerë të masave dhe aktiviteteve, të cilat përfshijnë: alternativa të procedurës formale, zhvillimin e sanksioneve në komunitet, probacioni dhe mënyra të ngjashme për format e rënda të delikuencës, proporcionalitet dhe klasifikim të masave në varësi nga faza zhvillimore dhe përgjegjësia individuale e fëmijës, involvimin e prindërve në zbatimin e masave të mbikëqyrjes, zbatimin e masave edukuese ndaj personave madhor të rinj, largimin e pengesave për rehabilitim të personave madhor të rinj, shlyerjen e të dhënave për dënimin në evidence e dënimeve, përgatitjen për riintegrim që nga dita e parë e heqjes së lirisë së fëmijës.

²⁶ https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805df0b3

Rekomandimi CM/REC(2008)11²⁷ për shkelësit e mitur subjekt të sanksioneve dhe masave të Komitetit të ministrave të Këshillit të Europës të vitit 2008 përcakton parime të rëndësishme për t'u ndjekur nga shtetet në trajtimin e tyre ndaj të miturve. Këto përfshijnë një kërkesë që detyrimi dhe zbatimi i sanksioneve ose masave të jetë i bazuar në interesat më të mira për të miturit, të jetë subjekt i parimit të proporcionalitetit, në varësi nga serioziteti i shkeljes së bërë me veprën penale dhe të marrin parasysh moshën e fëmijës, mirëqenien fizike dhe mendore, zhvillimin, kapacitetet dhe kushtet personale. Parimet kërkojnë që masat tu përshtaten individualisht të miturve, të zbatohen pa vonesë dhe të ndjekin parimin e ndërhyrjes minimale. Të miturit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë efektive në seanca gjyqësore, si dhe të kenë të gëzojnë të gjithë të drejtat e tyre duke përfshirë privatësinë gjatë gjithë procedurës. Stafi duhet të trajnohet dhe duhet të ketë burime të mjaftueshme për të siguruar që ndërhyrja në jetën e të miturve të jetë e vlefshme. Të gjitha sanksionet duhet të jenë subjekt i inspektimit dhe monitorimit të rregullt. Gjithashtu parashohin rekomandime lidhur me kushtet e dënimit të cilat duhet të sigurohen me ligj, të caktuara në politika institucionale dhe të vëzhgohen në praktikë në të gjitha vendet anëtare.

3. Dokumentet tjera ndërkombëtare dhe regjionale të rëndësishme për drejtësinë e fëmijëve

Për të drejtat e fëmijëve të përfshira edhe në konventa tjera ndërkombëtare me rëndësi janë edhe normat që kanë të bënë lidhur me mbrojtjen penalo-juridike të tyre. Të tilla janë, për shembull:

1. Deklarata e të drejtave të njeriut e Kombeve të bashkuara të vitit 1948 e cila i definon të drejtat themelore të cilat i kanë të gjitha qeniet njerëzore, pa asnjë lloj diskriminim. E njejta bëri ndikim të madh dhe përfaqësoi bazë për miratimin e një numri të madh të instrumenteve, standardeve dhe udhëzimeve në sferën e të drejtave të njeriut.

2. Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut e vitit 1950, i identifikon të drejtat dhe liritë e patjetërsueshme, të cilat i posedon secili njeri dhe i

²⁷ [https://www.unicef.org/tdad/councilofeuropejrec08\(1\).pdf](https://www.unicef.org/tdad/councilofeuropejrec08(1).pdf)

obligon shtetet nënshkruese, ti garantojnë dhe mbrojnë këta të drejta, pa asnjë lloj diskriminimi. Janë miratuar edhe 14 protokolle, me të cilat ndryshohen disa nga nenet origjinale ose shtohen disa të drejta dhe masa të sigurisë plotësuese. Për shkeljen e të drejtave të parapara me Konventë, kompetente është Gjykata europiane e të drejtave të njeriut, ndërsa çdo individ (duke përfshirë këtu edhe fëmijën) ose një grup individësh, para gjykatës mund të parashtrajnë padi kundër shtetit të caktuar nënshkrues, duke e theksuar llojin e shkeljes së të drejtave të garantuar me Konventë.

3. Konventa e Kombeve të bashkuara për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese e vitit 1984 (së bashku me Protokollin fakultativ të vitit 2002) parasheh ndalimin e torturës pa dallim të kushteve dhe i obligon shtetet nënshkruese të ndërmarrin masa me të cilat do të pengohet çdo lloj torture dhe çfarëdo lloj trajtimi të ashpër, çnjerëzor ose poshtërues. Konventa kërkon nga shtetet, t'i hetojnë dhe penalisht t'i ndjekin të gjitha rastet e supozuara të torturës dhe të sigurojnë trajnime për parandalimin e torturës për të gjithë pjesëtarët e organeve për zbatimin e ligjit dhe pjesëtarët e armatës. Parasheh themelimin e Komitetit për parandalimin e torturës, i cili ndjek dhe kontrollon zbatimin e Konventës dhe nga shtetet kërkon njoftime të rregullta në aspekt të implementimit të tyre. Me protokollin fakultativ parashihet vendosja e mekanizmave preventive nacionale për parandalimin e torturës, të obliguara edhe për vizitimin e vendeve ku personat e mbajnë paraburgimin, si dhe për pranimin e të gjitha ankesave në aspekt të rasteve të supozuara të torturës dhe hetimin përkatës të tyre. I njëjti parasheh edhe themelimin e Nënkomitetit për parandalimin e torturës, i cili ka të drejtë të vizitojë të gjitha vendet ku ka persona të arrestuar dhe të burgosur në vendet nënshkruese.

4. Konventa evropiane për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe poshtërues e vitit 1987. Në bazë të nenit 3 në mënyrë plotësuese e përforcon mbrojtjen e njerëzve dhe torturën eventuale, trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtërues dhe e themelon Komitetin evropian për parandalimin e torturës, i cili ka autorizim të vizitojë në të gjitha vendet ku ka persona të arrestuar dhe të burgosur dhe të dorëzojë raporte deri te shtetet për konstatimet e tyre

6. Udhëzimet e Komitetit të ministrave pranë Këshillit të Evropës në aspekt të drejtësisë miqësore (sipas masës) së fëmijës të vitit 2010. Janë krijuar udhëzime për trajtimin dhe masat të cilat duhet të ndërmerren për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë fëmijëve të cilët vijnë në kontakt me organet e jurisprudencës në cilësi të kryesit, viktimës, dëshmitarit dhe personave të tretë në procedurë (për shembull, në rast të kujdestarisë). Ata përmbajnë parime të përgjithshme dhe udhëzime specifike për secilën fazë të procesit gjyqësor.

KAPITULLI V

Pozita juridike e delikuentëve të mitur ne legjislacionin vendas

Pozita e fëmijëve atëherë kur paraqiten si kryes të veprave penale në të drejtën penale të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të analizohet në dy periudha. Periudha e parë, pas Luftës së dytë botërore kur Republika e Maqedonisë së Veriut, atëherë Republika socialiste e Maqedonisë, ishte pjesë përbërëse e Federatës jugosllave dhe legjislacioni i saj penal vlente edhe në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo është periudha kur në Kodin e parë penal të sjellë ne vitin 1953 është mbajtur koncepti klasik retributiv dhe represiv në aspekt të pozitës së të miturve, dhe Kodi penal i vitit 1960 i cili përpiqet t'i përfshijë dhe t'i fusë në legjislacion të arriturat e teorisë, shkencës dhe legjislacionit në mbarë botën. Pas vitit 1960 i mituri dhe kriminaliteti i të miturve bëhen lëndë interesimi, kështu që edhe legjislacioni edhe kriminologjia hulumtuese fillon të merret në mënyrë më intensive me këtë dukuri. Periudha e dytë pas vitit 1990 me pavarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe qasjen në drejtim të ndërtimit të legjislacionit të vet penal. Kjo periudhë karakterizohet me punë me intensive në krijimin e një Ligji për të drejtën e të miturve, i cili bën përpjekje "t'i nxjerrë" të miturit nga e drejta penale e përgjithshme dhe tu caktojë pozitë të ndryshme nga të rriturit atëherë kur ata paraqiten si kryes të veprave penale.

Do të thotë, në periudhën deri vitin 1960 të miturit në legjislacionin juridiko penal maqedonas kishin pozitë identike si edhe të rriturit, me një sistem më të pasur masash edukuese (masa edukuese-përmirësuese) kur bëhej fjalë për të miturit më të rinj (nga mosha 14 deri 16 vjeçare). Në ndryshimet e Kodit penal jugosllav të vitit 1960 bëhet një hap i madh me atë që të miturit në Kodin penal dhe Ligjin për procedurë penale futen në kapituj të veçantë. Me këta ndryshime parashihen dy kategori të të miturve për nga mosha: të mitur më të rinj dhe të më vjetër, e më vonë parashihet edhe kategoria të rritur të rinj ndaj të cilëve mund të zbatohen masa edukuese.

Pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratohet Kodi i parë penal i Republikës së Maqedonisë në vitin 1996, i cili në fakt nuk solli ndryshime dhe risi esenciale, e më së paku solli risi në aspekt të pozitës së të miturve si kryes të veprës penale. Ky Kod penal ka

pësuar më shumë ndryshime dhe plotësime. Me të rëndësishme janë ata të vitit 2004, kur parashihen më shumë ndryshime dhe plotësime të rëndësishme si ne pjesën e përgjithshme ashtu dhe në atë të veçantë të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mund të thuhet se ky Kod penal nuk solli ndryshime esenciale lidhur me pozitën e të miturve, mirëpo u miratuan dispozita të caktuara të cilat mbrohet pozita e të miturit në përgjithësi, edhe nga dhuna në familje si pasojë e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të fëmijëve dhe të miturve, mirëpo edhe si pasojë e rritjes së kriminalitetit të dhunës në përgjithësi dhe në familje ne veçanti.

Dispozitat lidhur me të miturit kësaj radhe vihen në kapitull të veçantë (kapitulli i gjashtë) nën titullin: masat edukuese dhe dënimi i të miturve. Mbahet sistemi i njëjtë i zbatimit të masave edukuese dhe dënimeve, mirëpo, regjistri i sanksioneve zgjerohet me mundësinë e zbatimit të masave alternative.

Në nenin 71 të Kodit penal ka qenë i përcaktuar edhe nocioni i fëmijës, si i mitur i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur 14 vjet, ndërsa në nenin 82, kategoria e personit madhor të ri kishte të bëjë me kryesin madhor të veprës penale i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur 21 vjet, do të thotë person nga mosha 18 deri 21 vjet.

Sipas nenit 91a të Kodit penal gjykata mund me kusht ta ndërpresë procedurën për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me para dhe dënimi me burg deri 3 vjet (do të thotë pesha e veprës penale e shprehur nëpërmjet dënimit) dhe i mituri nëse ka shprehur pendesë dhe i ka evituar pasojat e veprës, e ka kompensuar dëmin, është pajtuar me të dëmtuarin, dhe ai është pajtuar me ndërprerjen e procedurës. E gjithë kjo nën kusht, i mituri në afat prej dy vitesh të mos kryejë veprën e njëjtë penale ose vepër penale më të rëndë. Masa e dytë alternative është puna në dobi të përgjithshme në afat prej 5 deri 100 orë.

Me miratimin e Ligjit për të drejtën e të miturve²⁸ (Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 87/07, 12.05.2007) u parapa qasje e re lidhur me veprimin ndaj fëmijëve dhe të miturve, duke u nisur nga parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve, si dhe

²⁸ Nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji ndërpriten të vlejné dispozitat nga neni 70 deri te neni 96 nga Kodi penal ('Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë', numër 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006 dhe 73/2006)

dokumentet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe implementimi i tyre. Në fakt ky ligj paraqiste një përmbledhje rregullash të cilat u takonin dy kategorive: të drejtës së të miturve (juvenile justice system) dhe mirëqenies së fëmijëve (child welfare).

Me Ligjin për të drejtën e të miturve sistemi i sanksioneve penale ndaj fëmijëve u pasurua me lloje të reja të sanksioneve të cilat mundësojnë trajtim individual dhe preventivë të theksuar speciale, si qëllime kryesore ndaj të cilat synon legjislacioni penal ndaj të miturve. Ligji për të drejtën e të miturve në qasjen për përcaktimin dhe zbatimin e masave dhe sanksioneve ndaj të miturve, i përpunonte parimet të parapara në Konventën për të drejtat e fëmijëve, të miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1989. Me qasjen e veçantë ndaj drejtësisë së të miturve theksohej mirëqenia e fëmijës dhe të miturit dhe parashihte se gjatë çdo veprimi ndaj të miturit, pa marrë parasysh nëse ndaj tij zbatohet masë ose sanksion, duhet të mbahet llogari për mbrojtjen e interesave të të miturit dhe të realizohet kontribut në procesin e riedukimit dhe zhvillimit të tij të drejtë. Ligji për të drejtën e të miturve lejonte që të miturit t'i merren ose kufizohen të drejta të caktuara mirëpo, vetëm në masën që i përgjigjet shkallës së arritur të zhvillimit të personalitetit të tij dhe nevojën për eliminimin e gjendjes që ndikon që ai të kryejë vepra penale.

Në Ligjin për të drejtën e të miturve të vitit 2007 definimi i kategorive të cilat i përfshinte ai ishte i dyfishtë dhe ai njihje kategorinë “fëmijë” dhe kategorinë “i mitur”. Mirëpo për shkak të harmonizimit me instrumentet ndërkombëtare, ligjvënësi vendosi ta përdorë termin “fëmijë” në vend të termit “i mitur” në Ligjin për drejtësi për fëmijë (Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 148/13, 29.10.2013).

Dokumentet ndërkombëtare të cilat e tangojnë çështjen e mbrojtjes së fëmijëve theksojnë se veçanërisht është më rëndësi të vepohet ndaj fëmijëve në ambientin natyror të fëmijës, atje ku ai ndihet i sigurt dhe i mbrojtur, gjatë së cilës është me rëndësi veprimi i herët psiko-social. Andaj, zgjidhjet e fundit të parapara në Ligjin për drejtësi për fëmijë të vitit 2013 i cili paraqet kontinuitet të përpjekjeve për krijimin e drejtësisë së fëmijëve si një disiplinë të veçantë teorike dhe praktike, rëndësi të veçantë i japin formave joformale të veprimit me fëmijët që nënkupton interaksion dhe përfshirje aktive të një rrethi më të gjerë të subjekteve të cilat sipas sistemit të kompetencave mund të kontribuojnë në realizimin e mbrojtjes së

fëmijëve. Drejtësia restorative ndaj fëmijëve është aspekt kyç i politikës sociale, i cili ka të bëjë me një numër gjithnjë më të madh të fëmijëve të pambrojtur të cilët shpesh herë janë të marginalizuar nga ana e shoqërisë.

Koncepti “drejtësi për fëmijë” i përfshin fëmijët të cilët kanë rënë ndesh me ligjin (gjegjesisht, fëmijë të cilët janë regjistruar, të akuzuar ose njohur si shkelës të kodit penal), fëmijë të cilët janë gjetur në rolin e viktimës ose dëshmitarëve të krimit, si dhe fëmijë në rrezik nga përfshirja në sistemin juridiko-penal (qoftë për shkak të gjendjes sociale ose për shkak se kanë bërë ndonjë vepër, e cila do të konsiderohej vepër penale, nëse fëmija do të ishte i moshës me përgjegjësi penale). Mund të thuhet se ky është koncept gjithëpërfshirës, i orientuar në favor të interesave më të mira të të gjithë fëmijëve, të cilët kanë rënë në kontakt me sistemin juridik dhe sistemet tjera relevante. Ai përfshin aspekte të ndryshme, siç është preventiva, diversioni, rehabilitimi, shërbimet për ofrim të ndihmës dhe mbështetja e masave të mbrojtjes. Koncepti “drejtësi për fëmijë” dallon nga termi “drejtësi për të mitur”, për shkak se nuk i përfshin vetëm fëmijët, të cilët kanë rënë ndesh me ligjin, por të gjithë fëmijët, që janë në kontakt me ligjin, për shembull fëmijët viktime dhe fëmijët dëshmitarë²⁹.

Definicioni themelor në Ligjin për drejtësi për fëmijë është se me fëmijë nënkuptohet çdo person në moshë deri 18 vjet. Me qëllim që të përkufizohen kategoritë e ndryshme të fëmijëve sipas moshës, veprimeve të ndërmarra, gjendjes së rrezikut, reagimeve ndëshkuese të mundshme, masave dhe sanksioneve të cilat mund të përcaktohen, gjegjesisht shqiptohen, nocioni i fëmijës mund të kategorizohet në 3 grupe:

1. Kategoria e fëmijëve në rrezik

- Fëmijë në rrezik është çdo fëmijë që i ka mbushur shtatë vjet dhe nuk i ka mbushur 18 vjet me pengesa trupore ose pengesa të zhvillimit mental, viktimë e dhunës, i lënë pas dore nga aspekti edukues dhe social, i cili gjendet në gjendje të atillë në të cilën është penguar ose është pamundësuar realizimi funksionit edukues i prindit/ëve ose tutorit/ëve, i cili nuk është përfshirë në sistemin e arsimimit dhe edukimit, i përfshirë në lypje, endje ose prostitucion, i cili përdor droga dhe substanca tjera psikotrope dhe prekursorë ose alkool, e i cili për shkak të gjendjeve

²⁹Уницеф, Правда за децата-Прирачник, 2010

të këtilla është ose mund të bie ndesh me ligjin si viktimë ose si dëshmitar i veprimit që me ligj është paraparë si kundërvajtje ose veprim që me ligj është paraparë si vepër penale,

- fëmijë në rrezik deri në moshën 14 vjet është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprës së paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose burg mbi tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur shtatë vjet, e nuk i ka mbushur 14 vjet,

- fëmijë në rrezik nga 14 deri 18 vjet është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit, të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri në tri vite ose vepër e paraparë me ligj si kundërvajtje, i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet³⁰,

Nga definicionet e pranuar del se ligjvënësi është përcaktuar për kuptimin e dyfishtë të “rrezikut” i cili ka të bëjë me grupmoshën 7 deri 18 vjet.

Sipas kuptimit të parë rreziku përfshin faktorët e ndryshëm të rrezikut të cilët e rrezikojnë rritjen, zhvillimin, edukimin dhe socializimin e drejtë të fëmijës. Nevoja e përcaktimit të gjerë të faktorëve të rrezikut del nga tentimi i ligjvënësit ta parandalojë kontaktin e fëmijës në rrezik me organet e hetuesisë penale dhe kryesit e veprave penale. Pikërisht për këtë shkak faktorët e rrezikut i përcakton si gjendje për shkak të të cilave fëmija në rrezik mund të vijë në kontakt me ligjin dhe atë ose si viktimë ose si dëshmitar i një veprimi i cili me ligj është paraparë si kundërvajtje ose si vepër penale. Tentimi është që të mënjanohet përfshirja e fëmijës në sistemin e drejtësisë penale si pjesëmarrës në të, e jo si kryes i veprës penale.

Kuptimi i dytë i rrezikut është mungesa e përgjegjshmërisë penale në rastet kur fëmija i moshës 7 deri 14 vjet ka ndërmarrë veprim i cili me ligj është paraparë si vepër penale dhe për të cilën është paraparë dënim me para ose burg mbi 3 vjet, gjegjësisht veprim i cili me ligj është i paraparë si kundërvajtje. Del se kur fëmija i moshës 7 deri 14 vjeçare do të ndërmarrë veprime të cilat e përbëjnë figurën e ndonjë vepre penale, ai nuk konsiderohet si kryes i veprës penale dhe ndaj tij nuk zbatohet procedurë penale klasike dhe formale, por konsiderohet si fëmijë në rrezik dhe ndaj tij mund të ndërmerren vetëm masa të ndihmës dhe të mbrojtjes. Zbatimi i parimit të proporcionalitetit ju mundëson organeve të hetuesisë të mos iniciojnë procedurë

³⁰ Neni 19 i Ligjit për drejtësi për fëmijë (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 148/13...152/19)

gjyqësore dhe ndaj fëmijës në rrezik nga mosha 14 deri 18 vjet i cili ka ndërmarrë veprim i cili me ligj është paraparë si vepër penale dhe për të cilën është e përcaktuar dënim me para ose me burg deri 3 vjet ose veprim i cili me ligj është paraparë si kundërvajtje. Në këtë mënyrë rreziku zgjerohet edhe ndaj fëmijëve të moshës nga 14 deri në 18 vjeçare, por vetëm në rastet kur ata do të kryejnë vepër më të lehtë penale e cila matet sipas dënimit të paraparë në Kodin penal³¹.

2. Kategoria e fëmijëve të cilët i nënshtrohen përgjegjësisë penale:

- Fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 14 deri 16 vjet është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 16 vjet.

- Fëmijë që bie ndesh me ligjin mbi 16 vjet është çdo fëmijë i cili në kohën e kryerjes së veprimit të paraparë me ligj si vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg mbi tri vite, i ka mbushur 16 vjet e nuk i ka mbushur 18 vjet³²,

Në këtë grup bëjnë pjesë dy kategoritë e moshës që në Ligjin për të drejtën e të miturve të vitit 2007 ishin të definuar si “të mitur të rinj” dhe si “të mitur të rritur”. Esenca e përgjegjësisë penale ngel e njejtë, dhe vetëm është pranuar terminologji e re, me një dallim në aspekt të përgjegjësisë penale vetëm për vepra penale më të rënda për të cilat është paraparë dënim me burg mbi 3 vjet, ndërkaq për veprat penale më të lehta të njejtët trajtohen si fëmijë në rrezik³³.

3. Kategoria e fëmijëve viktima

Fëmijë viktimë është çdo fëmijë i moshës deri 18 vjet i cili ka pësuar dëm, duke përfshirë lëndim fizik ose mental, pësim emotiv, humbje materiale ose shkelje tjetër ose rrezikim të të drejtave dhe interesave si pasojë e veprimit të kryer me ligj të paraparë si vepër penale³⁴. Ligji për drejtësi për fëmijë vëmendje të veçantë i kushton fëmijëve viktima si persona

³¹ Нанев, Лазар; Кошевалиска, Олга, Малолетничко казнено право, Штип, 2018, fq. 20

³² Neni 19 i Ligjit për drejtësi për fëmijë (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 148/13...152/19)

³³ Нанев, Лазар, Кошевалиска, Олга, Малолетничко казнено право, Штип, 2018, fq. 20

³⁴ Neni 19 i Ligjit për drejtësi për fëmijë (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 148/13...152/19)

deri në 18 vjet të mbushura. Që një fëmijë të fitojë statusin e viktimës nevojitet të këtë pësuar dëm, lëndim, vuajtje, humbje ose rrezikim të të drejtave dhe interesave të tij si pasojë e veprës penale të kryer. Në korelacion me definimin e fëmijës në rrezik bëhet e qartë se është reaguuar vonë në zbulimin dhe tejkalimin e faktorëve të rrezikut prandaj dhe fëmija ka ardhur në kontakt me ligjin si viktimë e veprës penale.

Ligji për drejtësi për fëmijë në nenin 19 sqaron edhe nocionin e personit më të ri të moshës madhore, sipas të cilit bëhet fjalë për person i cili gjatë kohës së gjykimit për veprim të paraparë me ligj si vepër penale, i ka mbushur 18 vjet e nuk i ka mbushur 21 vjet,

Duke paraparë trajtim të veçantë për këtë kategori të kryesve të veprave penale, ligjdhënësi edhe një herë e vërteton se moshë dhe pjekuria nuk zhvillohen në vijë të drejtë tek të gjithë personat, prandaj paraqitet nevoja për ofrimin e një mundësie të fundit për trajtim dhe dënim më të butë ndaj personave të cilët sapo kanë kaluar në moshë madhore. Ligji për drejtësi për fëmijë e ka mbajtur trajtimin më të butë ndaj personave të moshës 18 deri 21 vjet dhe atë në aspekt të mundësisë të shmangët gjykimi, nëse ai person ka mbushur 21 vjet në kohën e gjykimit, e nëse në kohë të gjykimit nuk ka mbushur 21 vjet, mund ti gjykohe vetëm për vepra penale më të rënda, mirëpo do t'i shqiptohet masa e mbikëqyrjes së përforcuar ose masa edukuese e entit³⁵.

Siç u përmend edhe më lartë kategorizimi i fëmijëve në grupe të ndryshme, në varësi nga moshë e tyre, e pastaj edhe për nga pesha e veprës penale dhe sanksioni i paraparë për to, mirëpo edhe gjendja psiko-fizike në të cilën gjendet fëmija, pjekuria e tij dhe aftësia për t'i kuptuar pasojat e veprimeve të veta është bazë për status të ndryshëm juridiko – penal. Në varësi nga kategorizimi i këtillë, në sistemin e drejtësisë për fëmijë janë paraparë lloje të ndryshme të sanksioneve në varësi nga kategoritë e ndryshme të moshës dhe pesha e veprës penale të kryer, E një rëndësie të veçantë është gradacioni i fëmijëve sipas moshës në grupe të ndryshme (si fëmijë, si fëmijë në rrezik, fëmijë në rrezik deri 14 vjet, fëmijë në rrezik nga moshë 14 deri 18 vjet, fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 14 deri 16 vjet, fëmijë që bie ndesh me ligjin nga 16 deri 18 vjet, fëmijë viktimë në moshë deri 18 vjet dhe person më i ri i moshës madhore nga 18 deri 21 vjet) e cila i jep kuptim dhe rëndësi sistemit të sanksioneve të cilat mund tu

³⁵ Нанев, Лазар, Кошевалиска, Олга, Малолетничко казнено право, Штип, 2018, fq. 21

shqiptohen fëmijëve kryes të veprimeve të cilat me ligj janë të paraparë si vepra penale. Natyra e ndryshme dhe serioziteti i sanksioneve i mundëson gjykatës të zgjedhë dhe zbatojë sanksion përkatës në varësi nga shkalla e zhvillimit, moshës dhe pjekurisë së fëmijës, e me të cilin sipas vlerësimit të gjykatës do të realizohet qëllimi i dënimit.

KAPITULLI VI

Struktura e sanksioneve penale dhe ekzekutimi i sanksioneve ndaj fëmijëve kur paraqiten si kryes të veprave penale

Sistemi i sanksioneve ndaj fëmijëve në shtetin tonë por edhe ne legjislacionet e shteteve të zhvilluara evropiane është komponentë formale e konceptit më të gjerë i cili, përveç rolit aktiv të bashkësisë dhe involvimit të saj (community-based strategy) në preventivin e delikuencës së fëmijëve, i përfshin edhe organet dhe trupat e policisë, prokurorisë, jurisprudencës, shërbimeve të probacionit dhe institucioneve ndëshkuese. Tendenca e ligjit për drejtësi për fëmijë është që nga masat dhe sanksionet e parapara në të përparësi t'i jepet masave preventive, mbrojtëse dhe edukuese, ndërsa sanksionet të zbatohen si përjashtim. Theksohet fakti se për shkak të vetive të veçanta të fëmijës, nevojitet pozitë e tij e veçantë dhe trajtim i veçantë. Sanksionet të cilat mund t'i shqiptohen fëmijës si kryes i veprës penale dallojnë në varësi nga natyra e veprës së kryer, gjegjësisht a bëhet fjalë për vepër penale apo kundërvajtje.

Për vepër penale të kryer nga fëmija mund të shqiptohet njëri nga këto lloje të sanksioneve:


1. masa edukuese
2. dënime

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhëna për numrin e masave edukuese dhe dënimit me burg të shqiptuara në periudhën 2009-2018

Tabela 7.

	Numri i përgjithshëm i fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale	Masa edukuese	Dënim-Burg për fëmijë
2009	748	734	14
2010	547	538	9
2011	722	720	2
2012	556	549	7
2013	473	473	-
2014	461	458	3
2015	348	340	8
2016	468	464	4
2017	368	363	5
2018	330	327	3

Grafikon 4.



Nga tabela numër 4 mund të konstatomë se në vitin 2009 nga gjithsej 748 fëmijë ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale, 734 prej tyre janë masa edukuese, ndërsa 14 fëmijëve u është shqiptuar burg për fëmijë, në vitin 2010 nga gjithsej 547 fëmijë ndaj të cilëve janë

shqiptuar sanksione penale, 538 prej tyre janë masa edukuese dhe 9 prej tyre burg për fëmijë, në vitin 2011 nga gjithsej 722 fëmijë ndaj të cilëve është shqiptuar sanksion penal, 720 prej tyre janë masa edukuese dhe vetëm 2 prej tyre burg për fëmijë. Në vitin 2013 nga 473 fëmijë ndaj të cilëve është shqiptuar sanksion penal, nga të cilat po aq janë masa edukuese dhe asnjë fëmija nuk i është shqiptuar burg për fëmijë. Në vitin 2014 nga 461 fëmijë ndaj të cilëve është shqiptuar sanksione penale, 458 janë masa edukuese dhe vetëm 3 fëmijëve u është shqiptuar burg për fëmijë, në vitin 2015 nga gjithsej 348 fëmijë ndaj të cilëve është shqiptuar sanksion penal, 340 janë masa edukuese dhe 4 prej tyre burg për fëmijë, në vitin 2017 nga gjithsej 368 fëmijë ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale, 363 prej tyre janë masa edukuese dhe 5 prej tyre janë burg për fëmijë dhe në vitin 2018 nga gjithsej 330 fëmijë ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale, 327 prej tyre u janë shqiptuar masa edukuese dhe vetëm 3 prej tyre burg për fëmijë.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë mund të konstatojmë se në numrin më të madh zbatohen masa/sanksione që nuk përfshijnë heqjes të lirisë, që korrespondon me qëllimet e Ligji për drejtësi për fëmijë.

1. Masat edukuese

Fëmijës mbi moshën 14 vjet për veprim që me ligj është paraparë si vepër penale mund t'i shqiptohen masat edukuese në vijim:

1. masa qortim ose dërgim në qendër për fëmijë;
 2. masat e mbikëqyrjes së përforcuar: nga ana e prindërve ose kujdestarit, familjes përkujdesëse ose nga ana e Qendrës për punë sociale dhe
 3. masat e entit: dërgim në institucione edukuese ose në shtëpi edukuese-përmirësuese
- Masa qortim ose dërgim në qendër për fëmijë shqiptohen ndaj fëmijës kur nuk ekziston nevoja për masa më të gjata të edukimit, e veçanërisht nëse ka kryer vepër penale nga mendjehetësia.

Masa të mbikëqyrjes së përforcuar shqiptohen ndaj fëmijës kur ekziston nevoja për masa të vazhdueshme të edukimit, riedukim dhe mjekimit me mbikëqyrje përkatëse, ndërsa nuk ekziston nevoja për ndarjen e plotë nga ambienti i deritanishëm.

Masat e enteve shqiptohen ndaj fëmijës kur ekziston nevoja për masa të vazhdueshme të edukimit, riedukimit ose shërimit dhe largimin e tij të plotë nga ambienti i deritanishëm. Kohëzgjatja e këtyre masave nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vjet, mirëpo më së shumti deri në mbushjen e moshës 23 vjeçare.

Gjatë zgjedhjes së masës edukuese gjykata do ta marrë parasysh moshën e fëmijës, shkallën e zhvillimit shpirtëror të tij, vetitë e tij psikike, arsyet nga të cilat është nisur fëmija për të kryer veprën, prirjet, edukimin e deritanishëm, ambienti dhe kushtet në të cilat ka jetuar, nëse ndaj tij më herët është shqiptuar masë edukuese ose dënim burgim për fëmijë dhe të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit të masës ashtu që ajo ta arrijë qëllimin e saj të përcaktuar me ligj. Qëllimi i ekzekutimit të masave edukative është mbrojtja, arsimimi, edukimi dhe riedukimi, socializimi ndihma dhe kujdesi për fëmijët që të sigurohet zhvillimi i drejtë i personalitetit të tyre³⁶.

Ekzekutimi i masave edukative është urgjent. Masat edukative ekzekutohen menjëherë pas plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor, me të cilin janë kumtuar dhe nëse nuk ekzistojnë pengesa për zbatimin e tyre.

1.1. Masat disiplinore: qortim dhe dërgim në qendër për fëmijë

1.1.1. Qortim

Qortimi shqiptohet nëse është i mjaftueshëm vetëm qortimi i fëmijës për veprën penale të kryer³⁷, pa përcaktimin e obligimeve plotësuese, ndalesave ose kufizimeve, gjegjësisht kur vetë qortimi do të sigurojë plotësimin e qëllimit të edukimit gjegjësisht riedukimit dhe zhvillimit të drejtë të personalitetit të fëmijës në të ardhmen. Qortimi në praktikë shqiptohet atëherë kur

³⁶ Neni 309 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

³⁷ Neni 39 paragrafi 1 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

veprimi i fëmijës mund të vlerësohet si tejkalim i normave të sjelljes të cilat konsiderohen si të papranueshme dhe të lejuara, ndërsa vetë fëmija aspak nuk ka qenë i vetëdijshëm se me atë cenon normë të caktuar juridike.

Në praktikë qortimi shqiptohet kur do të vlerësohet se kryerja e veprës penale sipas kuptimit të fëmijës është pjesë e asaj që quhet “lojë fëmijërore”, diçka që është interesante dhe ku mbisundon kurioziteti, e jo qëllimi i shkaktimit dëm tjetrit. Gjykata që e ka marrë vendimin me të cilin është shqiptuar masa edukuese qortim, vetë është kompetente për ekzekutimin e masës. Gjatë shqiptimit të qortimit ndaj fëmijës do t'i vihet në dije dëmi nga veprimi i tij dhe do të paralajmërohet se në rast të kryerjes së serishme të veprës penale ndaj tij mund të shqiptohet sanksion tjetër penal³⁸.

1.1.2. Dërgim në qendër për fëmijë

Fëmija do të dërgohet në qendër për fëmijë kur gjykatësi do të vlerësojë se qortimi për veprën penale të kryer është i pamjaftueshëm të arrihen qëllimet e riedukimit. Gjykata do ta shqiptojë masën edukuese dërgim në qendër për fëmijë kur do të vlerësohet se sjellja e fëmijës do të përmirësohet nëse zbatohen masa përkatëse afatshkurte të cilat do të mundësojnë ndikim ndaj personalitetit dhe sjelljes së fëmijës në të ardhmen³⁹. Do të thotë me anë të kësaj bëhen përpjekje që ai ta kuptojë natyrën e veprës së kryer dhe pasojat nga ajo. Qendra duhet të mundësojë që në afat të shkurtër, me zbatimin e metodave intensive të bëhet ndikim pozitiv ndaj personalitetit dhe sjelljes së fëmijës, të zgjidhen problemet e tij zhvillimore dhe të tejkalohen pasojat me integrimin e suksesshëm të tij në rrethin shoqëror

Qendra për fëmijë themelohet me akt të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut⁴⁰. Kjo masë edukuese mund të realizohet edhe në institucione ekzistuese të cilat i plotësojnë kushtet, e këto mund të jenë: strehimore, internate, shtëpi të vogla grupore, institucione arsimore dhe institucione tjera për punë me të rinj në vendbanimin ose vendqëndrimin e fëmijës. Në cilat

³⁸ Neni 39 paragrafi 2 i Ligjit për drejtësi për fëmijë (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 148/13...152/19)

³⁹ Neni 40 i Ligjit për drejtësi për fëmijë (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 148/13...152/19)

⁴⁰ Neni 317 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 99/19...220/19)

institucione do të organizohet qendër për fëmijë përcakton ministri i punës dhe politikës sociale në pajtim me ministrin e arsimit dhe shkencës.

Në aspekt të dinamikës së zbatimit të masës dërgim në qendër për fëmijë, Ligji për drejtësinë për fëmijë parasheh disa modalitete. Fëmija mund të dërgohet në qendër për fëmijë:

a) në numër të caktuar të orëve gjatë ditës në ditët e festës, dhe atë më së shumti në katër ditë feste njëri pas tjetrës;

b) në numër të caktuar të orëve gjatë ditës, mirëpo më së shumti një muaj, dhe

c) në qëndrim të pandërprerë në numër të caktuar të ditëve, mirëpo jo më shumë se njëzet ditë⁴¹.

Para shqiptimit të kësaj mase gjykata do të mbajë llogari për atë që më zbatimin e saj fëmija të mos humbë nga mësimi i rregullt ose puna, gjegjësisht dërgimi në qendër për fëmijë të mos sjellë në pamundësi që fëmija t'i kryejë aktivitetet e zakonshme ditore ose aktivitetet shtesë të cilat ndihmojnë në socializmin e drejtë të tij. Pas pranimit të vendimit qendra për punë sociale kompetente sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të personit të fëmijës ndaj të cilit zbatohet masa edukative në marrëveshje me qendrën për fëmijë është i obliguar në afat prej dhjetë ditësh t'i thërrasë fëmijën së bashku me prindin/ërit ose tutorin/ët të paraqiten në qendër në ditën dhe orën e caktuar, me qëllim të zbatimit të masës disiplinore. Prindi/ërit ose tutori/ët janë të obliguar të sigurojnë ardhjen e rregullt të fëmijës në qendrën për fëmijë. Nëse fëmija nuk paraqitet në kohën e përcaktuar në qendrën për fëmijë, nuk vjen rregullisht ose e ndërpret ardhjen e tij, qendra për fëmijë do ti njoftojë qendrën për punë sociale dhe gjykatën⁴² Dërgimi i fëmijës në qendrën për fëmijë në ditët e festës dhe në numër të caktuar të orëve në ditë zbatohet nga ora 8 deri 20 gjatë kohës së lirë të fëmijës

Dërgimi i fëmijës në qendër për fëmijë për qëndrim të pandërprerë në numër të caktuar të ditëve zbatohet në kohën kur fëmija është i lirë. Kjo masë zbatohet edhe kur fëmija është i angazhuar me punë gjatë së cilës vazhdon ta ndjekë shkollën ose të shkojë në punë, ndërsa nga ana e qendrës për fëmijë i sigurohen ushqim dhe strehim⁴³.

⁴¹ Neni 40 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

⁴² Neni 318 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁴³ Neni 319 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

Në qendrën për fëmijë kohën e kalon në punë dhe mësim dhe aktivitete të lira sportive dhe kulturore, nën kontrollin e personave profesionist. Në qendrën për fëmijë, fëmija realizon aktivitete të cilat i përgjigjen gjendjes së tij psikofizike, kanë karakter edukues dhe nëpërmjet tyre fiton shkathtësi, informata dhe njohuri të cilat do të ndihmojnë në të ardhmen të mos bëjë sjellje të palejuara. Fëmijët në qendrën për fëmijë duhet të respektojnë dispozitat e rendit shtëpiak lidhur me disiplinën e punës dhe urdhrat e personave profesionist. Fëmijës i cili nuk do të respektojë dispozitat e rendit shtëpiak lidhur me disiplinën e punës dhe urdhrat e personave profesionist, drejtori i institucionit do t'i shqiptojë qortim. Në qoftë se fëmija nuk vjen rregullisht në qendrën për fëmijë dhe përsërit mosrespektimin e rendit dhe disiplinës, drejtori mund që t'ia zgjasë qëndrimin edhe për dy orë në ditë. Për masën disiplinore të shqiptuar drejtori e njofton qendrën për punë sociale dhe gjykatën⁴⁴.

Në qendrën për fëmijë mbahet ditar për qëndrimin e fëmijës. Pas përfundimit të ekzekutimit të kësaj mase edukuese, qendra për fëmijë i dërgon raport qendrës për punë sociale dhe gjykatës për masat e ndërmarra dhe rezultatet e arritura në punën edukative.

Kur do të shqiptohet dërgimi në qendër për fëmijë, gjykata mund të përcaktojë që gjatë dhe pas mbarimit të kësaj mase fëmija të vihet nën mbikëqyrje të përforcuar të qendrës për punë sociale, për periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj⁴⁵.

Qendër për fëmijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut për herë të parë u hap në Shkup në vitin 2011, dhe i njëjti ishte i vendosur dhe funksiononte në kuadër të IP për përkujdesjen e fëmijëve me probleme edukuese-sociale dhe çrregullime në sjellje në Shkup, ndërkaq funksionon me Program paraprakisht të përgatitur për organizim dhe punë. Objekti i qendrës në vitin 2017 u kaplue nga zjarri dhe u vendos jashtë funksionit që pamundësonte shqiptimin e kësaj mase nga ana e gjykatave të vendit.

⁴⁴ Neni 321 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁴⁵ Neni 40 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

Në tabelën më poshtë shfaqen të dhëna nga Enti shtetëror për statistikë për shqiptimin e masave qortim dhe dërgim në qendër për fëmijë në periudhën kohore 2008-2019 ndaj fëmijëve të moshës 14 deri 16 vjet dhe fëmijëve të moshës 16 deri 18 vjet.

Tabela 8

	Fëmijë të moshës 14-16 vjet		Fëmijë të moshës 16-18 vjet		Gjithsej	
	Qortim	Dërgim në qendër	Qortim	Dërgim në qendër	Qortim	Dërgim në qendër
2009	21	/	64	/	85	/
2010	33	/	74	/	107	/
2011	27	/	65	/	91	/
2012	12	/	45	/	57	/
2013	17	/	63	/	62	/
2014	10	1	52	/	72	1
2015	14	/	65	/	79	/
2016	10	1	39	/	49	1
2017	11	/	39	/	50	/
2018	10	/	36	/	46	/

Mund të konstatojmë se në periudhën 2008-2019 gjykatat kryesisht kanë shqiptuar masën edukuese qortim. Nga tabela mund të konstatojmë se masa edukuese qortim në numër më të madh u është shqiptuar fëmijëve të moshës 16 deri 18 vjet.

Karakteristik është fakti se shqiptimi i masës dërgim në qendër është bërë vetëm dy herë nga ana e gjykatës dhe atë një herë në vitin 2014 dhe një herë në vitin 2016 dhe atë ndaj fëmijëve të grupmoshës 14 deri 16 vjet. Andaj paraqitet nevoja për përmirësimin dhe përforcimin e kushteve institucionale për zbatimin e masës disiplinore-Dërgim në Qendër për fëmijë, me çka do të nxitet edhe shqiptimi i saj nga ana e gjykatësve.

1.2. Masa të mbikëqyrjes së përforcuar

1.2.1. Masa të mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e prindit/ërve, ose tutorit/ëve

Gjykata do të shqiptojë masë të mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e prindit/ërve, ose tutorit/ëve, fëmijës i cili ka kryer veprë penale vetëm nëse vlerëson se fëmija ka kryer veprën penale, pasi që prindi/ët, ose tutori/ët kanë bërë lëshim, e kanë pasur mundësi të kryejnë mbikëqyrje mbi fëmijën, ndërkaq kanë mundësi që ta bëjnë këtë në mënyrë përkatëse. Mbikëqyrja e përforcuar e prindit/ëve, ose tutorit/ëve do të shqiptohet kur gjykatësi do të konstatojë se ka munguar roli edukues dhe kontrollues i familjes, e cila ka mundësi dhe kapacitet ta realizojë mbikëqyrjen dhe të kushtojë kujdes më të madh për sjelljen e fëmijës, problemet dhe nevojat që ai i ka e me qëllim për zbulimin e shkaqeve dhe motiveve të cilat kanë sjellë deri në kryerjen e veprës penale. Gjatë shqiptimit të kësaj mase edukuese gjykatësi për fëmijë i urdhëron prindërit gjegjësisht tutor-in/ët obligime të caktuara gjegjësisht, detyra në aspekt të masave të cilat duhet të ndërmerren për edukimin e fëmijës, për shërimin e tij dhe për eliminimin e ndikimeve të dëmshme ndaj tij të cilat kanë kontribuar që ai të kryer veprë penale. Njëkohësisht, gjykata mund t`ju japë edhe udhëzime të nevojshme në aspekt të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave. Masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e prindit/ëve gjegjësisht tutori/ët nuk përcaktohet me kohëzgjatje të caktuar por realizohet në interval kohor të paraparë me ligj i cili nuk mund të zgjasë më pak se një vit e as më shumë se tre vjet⁴⁶, me çka gjykata, në varësi nga suksesi në realizimin e obligimeve dhe detyrimeve nga ana e personave të obliguar për edukimin e fëmijës dhe përmirësimin e sjelljes së tij. Ndërprerja e masës përcaktohet në mënyrë plotësuese.

Zbatimi i masës edukuese të mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e prindit ose tutorit fillon në ditën kur gjykata kompetente do t`ua dorëzojë vendimin me të cilin është shqiptuar kjo masë me qëllim të zbatimit nga ana e prindit/ëve, ose tutorit/ëve. Prindi/ët ose tutori/ët e zbatojnë masën ashtu që mbajnë llogari të vazhdueshme dhe të plotë për edukimin e fëmijës, ndërmarrin masa për mjekimin e tij të cilat do ta pengojnë ndikimin e dëmshëm ndaj fëmijës

⁴⁶ Neni 41 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

dhe i zbatojnë urdhrat dhe udhëzimet e qendrës për punë sociale dhe gjykatës kompetente gjatë zbatimit të masës⁴⁷. Prindi/ët ose tutori/ët është i obliguar t'i mundësojë qendrës për punë sociale zbatimin e kësaj mase. Prindi/ët ose tutori/ët e fëmijës dhe qendra për punë sociale, në afatin që e ka përcaktuar gjykata, e së paku një herë në gjashtë muaj, do ta njoftojnë gjykatën kompetente për zbatimin e kësaj mase edukuese⁴⁸. Në qoftë se gjatë zbatimit të masës edukuese nga ana e prindit/ëve ose tutorit/ëve vjen deri në mospajtim në mes prindit/ëve ose tutorit/ëve të fëmijës dhe Qendrës për punë sociale, mosmarrëveshjen për mënyrën e zbatimit të kësaj mase do ta zgjedhe gjykata e cila e ka shqiptuar masën⁴⁹. Qendra për punë sociale është kompetente të përpilojë raport për mënyrën e zbatimit të masës edukuese nga ana e prindit/ëve ose tutorit/ëve dhe për rezultatet e arritura të zbatimit të kësaj mase dhe ta dorëzojë në gjykatën kompetente.

Për mënyrën e zbatimit të masës edukuese mbikëqyrje e përforcuar nga ana e prindit/ëve ose tutorit/ëve dhe për rezultatet e arritura nga zbatimi i kësaj mase përpilohet raport nga ana e Qendrës për punë sociale dhe i njëjti dorëzohet deri të gjykata kompetente.

1.2.2. Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e familjes përkujdesëse

Dërgimi i fëmijëve në familje tjetër shfrytëzohet si instrument dhe resurs në politikën dhe procesin e deinstitutionalizimit dhe zhvillimin e formave jashtë institucionale në komunitet.

Familjet përkujdesëse shfrytëzohen në fushën e mbrojtjes sociale, por edhe në fushën e drejtësisë për fëmijë në aspekt të fëmijëve ndaj të cilëve është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes përkujdesëse. Në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale, familjet përkujdesëse paraqesin formë të mbrojtjes jashtë familjare. Në familje përkujdesëse personi mund të strehohet në dy raste: nëse nuk ka kushte për jetë në familjen e tij dhe nëse për shkaqe tjera i nevojitet strehim në familje përkujdesëse⁵⁰. Përkujdesja e specializuar është shërbimi përmes të cilit personave të vendosur u sigurohet përkujdesje e përgjithshme dhe

⁴⁷ Neni 325 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁴⁸ Neni 326 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁴⁹ Neni 327 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁵⁰ Neni 88 I Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta zyrtare e RMV" nr.104/19...275/19)

mbështetja deri në tejkalimin e problemeve sociale, ndërsa sigurohet nga ana e përkujdesësve që kanë kaluar trajnim të specializuar. Shfrytëzuesit e shërbimit janë: fëmija viktimë e dhunës familjare, fëmija në konflikt, fëmija ose persona me pengesa⁵¹.

Këtë masë edukuese gjykatësi do ta shqiptojë kur do të konstatojë se prindi/ët gjegjësisht tutori/ët e fëmijës: a) ka ngecur në plotësimin e kujdesit prindëror për zhvillim të drejtë të personalitetit dhe mbikëqyrje ndaj fëmijës; dhe b) nuk kanë mundësi gjegjësisht prej tyre nuk mund të pritët me sukses të kryejnë mbikëqyrje ndaj fëmijës.

Gjatë ekzistimit kumulativ të të dy kushteve, gjykata do të vendosë fëmija t'i jepet familjes mbikëqyrëse e cila dëshiron ta pranojë dhe e cila ka mundësi të kryejë mbikëqyrje të përforcuar ndaj tij. Realizimi i kësaj mase do të ndërpritët kur prindi/ërit gjegjësisht tutori/ët i fëmijës do të fitojnë mundësinë të bëjnë mbikëqyrjen e përforcuar ndaj tij, ose kur sipas rezultateve të edukimit dhe riedukimit do të pushojë nevoja për mbikëqyrje të përforcuar ndaj fëmijës dhe ai mund të kthehet të jetojë në familjen e tij.

Aktivitetet lidhur me zbatimin e kësaj mase i realizon ekipi profesional i Qendrës për punë sociale cili punon me këtë problematikë (punëtori social, pedagogu, psikologu dhe juristi). Ekipi profesional i Qendrës për punë sociale përgatit:

-Program për njoftimin e opinionit me formën-strehimin në familje përkujdesëse, në të cilin do të definohen aktivitetet, mënyra, dinamika dhe subjektet të cilat duhet t'i realizojnë aktivitetet e parapara, dhe

-Raport për realizimin e aktiviteteve në pajtim me Programin për njoftimin e opinionit me formën-vendosjen në familje përkujdesëse.

Në vlerësimin e familjes përkujdesëse potenciale merr pjesë ekipi profesional. Personi përgjegjës ka për obligim me shkrim t'i përgjigjet familjes përkujdesëse a është adekuate ose jo në pajtim me vlerësimin. Vlerësimi bëhet në pajtim me kriteret në vazhdim: mosha e përkujdesësve, niveli i arsimit, gjendja shëndetësore, kushtet e banimit, përshatatshmërisë morale nëpërmjet gatishmërisë për përkujdesjen e fëmijëve, motivet për përkujdesjen e fëmijëve, strukturën e personalitetit në aspekt të aftësive, interesave dhe emocioneve, kualitetit të raporteve ndërmjet partnerëve që kanë të bëjnë me komunikimin e ndërsjellë,

⁵¹ Neni 90 i Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta zyrtare e RMV" nr.104/19...275/19)

cilësinë e kryerjes së të drejtës prindërore ndaj fëmijëve të vet, cilësinë e raporteve me familjen më të gjerë dhe rrethin më të gjerë të punës, mënyrën e jetesës dhe aktivitetet gjatë kohës së lirë dhe kohëzgjatjen e strehimit në pajtim me kapacitetet e përgjithshme të familjes. Moshë e çiftit të familjes përkujdesëse duhet të jetë nga 18 deri 65 vjet. Dallimi në moshë në mes çiftit përkujdesës dhe fëmijës duhet të jetë afërsisht me raportin prindër-fëmijë, por jo më e vogël se 18 vjet dhe jo më i madh se 50 vjet.

Ekipi profesional duhet të realizojë së paku një inspektim në familjen përkujdesëse dhe secili anëtarë i ekipit profesional duhet të realizojë nga së paku një intervistë me çiftin martesor-përkujdesësit⁵².

Pas përfundimit të vlerësimit të të gjitha kriterëve, ekipi profesional zhvillon trajnime me të gjitha familjet përkujdesëse të cilat i plotësojnë kushtet. Gjatë vlerësimit dhe pas trajnimit të realizuar me sukses, ekipi profesional i Qendrës për punë sociale vlerëson çfarë lloji të përkujdesjes ka kapacitet të realizojë familja përkujdesëse (përkujdesje të përgjithshme, të specializuar, përkujdesje të natyrës intervenuese ose përkujdesje të përkohshme). Pas vlerësimit dhe realizimit të trajtimit, ekipi profesional i Qendrës përgatit dokumentacionin e duhur dhe përpilon marrëveshje në të cilën theksohen të drejtat dhe obligimet e përkujdesësve. Marrëveshja nënshkruhet nga ana e drejtorit në emër të Qendrës, ndërsa marrëveshja e nënshkruar ruhet në dosjen e familjes përkujdesëse.

Personi profesional i Qendrës për punë sociale, i cili është përgjegjës për përgatitjen e Planit për punë individuale, duhet ta vizitojë fëmijën dhe familjen përkujdesëse së paku dy herë gjatë 7 ditëve të para të përkujdesjes dhe së paku një herë në muaj pas asaj. Ekipi profesional e përgatit familjen përkujdesëse për personin konkret, i cili duhet të përkujdeset dhe e njofton lidhur me: personalitetin e shfrytëzuesit, moshën, gjendjen shëndetësore, zhvillimin psiko fizik të personit, nevojat e shfrytëzuesit, kontaktet me familjen biologjike, obligimet e familjes përkujdesëse (ushqimimi, veshmbathja, mbrojtja shëndetësore, edukata, ndihmë në procesin e shkollimit). Gjatë strehimeve intervenuese, Qendra për punë sociale, e cila e ka strehuar fëmijën në periudhë nga 7 deri 10 ditë është e obliguar të bëjë kontroll në familjen

⁵² ЈУ Завод за социјални дејности, Стандарди и процедури за постапување на центрите на социјална работа, Скопје, 2014 fq.98

përkujdesëse së paku 2 herë, e kjo mund të bëhet më shpesh në pajtim me moshën, gjendjen shëndetësore dhe nevojat e fëmijës⁵³.

Zbatimin e masës edukuese nga ana e familjes përkujdesëse, Qendra për punë sociale ia beson familjes të përcaktuar në vendimin gjyqësor. Pas marrjes së vendimit nga ana e gjykatës kompetente, qendra për punë sociale do ta njoftojë familjen se në datën e caktuar në afat prej 15 ditësh do t'ua dorëzojë fëmijën për zbatimin e masës edukuese mbikëqyrje nga ana e familjes përkujdesëse⁵⁴. Qendra për punë sociale lidh marrëveshje me shkrim me familjen e përcaktuar në vendimin e gjykatës në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në lidhje me vendosjen dhe realizimin e mbikëqyrjes së përforcuar ndaj fëmijës. Me marrëveshje përcaktohen edhe lartësia dhe mënyra e pagesës së harxhimeve për vendosjen e fëmijë dhe kushtet dhe afatet e ndërprerjes së marrëveshjes⁵⁵. Gjatë zbatimit të masës edukuese mbikëqyrje te përforcuar nga ana e familjes përkujdesëse, fëmijës i sigurohet mbajtja e lidhjeve me familjen, në qoftë se gjykata kompetente me propozim të Qendrës për punë sociale nuk ka përcaktuar ndryshe⁵⁶.

Me qëllim që të realizohet kontroll në përparimin e sjelljes së fëmijës, gjatë shqiptimit të mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes përkujdesëse gjykata do të përcaktojë Qendra për punë sociale ta kontrollojë zbatimin e saj, t'i jepet ndihma e nevojshme familjes së cilës i është dhënë fëmija. Nga përparimi i fëmijës do të varet vendimi për ndërprerjen e kësaj mase.

1.2.3. Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale

Masa e tretë edukuese e cila përbëhet nga mbikëqyrja e përforcuar ndaj fëmijës është mbikëqyrja e përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale. Këtë masë gjykata do ta shqiptojë kur do të vlerësojë se prindi/ërit, ose tutori/ët nuk kanë mundësi të bëjnë mbikëqyrjen e përforcuar ndaj fëmijës, ndërsa nuk ekzistojnë kushte për dorëzimin e fëmijës në familje

⁵³ ЈУ Завод за социјални дејности, Стандарди и процедури за постапување на центрите на социјална работа, Скопје, 2014 fq.106

⁵⁴ Neni 329 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁵⁵ Neni 330 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁵⁶ Neni 331 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

përkujdesëse. Në raste të këtilla mbikëqyrja e përforcuar të cilën gjykata e ka vlerësuar si të nevojshme për edukim të drejtë, gjegjësisht riedukim të fëmijës do ti besohet Qendrës për punë sociale. Gjatë kohëzgjatjes së masës fëmija edhe më tej ngel të jetojë së bashku me prindërit e tij, gjegjësisht personat tjerë të cilët kujdesen për të. Nëse ekzistojnë kushtet për shkak të të cilave fëmija nuk mund të ngelë në familjen në të cilën ka jetuar, Qendra për punë sociale do ta strehojë fëmijën në institucion edukues dhe do të kujdeset për shkollimin apo punësimin e tij, për largimin e tij nga rrethi i cili në mënyrë të dëmshme ka ndikuar ndaj tij, si dhe për mjekimin e nevojshëm, ndërsa në kuadër të mundësive me të cilat disponon Qendra për punë sociale do të kujdeset edhe për përmirësimin e kushteve në të cilat jeton fëmija⁵⁷.

Menjëherë pas pranimit të vendimit, qendra për punë sociale do ti njoftojë prindin/ërit ose tutorin/ët se në afat prej 15 ditësh do të fillojë me realizimin e mbikëqyrjes së përforcuar ndaj fëmijës dhe do t'i njoftojë me programin e mbikëqyrjes së përforcuar të cilin do ta realizojë. Qendra për punë sociale do të përcaktojë punëtor profesionist i cili në vazhdimësi dhe pa ndërprerje do të kujdeset për zbatimin e mbikëqyrjes së përforcuar dhe realizimin e programit⁵⁸.

Pas pranimit të vendimit me të cilin është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana gjykatës kompetente, Qendra përgatit program për realizimin e mbikëqyrjes së përforcuar ndaj fëmijës me të cilin përcaktohet mënyra e realizimit të kujdesit që ka të bëjë me shkollimin, punësimin, mjekimin nëse është i nevojshëm, veçimin nga mjedisi i cili ndikon dëmshëm mbi fëmijën dhe rregullimin e rrethanave familjare dhe të tjera në të cilat jeton fëmija.

Zbatimi i masës edukuese mbikëqyrje e përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale paraqet proces kompleks, struktural dhe dinamik të ndryshmit të personalitetit dhe rrethit personal të fëmijëve me sjellje delikuate, në drejtim të riintegritit të plotë të tyre. Në kuptim operacional, faza e trajtimit të ekzekutimit të masës mbikëqyrje e përforcuar nga ana e qendrës, mund të shpjegohet në nënfazat në vijim, gjegjësisht grupet e aktivitete: përcaktimi i

⁵⁷ Neni 43 paragrafi 3 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

⁵⁸ Neni 333 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

potencialit dhe nevojën për zbatimin e trajtimit; planifikimi dhe programimi i trajtimit; realizimi i programit të trajtimit; ndjekja dhe vlerësimi i trajtimit⁵⁹.

Grupi i parë i aktiviteteve nuk është i detyrueshëm për zbatimin e masës, pasi që në fazën paraprake shqyrtuese fëmija është studiuar dhe në bazë të atij studimi është sjellë vendimi për masën edukuese të shqiptuar. Megjithatë, nevoja për shqyrtim të këtillë plotësues, del nga fakti se shqyrtimi paraprak është bërë me qëllim tjetër, gjegjësisht të përcaktohet masa edukuese adekuate për fëmijën në procedurën penale. Shqyrtimi i këtillë shpesh nuk siguron informata specifike të cilat janë të domosdoshme për individualizimin e trajtimit të fëmijës. Shpesh ndodh që nga shqyrtimi paraprak deri në fillimin e trajtimit, gjegjësisht zbatimin e masës, kalon një periudhë më e gjatë kohore, gjashtë ose më shumë muaj, dhe kjo e imponon nevojën për shqyrtim plotësues në të cilën vëmendje më e madhe do t'i kushtohet vlerësimit të ndryshimeve eventuale në atë periudhë. Do të thotë kjo fazë shërben për vënien e një raporti adekuat të bashkëpunimit me fëmijën dhe sigurimin e informatave specifike për planifikim të programit të trajtimit.

Faza e dytë e planifikimit dhe programimit të trajtimit i përcakton mjetet, metodat, teknikat dhe kuadrin profesional me të cilët sigurohet realizimi i qëllimit të përgjithshëm. Qasja ndaj planifikimit dhe programimit, duhet të realizohet në atë mënyrë që nuk duhet nisur nga qëllimet ideale të paramenduara, por të njejtat duhet të përputhen me mundësitë e fëmijës dhe rrethin në të cilën ai jeton.

Në realizimin e programit të trajtimit, që paraqet fazën e tretë, kryesisht zbatohet forma e punës individuale, ndërsa në varësi nga mundësitë dhe kushtet, zbatohet edhe forma e punës grupore.

Vlerësimi paraqet një çështje të rëndësishme e cila nuk mund të anashkalohet në punën praktike. Trajtimi i fëmijës nuk përbëhet vetëm nga zbatimi dhe realizimi i programit, por insistohet që ajo që është ndërmarrë rregullisht të rishqyrtohet dhe vlerësohet⁶⁰.

Zbatimi i masës nuk mund të jetë më i shkurtër se një vjet e as më e gjatë se tre vjet⁶¹ ndërsa në çdo rast konkret zgjat derisa të arrihen ndryshime pozitive në sjelljen e fëmijës, për

⁵⁹ ЈУ Завод за социјални дејности, Стручно- Методолшки упаства и прирачници, Скопје, 2007

⁶⁰ ЈУ Завод за социјални дејности, Стандарди и процедури за постапување на центрите на социјална работа, Скопје, 2014 fq.62

çka gjykata vendos në mënyrë plotësuese në bazë të informatave që ia jep Qendra për punë sociale për rrjedhën e zbatimit të masës dhe efektet e saj.

1.2.4. Obligime të veçanta që dalin nga masa mbikëqyrje e përforcuar

Gjatë shqiptimit të ndonjërës nga masat edukuese të mbikëqyrjes së përforcuar fëmijës do t'i caktohet një ose me shumë obligime nëse kjo është e nevojshme për masën e shqiptuar. Ligji për drejtësinë e fëmijëve parashihet se cilat obligime mund që gjykata t'ia përcaktojë fëmijës duke mbajtur llogari për individualizimin e dënimit dhe duke u nisur nga shkaqet që kanë ndikuar në kryerjen e veprës, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe personalitetin e fëmijës. Obligimet për nga natyra mund të ndahen në disa grupe: a) obligime ndaj personit të dëmtuar: personalisht t'i kërkojë falje personit të dëmtuar ose ta përmirësojë ose kompensojë dëmin e shkaktuar me vepër penale; b) obligime që kanë të bëjnë me shkollimin, gjegjësisht punën: ta ndjekë rregullisht mësimin, të mos mungojë nga vendi i punës për fëmijë mbi 15 vjet, të aftësohet për punë e cila i përgjigjet aftësive, prirjeve dhe forcës së tij fizike të tij për fëmijë mbi 15 vjet dhe të pranojë punë për fëmijë mbi 15 vjet ose të rikualifikohet ose profesionalizohet për mbajtjen e vendit të punës që e zë ose për krijimin e parakushteve për punësim të fëmijëve mbi 15 vjet; c) obligime që kanë të bëjnë me imponimin e ndalesave: ndalesa për konsumim të pijeve alkoolike, drogës ose substancave tjera psikotrope, ndalesa për të kontaktuar me persona të cilët ndikojnë negativisht ndaj personalitetit të tij; dhe ç) obligime lidhur me shfrytëzimin e kohës së lirë, gjegjësisht shpërndarjen e shpenzimeve: shfrytëzimi i kohës së lirë në mënyrë të dobishme, të mundësojë kontroll dhe të pranojë këshilla në lidhje me shpërndarjen dhe harxhimin e rrogës dhe të ardhurave të tjera të cilat i realizon, përfshirja në punë në organizatë humanitare, organizatë komunale, ekologjike ose joqeveritare ose përfshirje në ndonjë organizatë sportive, kulturo-artistike me obligim që t'i ndjekë rregullisht provat dhe trajnimet; t'i ndalohet lëvizja pa shoqërimin e prindit/ëve, ose tutorit/ëve të tij prej orës 22 deri në orën 5.

⁶¹ Neni 43 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

Gjykata mundet me propozim të qendrës, t'i ndryshojë ose heqë obligimet e veçanta që i ka caktuar.

Njëkohësisht, gjatë përcaktimit të kushteve të veçanta do t'ia sugjeroje fëmijës dhe personave të obliguar për edukimin e tij (prindit/ërve, gjegjësisht tutorit/ëve) se në rast se fëmija nuk i plotëson obligimet masa mund të zëvendësohet me dërgim në qendër ose me masë të entit. Gjykata mund, që me propozim të Qendrës për punë sociale t'i ndryshojë ose t'i anulojë obligimet e caktuara. Qendra për punë sociale bën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe i ndihmon fëmijët në plotësimin e obligimeve të caktuara, bashkëpunon me prindërit gjegjësisht kujdestarin dhe së paku një herë në gjashtë muaj së bashku me informacionin për zbatimin e masës së mbikëqyrjes së përforcuar e njofton gjykatën për suksesin e arritur në zbatimin e obligimeve të veçanta.

Në tabelën në vijim shfaqen të dhëna për numrin e përgjithshëm të masave të mbikëqyrjes së përforcuar të shqiptuara ndaj fëmijëve të moshës 14 deri 16 vjet dhe nga 16 deri 18 vjet në periudhën e viteve 2009-2018.

Tabela 9.

Viti	Fëmijë të moshës 14-16 vjet			Fëmijë të moshës 16-18 vjet			Gjithsej		
	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e familjes	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e familjes përkujdesëse	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e familjes	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e familjes	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale	Mbikëqyrje e përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale
2009	116	/	64	251	/	202	367	/	266
2010	80	/	42	165	/	122	245	/	164
2011	11	/	64	277	/	151	288	/	215
2012	85	/	36	213	/	137	298	/	173
2013	67	/	33	154	/	127	221	/	160
2014	59	/	28	192	/	91	251	/	119
2015	35	/	21	111	/	83	146	/	104
2016	58	/	42	162	/	142	220	/	184
2017	63	/	34	128	/	75	191	/	109
2018	39	/	18	107	/	18	146	/	109

Nga tabela mund të konstatojmë se në periudhën 2009-2018 nga tre llojet e masave të mbikëqyrjes së përforcuar në numër më të madh është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes. Nëse bëjmë krahasim me numrin e përgjithshëm të sanksioneve të shqiptuara ndaj fëmijëve pjesëmarrja e kësaj mase në vitin 2009 paraqet 49%, në vitin 2010 paraqet 44%, në vitin 2011 paraqet 39%, në vitin 2012 paraqet 53%, në vitin 2013 paraqet 46%, në vitin 2014 paraqet 54%, në vitin 2015 paraqet 41%, në vitin 2016 paraqet 47%, në vitin 2017 paraqet 51% dhe në vitin 2018 paraqet 44%.

Masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes në numër më të madh u është shqiptuar fëmijëve të moshës 16 deri 18 vjet.

Më tej vijon masa mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e Qendrës për punë sociale dhe nëse bëjmë krahasim me numrin e përgjithshëm të sanksioneve të shqiptuara pjesëmarrja e kësaj mase në vitin 2009 paraqet 35%, në vitin 2010 paraqet 29%, në vitin 2011 paraqet 29%, në vitin 2012 paraqet 31%, në vitin 2013 paraqet 33%, në vitin 2014 paraqet 25%, në vitin 2015 paraqet 29%, në vitin 2016 paraqet 39% , në vitin 2017 paraqet 29% dhe në vitin 2018 paraqet 36%.

Ndërkaq masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes përkujdesëse nuk është shqiptuar asnjë herë nga ana e gjykatave në këtë periudhë dhjetë vjeçare.

1.3. Masa të Enteve

Fëmijës mund ti shqiptohen masat e enteve si vijon:

1. dërgim në institucion edukues
2. dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese.

Shqiptimi i këtyre masave nuk është i lidhur me llojin ose peshën e veprimit të fëmijës i cili paraqet vepër penale, por me gjendjen e fëmijës dhe nevojën e tij për mbikëqyrje të vazhdueshme dhe masa të përforcuara të edukimit, riedukimit dhe zhvillimit të drejtë. Nga ana tjetër, pozita e rezervuar e tyre në aspekt të masave tjera edukuese është e diktuar nga fakti se tërheqja e fëmijëve nga rrethi i tij natyror-familja dhe vënia në regjim të posaçëm të kufizimit të lirisë mund të jetë kontraproduktive në aspekt të efekteve të pritura të zhvillimit dhe edukimit

të tij. Për këtë shkak, vendimi i gjykatës për shqiptimin e masave të entit paraqet konstatim profesional të gjendjes së fëmijës dhe prognozë për efektet edukative dhe efektet tjera, të përmbajtura në konkluzione dhe mendimin e qendrës për punë sociale dhe bashkëpunëtorëve profesional të gjykatës.

Qendra për punë sociale pas pranimit të vendimit nga ana e gjykatës kompetente me të cili fëmijës i shqiptohet ndonjëra nga masat e entit do të kërkojë nga prindi/ët ose tutori/ët, fëmijën të cilit i është shqiptuar kjo masë në ditë të caktuar gjatë afatit 15 ditor ta sjellë në institucion.

Qendra për punë sociale, gjithashtu do ta njoftojë edhe institucionin për datën kur fëmija duhet të paraqitet për ekzekutimin e masës edukuese. Institucioni në të cilin zbatohet masa e entit do ta njoftojë qendrën për punë sociale dhe gjykatën kompetente për datën e pranimit të fëmijës dhe fillimin e zbatimit të masës së entit⁶². Në qoftë se fëmija nuk paraqitet për zbatimin e masës së entit ose me vullnet vetanak e lëshon institucionin, udhëheqësi i institucionit do t'i njoftojë Qendrën për punë sociale, gjykatën kompetente dhe njësinë rajonale të Ministrisë së punëve të brendshme për kapjen e fëmijës dhe sjelljen e tij në institucionin për zbatimin e masës së entit⁶³.

Institucioni në të cilin zbatohet masa e entit, më së voni 3 muaj para lëshimit të planifikuar të fëmijës, duhet ta njoftojë Qendrën për punë sociale për lëshimin dhe t'i propozojë masat të cilat duhet të ndërmerren për edukimin e mëtejshëm të fëmijës⁶⁴. Qendra për punë sociale punon në konsultim me prindin/ërit ose tutorin/ët e fëmijës dhe me përfshirjen e tyre në përgatitjen për pranimin e fëmijës në institucion, veçanërisht kujdeset për rregullimin e kushteve familjare të fëmijës, për sigurimin e strehimit të përkohshëm të tij dhe ushqimin nëse ai nuk sigurohet nga ana e familjes, për sigurimin e veshmbathjeve, për mjekim, për zgjedhjen e ambientit përkatës dhe për shkollimin dhe punësimin e fëmijës. Për përgatitjet të cilat i ka ndërmarrë Qendra për punë sociale do të njoftohet gjykata kompetente⁶⁵

⁶² Neni 337 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁶³ Neni 338 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁶⁴ Neni 339 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁶⁵ Neni 340 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

1.3.1. Dërgim në institucion edukues

Gjykata mund ta dërgojë në institucion edukues fëmijën ndaj të cilit duhet të sigurohet mbikëqyrje e përhershme dhe e përforcuar nga ana e personave profesionist, të cilët kanë përgatitje arsimore dhe profesionale për edukator, me qëllimin e vetëm edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë të fëmijës. Në bazë të Ligjit për mbrojtje sociale shërbimi i masës dërgim në institucion edukues përfshin mbrojtje 24 orëshe dhe ndihmë nga ana e personave profesionist, veshje dhe sigurimin e mbrojtjes shëndetësore në varësi nga nevojat e shfrytëzuesit, si dhe risocializim, riintegrim, edukim, arsimim dhe ndihmë gjatë shkollimit, kalim i organizuar i kohës së lirë dhe shërbime tjera të risocializimit.

Masa edukuese dërgim në institucion edukues zbatohet në institucion edukativ të dedikuar për edukimin dhe mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe rinisë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut zbatimi i kësaj mase realizohet në IP për përkujdesjen e fëmijëve me problem edukuese-sociale dhe çrregullime në sjellje në Shkup. Institucioni bën zbatimin e masës si institucion i tipit të hapur, e në përputhshmëri me Ligjin për zbatimin e sanksioneve dhe Ligjin mbi familjen.

Institucioni vepron nëpërmjet dy shërbimeve: Shërbimi për punë edukuese me fëmijët me sjellje të çrregulluar dhe Shërbimi për realizimin e veprimtarisë arsimore⁶⁶

Qendra për punë sociale do ta njoftojë udhëheqësin e institucionit edukues me vendimin me të cilin është shqiptuar masa edukuese, si dhe me të dhënat tjera për personalitetin e fëmijës, për situatën familjare, sociale dhe kushtet në të cilat jeton dhe do ta njoftojë gjykatën kompetente për institucionin ku do të zbatohet masa edukuese ndaj fëmijës⁶⁷.

Fëmija në institucion edukues vendoset në kushte të njëjta dhe gëzon të drejtat dhe obligimet e njëjta si edhe fëmijët tjerë të vendosur në institucion, me atë që në aspekt të edukimit dhe mbikëqyrjes i kushtohet vëmendje e veçantë. Me rrethanën se ndaj fëmijës është

⁶⁶JУ Завод за социјални дејности-Скопје, Извештај за функционирањето и предлози за трансформација на ЈУ за згрижување деца со воспитно-социјални проблеми и нарушено поведение-Скопје, Скопје, 2018, fq. 5

⁶⁷Neni 342 dhe 343 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

shqiptuar dhe zbatohet masa edukuese të tipit të entit njoftohen udhëheqësi i institucionit dhe edukatori të cilit i është besuar fëmija⁶⁸.

Udhëheqësi i institucionit edukues është i obliguar që së paku në çdo gjashtë muaj ose kur gjykata kompetente apo Qendra për punë sociale do ta kërkojë këtë prej tij, ta informojë për suksesin në zbatimin e kësaj mase edukative ndaj fëmijës. Në institucionin edukativ fëmija qëndron së paku gjashtë muaj, se më së shumti tre vjet. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e përcakton kohëzgjatjen e saj por për këtë vendos në mënyrë plotësuese⁶⁹.

Gjatë kohës së pushimit dimëror dhe ditët e festive kur institucioni edukativ nuk punon, fëmija mund të dërgohet tek prindi/ët ose tutori/ët ose tek të afërmit. Nëse fëmija nuk ka ku të vendoset Qendra për punë sociale do të përcaktojë qëndrim të përkohshëm të fëmijës. Koha e kaluar jashtë entit edukues gjatë kohës së pushimit dimëror dhe festat llogaritet në kohën e kaluar në institucion⁷⁰.

Drejtori i institucionit edukues është i obliguar që së paku në çdo gjashtë muaj ose kur gjykata kompetente ose Qendra për punë sociale do ta kërkojë këtë t'i njoftojë për suksesin e zbatimin e kësaj mase edukuese ndaj fëmijës⁷¹.

Për fëmijët që kanë rënë ndesh me ligjin, pas kalimit të kohëzgjatjes sanksionit të shqiptuar nga ana e gjykatës "Dërgim në institucion edukues", në qoftë se janë të moshës madhore dhe nuk kanë kushte për jetë në shtëpinë e tyre, në procesin e riintegrit mund t'ju ofrohet shërbimi "Shtëpi në gjysmë të rrugës" në kohëzgjatje prej 1 deri 6 muaj. Qëndrimi ka për qëllim të mundësojë përgatitjen e shfrytëzuesve për ndihmë në aspekt të punësimit, sigurimin e strehimit vetanak dhe socializim nëpërmjet ndihmës së siguruar paraprakisht, ndihmë dhe monitoring nga ana e personave profesionist⁷².

⁶⁸ Neni 344 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁶⁹ Neni 45 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

⁷⁰ Neni 345 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁷¹ Neni 346 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁷² ЈУ Завод за социјални дејности-Скопје, Извештај за функционирањето и предлози за трансформација на ЈУ за згрижување деца со воспитно-социјални проблеми и нарушено поведение-Скопје, Скопје, 2018, fq. 11

1.3.2. Dërgimi në shtëpi edukuese-përmirësuese

Fëmijës ndaj të cilit duhet të zbatohen masa afatgjate të përforcuara për edukim dhe riedukim dhe paraqitet nevoja për largimin e plotë të tij nga rrethi në të cilën ka jetuar dhe është edukuar deri më tani, gjykata do ta dërgojë në shtëpi edukative-përmirësuese⁷³. Duke pasur parasysh faktin se bëhet fjalë për masë institucionale e cila parasheh qëndrim të vazhdueshëm të fëmijës në institucionin edukativ-përmirësues, gjatë vendosjes se a do ta shqiptojë këtë masë gjykata e merr parasysh peshën dhe natyrën e veprës së kryer dhe rrethanat nëse ndaj fëmijës më herët janë shqiptuar masa edukuese ose masa dënimi më burg për fëmijë. Masa edukuese dërgim në shtëpi edukative-përmirësues mund të shqiptohet vetëm një herë. Puna në shtëpinë edukative-përmirësuese organizohet ashtu që fëmijës i sigurohen kushte për shkollim fillor dhe të mesëm dhe edukim, kushte për fitimin dhe zhvillimin e shprehive pozitive, vlerave dhe profesionalizimit në punë dhe aftësimin për zeje të caktuara. Nëse në shtëpinë edukative-përmirësuese nuk ekziston mësim i një drejtimi të caktuar ose shkallë e arsimimit fëmija mund që mësimin e tillë ta ndjekë jashtë institucionit edukative-përmirësues. Në shtëpinë edukative-përmirësuese të fëmijës i sigurohen kushte për shfrytëzim aktiv të kohës së lirë me aktivitete kulturore, argëtuese dhe sportive. Fëmija derisa qëndron në shtëpinë edukative-përmirësuese mund të mbajë kontakte me familjen dhe me personat tjerë dhe institucione tjera të cilat mund të ndikojnë pozitivisht ndaj risocializimit të tij⁷⁴.

Në shtëpinë edukative-përmirësuese fëmija qëndron së paku një vit, ndërsa më së shumti pesë vjet gjegjësisht derisa të mbushë 23 vjet. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e përcakton kohëzgjatjen e saj, por lidhur me këtë vendos në mënyrë plotësuese. Gjkata e rishqyrton nevojën e qëndrimit në shtëpi edukative-përmirësuese çdo vit, me detyrë zyrtare, me propozim të prokurorit publik ose me propozim të shtëpisë edukative-përmirësuese⁷⁵.

Gjatë pranimit në shtëpinë edukative-përmirësuese vërtetohet identiteti i fëmijës. Në fillim të zbatimit të masës edukative fëmija njoftohet me rendin shtëpiak, të drejtat dhe

⁷³ Neni 46 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

⁷⁴ Neni 347 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁷⁵ Neni 46 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

obligimet të cilat i takojnë gjatë zbatimit të masës edukuese, mënyrën në të cilën i zbaton të drejtat e përcaktuara dhe me masat disiplinore të cilat mund t'i shqiptohen. Institucioni ka sjellë aktin e përgjithshëm me të cilin rregullohet më nga afër organizimi i punës dhe parashihet mënyra e jetesës në institucion.

Pas pranimit në shtëpinë edukuese-përmirësuese fëmija qëndron në njësinë pranuese deri 30 ditë. Në njësinë pranuese ekipi profesional, nëpërmjet zbatimit të metodave profesionale, bën ekzaminimin social-mjekësor dhe pedagogjik - psikologjik të personalitetit të fëmijës. Ekipin profesional e përbëjnë psikologu, pedagogu, punëtori social, mjeku, e sipas nevojës edhe persona profesionist të tjerë. Në bazë të potencialit zhvillimor dhe nevojave të personalitetit të fëmijës, ekipi profesional në njësinë pranuese përgatit dhe përcakton program për punë individuale e cila i përfshin të gjitha karakteristikat më të rëndësishme të personalitetit, përmbajtjet dhe metodat e punës të cilat do ta stimulojnë fëmijën për pjesëmarrje aktive në procesin e risocializimit dhe edukimit gjatë kohës së qëndrimit në shtëpinë edukuese-përmirësuese. Ekipi profesional në njësinë pranuese i përcakton metodat për punën edukuese me fëmijën, koordinohet angazhimi i punës me mësimin në shkollë për arsim fillor dhe të mesëm, me punëtoritë dhe ekonominë në të cilën zbatohet trajnimi profesional dhe propozohen masa për realizimin më të suksesshëm të procesit të riedukimit. Ekipi profesionist i institucionit dhe drejtori në bazë të planit të individualizuar, bëjnë vendosjen, e zbatojnë programin për trajtim dhe angazhimin me punë të fëmijës⁷⁶.

Në shtëpinë edukuese-përmirësuese fëmijët shpërndahen në grupe edukuese sipas moshës, vetive personale dhe karakteristikave tjera, të cilat mundësojnë zbatimin e metodave stimulative të përshtatura individualisht për punë me fëmijën në grup. Me shpërndarjen në grupe ndërmerren masa për mbajtjen e rendit dhe disiplinës me qëllim pengimin dhe pamundësimin e ndikimeve negative të ndërsjella. Grupet edukuese mund të përfshijnë nga pesë deri 7 persona dhe kanë edukator të posaçëm⁷⁷.

Fëmijëve, në pajtim me nevojat për riedukimin e tyre, ekipi profesional i institucionit e përcakton llojin e punës sipas aftësive të tyre trupore dhe shpirtërore dhe mundësive të

⁷⁶ Neni 348, 349, 350 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁷⁷ Neni 351 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

shtëpisë edukuese-përmirësuese. Gjatë përcaktimit të llojit të punës mbahet llogari për dëshirat e fëmijës të kryejë një lloj të caktuar të punëve. Gjatë zbatimit të drejtimit të cilin e mësojnë fëmijët, për të cilën organizohet mësim për arsim të mesëm, do të mbahet llogari për aftësitë dhe interesat e tyre, për mundësitë e shtëpisë edukuese-përmirësuese dhe për rrethanat tjera me rëndësi për realizimin e qëllimit të masës edukuese.

Fëmijët të cilët kanë kryer arsimin e mesëm ose janë aftësuar profesionalisht, mund të punojnë me orar të plotë të punës, në pajtim me rregullat nga fusha e marrëdhënieve të punës. Nga fëmijët të cilët e ndjekin mësimin për arsim të mesëm ose për llojin e caktuar të zejes, kërkohet të punojnë sipas rregullave dhe programit mësimor të shkollës të cilën e ndjekin. Fëmijës duhet t'i mundësohen kushte për kulture fizike dhe sport. Fëmija duhet të merret dy orë në ditë me sport dhe aktivitete tjera të lira në ajër të pastër, e nëse kushtet kohore nuk e lejojnë këtë, ajo duhet të realizohet në hapësirë të posaçme për edukatë fizike dhe rekreative. Fëmija së paku dy orë në ditë duhet të kalojë në aktivitete kulturore argëtuese.

Fëmija së paku dy orë në ditë duhet të kalojë në aftësim dhe ndjekjen e arsimimit sipas profesionit. Fëmijët të cilët do të marrin kualifikim në shtëpinë edukuese-përmirësuese marrin dëftesë. Në dëftesë nuk mund të shihet se kualifikimin e kanë marrë në shtëpi edukuese-përmirësuese. Në rastet kur në pajtim me rregullat e lëmisë së marrëdhënieve të punës koha e kaluar në punë të një lloji të caktuar pranohet për fitimin e një kualifikimi të caktuar, për kualifikim pranohet edhe koha e kaluar në llojin e njejtë të punës në shtëpinë edukuese-përmirësuese, me atë që kjo kohë nuk llogaritet në stazhin e punës dhe nuk mund të jetë bazë për fitimin e të drejtave tjera. Fëmijës i cili ka filluar arsimimin e mesëm ose ndonjë lloj shkollimi tjetër profesional mund t'i lejohet vazhdimi i shkollimit jashtë shtëpisë edukuese-përmirësuese, në qoftë se me sjelljen dhe angazhimin e tij në mësim ju shërben si shembull fëmijëve të tjerë dhe këtë e meriton⁷⁸.

Fëmijë ju sigurohet ushqim tre herë në ditë, e cila duhet të përmbajë së paku 14, 600 xhul. Ata fëmijë të cilët janë të sëmurë marrin ushqim të llojit dhe sasisë të cilat do t'uua përcaktojë mjeku. Gjithashtu fëmijët marrin edhe veshmbathje falas⁷⁹.

⁷⁸Nenet 353, 354, 355, 356 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁷⁹Neni 357 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

Për ata fëmijë që nuk punojnë me fajin e tyre dhe nuk kanë mjete vetanake, shtëpia edukuese-përmirësuese i përmbush nevojat e tyre. Gjithashtu fëmijët kanë të drejtë për vizita nga ana e anëtarëve të familjes së ngushtë të tyre, e në qoftë se lejon drejtori i shtëpisë edukuese-përmirësuese mund të pranojnë vizita edhe nga ana e personave tjerë. Në aspekt të këmbimit të letrave vlejnë po të njejtat rregulla, do të thotë fëmijët mund të këmbejnë letra me prindërit ose të afërmit. E drejta e letërkëmbimit mund të zgjerohet edhe ndaj personave tjerë, por vetëm nëse kjo nuk ndikon negativisht ndaj fëmijës. Të drejtë tjetër të cilën e gëzojnë fëmijët në entin edukues-përmirësues është pranimi i pakove. Kjo përfshin: pako me veshmbathje, sende për përdorim personal, libra dhe gazeta ditore, duke mbajtur llogari që përmbajtja e tyre mos të jetë e dëmshme. Fëmijët në pako mund të pranojnë edhe para të cilat mund t'i shfrytëzojnë në kuadër të rregullave të parapara në rendin shtëpiak. Fëmijët gjithashtu kanë të drejtë edhe të mungesës dhe atë në kohëzgjatje prej një muaj gatë vitit, me mundësi të shfrytëzimit në dy pjesë, pushim veror dhe dimëror dhe gjatë kësaj periudhe mund t'i vizitojnë prindërit dhe të afërmit.

Mungesën e jep drejtori i shtëpisë edukuese-përmirësuese dhe ai jepet gjatë periudhës së pushimit dimëror dhe gjatë ditëve festive dhe fundjavës. Shtëpia edukuese përmirësuese mund të organizojë dhe mjekimin jashtë shtëpisë falas për ata fëmijë që gjenden në shtëpinë edukuese-përmirësuese. Koha të cilën fëmijët e kanë kaluar në mungesë ose në verime të përbashkëta llogaritet në kohën e kaluar në shtëpi. Fëmijët të cilët nuk ndjekin mësimin për shkollim fillor dhe të mesëm, e në trajnime praktike kanë kaluar gjashtë muaj pa ndërprerë duke përfshirë këtu edhe kohën e kaluar në mjekim për shkak të lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale, kanë të drejtë të pushimit prej së paku 20 ditë gjatë vitit, me mundësi të shfrytëzimit në dy pjesë: pushim veror dhe dimëror. Pushimi, parimisht, shfrytëzohet tek prindi/ët ose tutori/ët ose të afërmit. Për ata fëmijë që nuk kanë ku të shkojnë, e janë të prirë për ikje ose ekziston rreziku të vazhdojnë me kryerjen e veprave penale dhe prishjen e rendit dhe qetësisë publike, drejtorja e shtëpisë mund të organizojë pushim të përbashkët në hapësirat e shtëpisë edukuese-përmirësuese ose jashtë saj. Vendim për shfrytëzimin e pushimit sjell drejtori i shtëpisë, me propozimin e personit zyrtar nga sektori i risocializimit⁸⁰. Shtëpitë

⁸⁰ Neni 363 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

edukuese-përmirësuese duhet të kenë detyrimisht minimumin e sigurisë dhe të kenë pengesa fizike deri në atë shkallë që pengojnë ikjen e fëmijëve, por ata duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që nëse fëmija bën përpjekje për të ikur të mos pësojë lëndim fizik⁸¹.

Ndaj fëmijëve nuk lejohet zbatimi i masës së posaçme për mbajtjen e rendit dhe disiplinës-qeli. Për shkelje më të rënda të disiplinës, si dhe Rendit shtëpiak të institucionit fëmijët mund të ndahen në dhoma të veçanta në kohëzgjatje nga pesë deri shtatë ditë, gjatë së cilës periudhë ekipi profesional ndërmerr aktivitete korrektuese speciale ndaj fëmijës. Ndarja në dhomë të veçantë mund të shtyhet në qoftë se ekziston mundësia që edhe pa shqiptimin e kësaj mase, do të arrihet qëllimi i veçimit⁸².

Fëmijët sipas gjinisë akomodohen në shtëpi të veçanta, kurse mund të akomodohen në një shtëpi, por ndarazi⁸³. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut zbatimi i masës dërgim në institucion edukues-përmirësues bëhet në dy institucione dhe atë: Shtëpia edukuese përmirësuese Tetovë në të cilën dërgohen fëmijët e gjinisë mashkullore të cilëve i u është shqiptuar masa e entit dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese për të gjitha gjykatat në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në njësinë për femra në kuadër të shtëpisë ndëshkuese-përmirësuese Idrizovë në të cilën dërgohen fëmijët e gjinisë femërore të cilëve u është shqiptuar masa e entit dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese. Mbikëqyrje mbi punën e Shtëpisë edukuese përmirësuese bën Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së drejtësisë.

1.3.3. Ndërprerja e zbatimit, ndryshimi dhe vendimmarrja e sërishme lidhur me masat edukuese

Ndërprerja e zbatimit gjegjësisht ndryshimi i një mase edukuese me tjetër është e mundshme nëse plotësohen dy kushte:

1) për shkak të rrethanave të reja të cilat ndikojnë ndaj llojit të masës edukuese-kur pas sjelljes së vendimit me të cilën është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar ose masa e

⁸¹ Neni 364 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁸² Neni 366 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁸³ Neni 40 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

entit do të paraqiten rrethana të reja të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën kur është sjellë vendimi ose nuk është ditur për ta, ndërsa konsiderohen se në mënyrë esenciale mund të ndikojnë ndaj sjelljes së vendimit në drejtim tjetër, zbatimi i masës së sjellë mund të ndërpritet ose të zëvendësohet me masë tjetër të mbikëqyrjes së përforcuar ose me masë të entit; ose

2) duke pasur parasysh suksesin e arritur në edukimin dhe riedukimin edhe pse përjashtimisht, zbatimi i masës së mbikëqyrjes shtesë ose masës së entit mund të ndërpritet, ndërsa mund të zëvendësohet me masë tjetër të tillë nëse konstatohet sukses në edukim dhe riedukim mirëpo me kufizimet në vijim: a) masa dërgim në institucion edukativ nuk mund të ndërpritet nga zbatimi para kalimit të afatit prej gjashtë muajsh, ndërsa deri në kalimin e këtij afati mund të zëvendësohet vetëm me dërgim i fëmijës në shtëpi edukuese-përmirësuese dhe b) masa dërgim në shtëpi edukative-përmirësuese nuk mund të ndërpritet nga zbatimi para kalimit të një viti.

Nëse nga plotfuqishmëria e vendimit me të cilën është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar ose të masës së entit kanë kaluar gjashtë muaj, e zbatimi nuk ka filluar, gjykata sërish do të vendosë për nevojën e zbatimit të saj. Me këtë rast, gjykata mund të vendosë që më herët masa e shqiptuar të zbatohet, të mos zbatohet ose të zëvendësohet me ndonjë masë tjetër⁸⁴.

⁸⁴ Neni 48 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

Në tabelën në vijim shfaqen të dhëna për numrin e përgjithshëm të masave të enteve të shqiptuara ndaj fëmijëve të moshës 14 deri 16 vjet dhe nga 16 deri 18 vjet në periudhën e viteve 2009-2018.

Tabela 10.

Viti	Fëmijë të moshës 14 deri 16 vjet		Fëmijë të moshës 16 deri 18 vjet		Gjithsej	
	Dërgim në institucion edukues	Dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese	Dërgim në institucion edukues	Dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese	Dërgim në institucion edukues	Dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese.
2009	2	4	1	8	3	12
2010	5	10	2	5	7	15
2011	/	7	2	11	2	18
2012	2	12	/	7	2	19
2013	/	6	2	4	2	10
2014	1	15	1	8	2	23
2015	1	7	0	3	1	10
2016	/	2	5	3	5	5
2017	3	6	2	2	5	8
2018	5	5	3	3	8	8

Nga tabela mund të konstatojmë se gjykatat në periudhën 2009-2018 në numër më të madh kanë shqiptuar masën e entit-dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese ndaj fëmijëve të moshës 16 deri 18 vjet, më pas sipas numrit vijojnë poashtu masa dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese ndaj fëmijëve të moshës 14 deri 16 vjet. Më shumë fëmijë janë dërguar në shtëpi edukuese-përmirësuese në vitin 2014 dhe atë gjithsej 23. Ndërkaq masa e entit-dërgim në institucion edukues është shqiptuar shumë rrallë dhe atë numri maksimal arin në vitin 2018 ndaj 8 fëmijëve.

2. Dënimi i fëmijëve

Sipas Ligjit për drejtësi për fëmijë dënimi mund të zbatohet vetëm ndaj fëmijës mbi moshën 16 vjet me përgjegjësi penale nëse për shkak të pasojave të rënda të veprës penale dhe shkallës së lartë të përgjegjësisë penale nuk është e arsyeshme që të shqiptohet masë edukuese.

Nën kushtet e përcaktuara më këtë ligj, fëmijës mbi moshën 16 vjet mund t'i shqiptohen dënimet në vijim:

1. burg për fëmijë-i cili mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor;
2. dënim në para-mund të shqiptohet si dënim kryesor, ndërsa përjashtimisht, për vepra penale të kryerja nga lakmia për përfitim, mund të shqiptohet si dënim sekondar se bashku me dënimin burg për fëmijë ose me dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse kur është përcaktuar dënimi burg për fëmijë;
3. ndalesë për drejtimin e automjetit të llojit apo kategorisë së caktuar-mund të shqiptohet si dënim kryesor apo si dënim sekondar dhe
4. dëbimi i të huajit nga vendi-mund të shqiptohet si dënim kryesor ose si dënim sekondar.

2.1. Burgu për fëmijë

Burgu për fëmijë mund t'i shqiptohet fëmijës mbi moshën 16 vjet me përgjegjësi penale i cili ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë dënim më burg prej pesë vitesh ose dënim më i rëndë, nëse vepra është kryer në rrethana rënduese ose në shkallë të lartë të përgjegjësisë penale të kryesit, për shkak të të cilave gjykata vlerëson se nuk është e arsyeshme shqiptimi i masës edukuese⁸⁵. Burgu për fëmijë mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor. Burgu për fëmijë nuk mund të jetë më i shkurtë se një vjet e as më i gjatë se dhjetë vjet, ndërsa shqiptohet në vite të plota ose në gjysmë viti. Gjatë matjes së dënimit të fëmijës për veprë penale të caktuar, gjykata nuk mund të shqiptojë burg për fëmijë në kohëzgjatje më të gjatë se dënimi me burg i paraparë për atë veprë, mirëpo gjykata nuk është e lidhur me masën më të vogël të paraparë për atë dënim. Gjatë matjes së dënimit burg për fëmijë, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i madh ose më i vogël, të përcaktuara në Kodin penal, veçanërisht duke mbajtur llogari për shkallën e zhvillimit shpirtëror

⁸⁵ Neni 51 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

të fëmijës dhe për kohën e nevojshme për edukimin, riedukimin dhe aftësimin profesional të tij⁸⁶.

Fëmijët dënimin e burg e mbajnë në institucion të veçantë ndëshkues-përmirësues, të veçuar nga personat madhor⁸⁷. Fëmijët e gjinisë mashkullore vendosen në hapësira të veçanta nga fëmijët e gjinisë femërore. Programet për aftësim profesional, aktivitete shkollore, sociale dhe argëtuese fëmijët mund t'i realizojnë bashkërisht⁸⁸. Pas mbushjes së moshës 23 vjeçare, personat e dënuar me dënim burg për fëmijë, dënimin e mbajnë në pajtim me aktin e shpërndarjes së personave të dënuar dhe fëmijëve në institucionet ndëshkuese –përmirësuese dhe institucioneve përmirësuese-edukuese.

Institucionet e parapara për fëmijë duhet të kenë minimumin e sigurisë dhe të kenë pengesa fizike në atë shkallë që e pamundësojnë ikjen e fëmijëve, por ata duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që në qoftë se fëmija tenton të ikë të mos pësojë lëndim fizik. Numri i fëmijëve në një institucion për fëmijë duhet të mundësojë individualizim të trajtimit⁸⁹. Institucioni për fëmijë duhet të ketë njësi të hapur në të cilën fëmija do të përparojë, kur do të vërtetohet se fëmija nuk do të ikë për shkak të mungesës së sigurisë fizike dhe do t'i përmbahet rendit të bazuar ndaj vetëdisiplinës së njesisë. Procedura për pranimin e fëmijës në institucionin për fëmijë duhet të realizohet në atë mënyrë që do t'i minimizojë efektet e padëshirueshme psikologjike të privimit nga liria⁹⁰.

Me trajtimin i cili zbatohet ndaj fëmijëve sipas programit profesional të përgatitur të përcaktuar nga ana e ministrit të drejtësisë në pajtim me ministrin e arsimit dhe shkencës dhe ministrin e punës dhe politikës sociale, duhet që fëmija të inkurajohet dhe atij t'i ofrohet ndihmë, tek ai të nxiten veti pozitive dhe zhvillim i personalitetit dhe ti mundësohet arsimim, profesionalizim dhe aftësim për jetën në liri.

Në bazë të mundësive të institucionit, fëmijët vendosen në dhoma të veçanta gjumi. Në qoftë se për shkak të mungesave hapësinore, natën në një hapësirë vendosen më shumë

⁸⁶ Neni 52 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

⁸⁷ Neni 38 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁸⁸ Neni 291 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁸⁹ Neni 293 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁹⁰ Neni 295 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

fëmijë, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i madh se pesë persona, duhet të sigurohet mbikëqyrje e cila realizohet në atë mënyrë që t'i ofrohet ndihmë secilit fëmijë. Fëmijëve, arsimit fillor dhe i mesëm si dhe lloji i detyrave të punës ju përcaktohen në bazë të programit për trajtim. Në institucion organizohet mësimi i shkollës fillore dhe të mesme e cila është e obligueshme, ndërkaq në varësi nga kushtet dhe mundësitë e institucionit, organizohen edhe lloje tjera të aftësimin profesional të fëmijëve. Në qoftë se në institucion nuk ka kushte për organizimin e mësimin, fëmijët duhet që patjetër mësimin ta ndjekin në shkollën në vendin ku gjendet selia e institucionit. Zgjedhja e llojit të detyrave të punës, lloji i mësimin dhe aftësimin profesional bëhet në bazë të mundësive të institucionit për fëmijë, duke pasur parasysh aftësitë fizike të fëmijës, vetitë personale dhe prirjen e fëmijës për një lloj të caktuar zeje-profesioni.

Fëmijës i sigurohet ushqim i cili duhet të ketë së paku 14,600 xhul⁹¹. Fëmijës duhet ti sigurohen dy orë në ditë aktivitete sportive dhe aktivitete tjera në ajër të pastër, e në qoftë se këtë nuk e lejojnë, këta aktivitete duhet të zhvillohen në hapësira të veçanta për edukim fizik dhe rekreativ. Fëmija së paku dy orë në ditë duhet të ketë aktivitete argëtuese. Fëmija së paku dy orë në ditë duhet të kalojë në aftësim dhe ndjekjen e arsimimit sipas profesionit.

Për të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë ditës përgatitet orar i aktiviteteve ditore, të cilin e përpilon ekipi profesional i njësisë për trajtim. Fëmija ka të drejtë për mbrojtje shëndetësore, në përputhshmëri me nevojat zhvillimore të tij. Mjeku duhet të bëjë kontroll të shëndetit të fëmijës dhe në rast të sëmundjes t'i ndërmarrë masat e nevojshme për mjekim. Për gjendjen shëndetësore të fëmijës duhet të njoftohet prindi ose tutori. Në rast të nevojës për mjekim spitalor, nevojitet pajtimi i prindit gjegjësisht tutorit të fëmijës. Shëndeti i fëmijëve kontrollohet dy herë në vit nëpërmjet kontrolleve sistematike.

Drejtori i institucionit mund që fëmijës t'i lejojë mungesë për të vizituar prindërit dhe familjen dy herë gjatë një viti, në kohën kur nuk zhvillohet mësimi. Kohëzgjatja e mungesës mund të jetë deri 14 ditë, duke marrë parasysh sjelljen e tij në institucion dhe angazhimin e fëmijës në mësim⁹². Fëmijëve duhet t'ju jepen benefite me të cilat do ti nxisin të kyçjen në aktivitetet e institucionit për fëmijë, zhvillimin e linjave pozitive të personalitetit dhe

⁹¹ Neni 300 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁹² Neni 303 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

vetërespektit. Ndaj fëmijëve nuk lejohet zbatimi i masës së veçantë të mbajtjes së rendit dhe disiplinës-qeli. Për shkelje më të rënda të rendit dhe disiplinës, si dhe mosrespektimin e Rendit shtëpiak të institucionit, fëmijët mund të ndahen në dhoma të veçanta në kohëzgjatje nga pesë deri shtatë ditë, gjatë së cilës periudhë ekipi profesional ndërmerr aktivitete korrektuese speciale ndaj fëmijës. Ndarja në dhomë të veçantë mund të shtyhet në qoftë se ekziston mundësia që edhe pa shqiptimin e kësaj mase, do të arrihet qëllimi i veçimit.


Fëmija i cili mban dënimin me burg për fëmijë mund të lëshohet në lirim me kusht, nëse ka mbajtur së paku një të katërtën, mirëpo jo para se të mbahet gjashtë muaj të dënimit të shqiptuar nëse riedukimi tregohet si i suksesshëm. Gjatë kohës së lirimimit me kusht gjykata i përcakton masë të mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e qendrës për punë sociale, e cila mund të jetë edhe më e shkurtër se pjesa e mosmbajtjes së dënimit. Gjykata mund ta vazhdojë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes së përforcuar deri në një vjet pas kohëzgjatjes së dënimit, mirëpo më së shumti deri në mbushjen e moshës njëzet e një vjeçare të të dënuarit. Gjykata do ta revokojë lirimimin me kusht nëse fëmija i dënuar nuk i plotëson obligimet e parapara me mbikëqyrjen e përforcuar ose nëse kryen një ose më shumë vepra penale tjera për të cilat është shqiptuar masa burg për fëmijë mbi dy vjet, derisa është në lirim me kusht. Nëse fëmija ka kryer vepër penale për të cilën i është shqiptuar dënim burg për fëmijë deri dy vjet ose dënim me para, gjykata mund ta revokojë lirimimin me kusht, duke marrë parasysh ngjashmërinë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre, shkaqet për të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat tjera të cilat çojnë deri të arsyeshmëria e revokimit të lirimimit me kusht. Kur gjykata do ta revokojë lirimimin me kusht, do të shqiptojë një të një prej masave alternative duke marrë dënimin e shqiptuar më parë si të vërtetuar. Kur gjykata nuk do ta revokojë lirimimin me kusht, ai vazhdohet për kohën të cilën fëmija i dënuar e ka kaluar në mbajtjen e dënimit burg për fëmijë të shqiptuar për veprën e re.

Zbatimi i dënimit burg për fëmijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut bëhet në Shtëpinë ndëshkimore-përmirësuese burgu Ohër për fëmijët e gjinisë mashkullore, ndërkaq fëmijët e gjinisë femërore dërgohen në njësinë për femra në kuadër të Shtëpisë ndëshkimore-përmirësuese Idrizovë në Shkup.

Tabela 11.

	Numri i përgjithshëm i fëmijëve ndaj të cilëve janë shqiptuar sanksione penale	Burg për fëmijë
2009	748	14
2010	547	9
2011	722	2
2012	556	7
2013	473	-
2014	461	3
2015	348	8
2016	468	4
2017	368	5
2018	330	3

Grafikon 5.



Në strukturën e sanksioneve të shqiptuara ndaj fëmijëve pjesëmarrja e dënimit burg për fëmijë në vitin 2009 paraqet 1,8%, në vitin 2010 paraqet 1,6%, në vitin 2011 paraqet 0,3%, në vitin 2012 paraqet 1,2%, në vitin 2013 nuk është shqiptuar dënim me burg për fëmijë, në vitin 2014 paraqet 0,6%, në vitin 2015 paraqet 2,2%, në vitin 2016 paraqet 0,8%, në vitin 2017 paraqet 1,3% dhe në vitin 2018 paraqet 0,9%.

Nga të dhënat e Entit shtetëror për statistikë bëjmë analizë për llojin e veprave penale për të cilat janë shqiptuar dënimet me burg për fëmijë. Kështu në vitin në vitin 2009 janë shqiptuar gjithsej 14 dënime me burg për fëmijë nga të cilat 2 për vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, 1 për vepra penale kundër shëndetit të njerëzve dhe 11 për vepra penale

kundër pasurisë, në vitin 2010 janë shqiptuar 9 dënime me burg për fëmijë nga të cilat 1 për vepër penale kundër jetës dhe trupit, 7 për vepra penale kundër pasurisë dhe 1 për vepër penale kundër rendit dhe qetësisë publike, në vitin 2011 janë shqiptuar 2 dënime me burg për fëmijë dhe atë të dyja për vepra penale kundër pasurisë, në vitin 2012 janë shqiptuar gjithsej 7 dënime me burg për fëmijë dhe atë për vepra penale kundër pasurisë, 2013 nuk është dënuar asnjë fëmijë, në vitin 2014 janë shqiptuar 3 dënime me burg për fëmijë dhe atë për vepra penale kundër pasurisë, në vitin 2015 janë shqiptuar 8 dënime me burg për fëmijë nga të cilat 2 për vepra penale kundër jetës dhe trupit, 1 për vepër penale kundër lirisë dhe moralit gjinor dhe 5 për vepra penale kundër pasurisë. Në vitin 2016 janë shqiptuar 4 dënime me burg për fëmijë dhe atë 1 për vepër penale kundër jetës dhe trupit, 1 për vepër penale kundër lirisë dhe moralit gjinor, 1 për vepër penale kundër shëndetit të njerëzve, 1 për vepër penale kundër detyrës zyrtare, në vitin 2017 janë shqiptuar 3 dënime me burg dhe atë për vepra penale kundër pasurisë dhe 1 për vepër penale kundër jetës dhe trupit dhe 2018 janë shqiptuar 3 dënime me burg për vepra penale kundër pasurisë⁹³.

⁹³www.stat.gov.mk

Nga të dhënat e Entit shtetëror për statistikë bëjmë analizë për kohëzgjatjen e dënimeve me burg për fëmijë të shqiptuara në periudhën kohore 2009-2018.

Tabela 12.

Viti	Gjithsej	Deri 10 vjet	Nga 8 deri 10 vjet	Nga 5 deri 8 vjet	Nga 3 deri 5 vjet	Nga 2 deri 3 vjet	Deri 2 vjet
2009	14	/	/	/	1	5	8
2010	9	/	1	/	1	4	3
2011	2	/	/	/	/	/	2
2012	7	/	/	/	1	1	5
2013	-	/	/	/	/	/	/
2014	3	/	/	/	/	/	3
2015	8	/	/	/	/	1	7
2016	4	/	1	/	/	/	3
2017	5	/	/	1	3	/	1
2018	3	/	/	1	/	1	1

Nga tabela mund të konstatojmë se fëmijëve në të shumtën e rasteve u janë shqiptuar dënime në kohëzgjatje më të shkurtër deri 2 vjet, ndërkaq vetëm në dy herë është shqiptuar dënim me burg nga 8 deri 10 vjet dhe atë për një herë në vitin 2010 dhe një herë në vitin 2016. Nga të dhënat e Entit shtetëror për statistikë mund të konstatojmë se dënimet me burg të shqiptuara në vitin 2010 dhe 2016 në kohëzgjatje nga 8 deri 10 vjet janë shqiptuar për vepra penale kundër jetës dhe trupit⁹⁴.

Nga të dhënat e Këshillit shtetëror për prevencionin e delikuencës së fëmijëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku si indikator merren gjykatat me kompetencë të zgjeruar mund të konstatojmë në vitin 2016 janë sjellë dy vendime për lirim me kusht nga mbajtja e dënimit burg për fëmijë dhe atë një nga ana e gjykatës së Shkupit dhe një nga ana e gjykatës së Shtipit dhe në vitin 2018 janë sjellë gjithsej 4 vendime për lirim me kusht nga mbajtja e dënimit me burg për fëmijë. Ndërkaq, sa i përket revokimit nga lirimi me kusht për mbajtjen e dënimit me burg nga ana e gjykatave kjo është bërë njëherë në vitin 2016 me vendim të gjykatës së Shkupit.

⁹⁴ www.stat.gov.mk

Në qoftë se bëjmë krahasim me numrin e përgjithshëm të sanksioneve penale të shqiptuara ndaj fëmijëve në periudhën kohore 2009-2018 mund të konstatojmë se dënimi me burg për fëmijë është shqiptuar shumë rrallë që është në pajtim me qëllimet e Ligjit për drejtësi për fëmijë.

2.2. Dënimi me para

Dënimi me para mund të shqiptohet si dënim kryesor. Për veprat e kryera nga lakmia e përfitimit, dënimi me para mund të shqiptohet si dënim dytësor së bashku me dënimin me burg për fëmijë ose dënimin me kusht me mbikëqyrje të përforcuar⁹⁵.

Dënimi me para shqiptohet në gjoba ditore me zbatimin e dispozitave të Kodit penal, gjatë së cilës numri i gjobave ditore nuk mund të jetë më i vogël se një e as më i madh se 120 gjoba ditore. Dënimi në para i papaguar mund ta zëvendësohet me masë alternative punë në interes të përgjithshëm, gjatë së cilës një gjobë ditore zëvendësohet me tre orë punë në përgjithshme, ndërsa numri i përgjithshëm i punës në dobi të përgjithshme nuk mund të jetë më i lartë se 100 orë⁹⁶. Nëse në mënyrë decide ndiqet teksti i dispozitës del se i është lënë në dispozicion gjykatës nëse do të përcaktojë ose jo punë në interes të përgjithshëm si zëvendësim për dënimin me para, gjatë kësaj duke mos mbajtur llogari për pajtueshmërinë e marrë nga ana e të fëmijës. Duke u nisur nga natyra e punës në interes të përgjithshëm në praktikë gjykata para se të zëvendësojë dënimin me para duhet ta vërtetojë pajtueshmërinë e fëmijës, t'ia sqaroj natyrën e këtij dënimi alternativ, përparësitë e saj dhe pasojat në rast të mospërmbushjes së angazhimit me punë që e përbën përmbajtjen e punës në dobi të përgjithshme.

Dënimin e papaguar me para ose punën me dobi të përgjithshme të pakryer ose pjesërisht të kryer si zëvendësim të saj, gjykata mund ta zëvendësojë edhe me masën dërgim në qendrën për fëmijë, ose me masën mbikëqyrje e përforcuar⁹⁷.

⁹⁵ Neni 54 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

⁹⁶ Neni 55 paragrafi 1 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

⁹⁷ Neni 55, paragrafi 2 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

Procedurën e pagesës së dënimit me para sipas detyrës zyrtare e inicion gjykata e cila e ka shqiptuar dënimin e shkallës së parë. Në qoftë se fëmija nuk ka vendbanim, gjegjësisht vendqëndrim në selinë e gjykatës e cila e ka shqiptuar dënimin e para të shkallës së parë, atëherë gjykata e shkallës së parë është e obliguar t'ia dorëzojë vendimin e plotfuqishëm për pagesë të dënimit me para gjykatës sipas vendbanimit, gjegjësisht vendqëndrimit. Në qoftë se fëmija i dënuar në afatin e paraparë nuk e paguan dënimin me para, kalohet në pagesën e detyrueshme. Shpenzimet e pagesës së detyrueshme të dënimit me para janë në barrë të personit të dënuar. Gjykatësi për zbatimin e sanksioneve para se t'i qaset pagesës së detyrueshme, personit të dënuar i dërgon vërejte ta paguajë dënimin me para në afat i cili nuk mund të jetë më gjatë se 15 ditë nga dita e pranimin të vërejtjes. Në qoftë se personi i dënuar në afatin e paraparë nuk e paguan dënimin zbatohet pagesa e detyrueshme. Në qoftë se pagesa e detyrueshme rezulton pa sukses, dënimi me para do të zëvendësohet me dënim me burg⁹⁸.

Në qoftë se personi i dënuar me vendim të plotfuqishëm nuk mund ta paguajë dënimin me para menjëherë, dorëzon kërkesë për pagesën në këste, mirëpo afati i pagesës nuk mund të jetë më i gjatë se dy vjet, me mundësi për vazhdimin e afatit edhe për tre muaj. Në qoftë se personi i dënuar nuk i paguan në kohë këstet, gjykata do ta revokojë vendimin e tij për pagesën në këste dhe do të zbatojë pagesën e detyrueshme ose do ta zëvendësojë me burg⁹⁹.

2.3. Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik

Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik të një lloji të caktuar apo kategorisë së caktuar mund t'i shqiptohet fëmijës të moshës mbi 16 vjeçare me përgjegjësi penale për vepër penale me të cilën rrezikohet trafiku publik, nëse vepra është kryer në gjendje të dehur gjegjësisht, nëse me të cenohen rregullat e trafikut. Kohëzgjatja e ndalesës për drejtimin e automjetit motorik nuk mund të jetë më e shkurtër se 3 muaj e as më e gjatë se pesë vjet, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit. Gjykata mund të përcaktojë ndalesë për nxjerrjen e patentë shoferit fëmijës që ka mbushur 16 vjet derisa zgjat ndalesa. Gjatë shqiptimit të

⁹⁸ Neni 263 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

⁹⁹ Neni 306 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

aktgjykimit me kusht gjykata mund të përcaktojë se ajo do të revokohet nëse fëmija nuk e respekton ndalesën për drejtimin e automjetit. Gjatë shqiptimit të dënimit ndalesë e drejtimit të automjetit si dënim i vetëm, gjykata njëkohësisht do të përcaktojë dënim para ose dënimin burg për fëmijë i cili do të ekzekutohet nëse fëmija e shkel ndalesën për drejtimin e automjetit.

Aktgjykimin e plotfuqishëm me të cilin është shqiptuar ndalimi i drejtimit të automjetit motorik gjykata kompetente ia dorëzon për zbatim stacionit policor të rajonit të caktuar sipas vendbanimit, gjegjësisht vendqëndrimit të personit të dënuar të cilit i është shqiptuar kjo masë. Ekzekutimi i dënimit realizohet me shënimin në patentën e shoferit të ndalesës për drejtim me mjetin motorik të një lloji dhe kategorie të caktuar ose me ndalesën për lëshimin e saj personit të dënuar për kohën për të cilën i është shqiptuar dënimi¹⁰⁰.

2.4. Dëbimi i të huajit nga vendi

Dëbimi i të huajit nga vendi shqiptohet me kushte për shqiptimin e tyre të parapara në Kodin penal. Neni 38-g i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut parasheh që gjykata mund që personit që nuk është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i shqiptojë dënimin dëbim nga vendi kur do të vlerësojë se natyra e veprës, dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra flasin për padëshirueshmërinë e qëndrimit të mëtejshëm të të huajit në vendin tonë. Dënimi dëbim i të huajit nga vendi mund të zgjasë nga një deri në dhjetë vite, ose përgjithmonë dhe nis nga dita e dëbimit të të huajit nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Ky dënim nuk mund t'i shqiptohet personit i cili gëzon mbrojtje në pajtim me dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara. Aktgjykimi i plotfuqishëm me të cilin është shqiptuar dënimi dëbim i të huajit nga vendi, gjykata kompetente ia dorëzon në zbatim Ministrisë së punëve të brendshme.

¹⁰⁰ Neni 268 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

3. Masat alternative

Masat alternative të cilat ju shqiptohen fëmijëve zbatohen në shoqëri, me kontribut aktiv dhe angazhimin e tij të drejtpërdrejtë, si dhe me involvimin e drejtpërdrejtë të familjes si qelizë primare sociale për zhvillimin dhe edukimin e fëmijës. Koncepti i zbatimit të masave alternative qëndron në pjesëmarrjen aktive të organeve sociale të cilët zbatojnë procedura dhe metoda jorepresive. Masat alternative paraqesin masa të cilat nuk kanë për qëllim privimin nga liria të fëmijës por e lejnë atë në liri, mirëpo i imponojnë kufizime, nëpërmjet kushteve dhe obligimeve të veçanta zbatimi i të cilave është në kompetencë të organeve të themeluara me ligj me qëllim zbatim të këtyre sanksioneve dhe masave¹⁰¹.

Masat alternative u bënë pjesë e sistemit të sanksioneve me sjelljen e Ligjit për drejtësinë e të miturve të vitit 2007 me çka edhe Republika e Maqedonisë së Veriut kyçet në familjen e shteteve të cilat kanë shumëllojshmëri të sanksioneve si reagim të mundshëm për delikuencën fëmijëve. Me masat alternative inkorporohet tendenca për humanizmin dhe efektuimin e së drejtës penale me shmangien e privimit afatshkurtër nga liria dhe mundësojnë dënimin në liri në rrethin social ku fëmija jeton dhe mëson. Promovimi i formave alternative të dënimit dhe pranimi i modeleve diverzive kontribuoi për përforcimin e përpjekjeve për definimin e standardeve për sanksionet dhe masat të cilat do të mund të zbatohen në rastet kur fëmijët paraqiten si kryes të veprave penale.

Masat alternative mund t'i shqiptohen fëmijës me përgjegjësi penale mbi moshën 16 vjet, gjatë së cilës zbatohen dispozitat e Kodit penal në aspekt të masave alternative, nëse në Ligjin mbi drejtësi për fëmijë nuk është përcaktuar ndryshe. Fëmijës me përgjegjësi penale mbi moshën 16 vjet për veprim të kryer që me ligj parashihet si vepër penale, mund t'i shqiptohen masat alternative në vijim:

1. dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse
2. ndërprerje me kusht të mbajtjes së procedurës ndaj fëmijës dhe
3. punë me dobi të përgjithshme.

¹⁰¹ Лажетик – Бужаровска, Гордана, Овластувањата на центрите за социјална работа и на јавниот обвинител во мамлолетничката правда, Zbornik PFZ, 61, (2) 441-468 (2011), fq. 453

Qëllimi i masave alternative është që për përgjegjësi penale ndaj fëmijës mbi moshën 16 vjet të mos zbatohet dënimi kur kjo nuk është e detyrueshme për pengimin e kryerjes së veprimeve që me ligj janë paraparë si vepra penale dhe kur mund të pritët se paralajmërimi me kërcënim të dënimit dhe zbatimi i masave të ndihmës, mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në liri, mjaftueshëm do të ndikojë në edukimin, riedukimin dhe zhvillimin e drejtë të tij¹⁰². Masat alternative gjykata mund t'i shqiptojë vetëm kur ekziston vullnet i lirë i shprehur dhe i prerë i fëmijës, në procedurë në të cilën respektohen të drejtat e tij¹⁰³.

Masat alternative zbatohen pas plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor me të cilin ata janë shqiptuar. Masat alternative i zbaton njësia për zbatimin e masave alternative në Qendrën për punë sociale kompetente sipas vendbanimit, gjegjësisht vendqëndrimit të fëmijës. Njësia është e përbërë nga persona profesionist të cilët posedojnë leje për zbatimin e masave alternative, të cilën e nxjerr Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Njësia përcakton plan dhe programë individuale për zbatimin e masave alternative, të përshtatur me llojin e veprës penale, personalitetin e fëmijës, gjendjen familjare të tij, statusin ekonomik dhe me përmbushjen e obligimeve të caktuara nga ana e fëmijës, në qoftë se ata përcaktohen. Njësia mban evidencë amë dhe dosje për fëmijën gjatë realizimit të ekzekutimit të masës alternative dhe për këtë rregullisht e njofton Drejtorinë për zbatimin e sanksioneve. Njësia kohë pas kohe e së paku një herë në muaj ose me kërkesë të gjykatës do ta njoftojë gjykatën për rezultatet e zbatimit të masës alternative dhe realizimin e obligimeve nga ana e fëmijës, në qoftë se të njejtat janë përcaktuar¹⁰⁴. Në qoftë se fëmija nuk e pranon masën alternative, njësia duhet që ta njoftojë gjykatën. Mbikëqyrje ndaj ligjshmërisë në ekzekutimin e masave alternative bën gjykata që e ka shqiptuar masën. Mbikëqyrje profesionale ndaj zbatimit të masave alternative bën Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve.

¹⁰² Neni 61 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

¹⁰³ Neni 62 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

¹⁰⁴ Neni 370 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19)

3.1. Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse

Dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse mund të shqiptohet kur fëmijës i është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej tre vitesh ose dënim me para¹⁰⁵. Nëse fëmijës i është shqiptuar edhe dënimi burg për fëmijë edhe dënim me para, dënimin me kusht gjykata mund ta shqiptojë për të dyja dënimet ose vetëm për dënimin burg për fëmijë. Kohën e kontrollit gjykata e përcakton në kohëzgjatje e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një e as më e gjatë se tre vjet. Mbikëqyrja mbrojtëse përbëhet nga një ose me shumë obligime të parapara si obligime të veçanta të cilat mund t'i shqiptohen ndaj ndonjëres prej masave edukative me mbikëqyrje mbrojtëse, ndaj të cilave fëmija duhet t'u përmbahet gjatë kohëzgjatjes së kontrollit. Ndhmën dhe përkujdesjen, mbikëqyrjen dhe mbrojtje lidhur me përmbushjen e obligimeve nga ana fëmijës e bën njësia për ekzekutimin e masave alternative pranë Qendrës për punë sociale, e cila është e obliguar me këshilla praktike ta nxisë dhe të ndihmojë në përmbushjen e tyre, të bashkëpunojë me prindin/ët, ose tutorin/ët dhe herë pas here e së paku një herë në tre muaj, ta njoftojë gjykatën për gjendjet me plotësimin e obligimeve të caktuara.

Gjykata do ta revokojë dënimin me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur nëse fëmija në kohën e kontrollit nuk i plotëson obligimet e përcaktuara ose kryen një ose më shumë veprime që me ligj janë paraparë si vepra penale, për të cilat është përcaktuar dënim me burg për fëmijë në kohëzgjatje më të gjatë se tre vite, ose nëse pas shqiptimit të dënitimit me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur konstaton se fëmija ka kryer veprime që me ligj është paraparë si vepër penale para se të shqiptohet dënimi me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur dhe se është i domosdoshëm dënimi për veprime të kryera paraprakisht që me ligj janë paraparë si vepra penale.

Njësia pranë Qendrës për punë sociale në planin për realizimin e mbikëqyrjes mbrojtëse, e përcakton llojin, kohëzgjatjen dhe realizimin e mbikëqyrjes e cila duhet të realizohet në aspekt të plotësimin të obligimeve të veçanta nga ana e personit të dënuar¹⁰⁶. Tek ky lloj i masës

¹⁰⁵ Neni 62 paragrafi 2 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

¹⁰⁶ Neni 373 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19))

alternative ekipi multidisiplinar i njësisë pranë Qendrës për punë sociale përgatit plan për zbatim, në të cilin duhet të përpunohet veçanërisht zbatimi i secilit obligim veçmas, me tajming, dinamikë, kohë dhe vend për zbatimin dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes mbrojtëse. Edhe gjatë formimit të përbërjes së ekipit dhe gjatë zgjedhjes së inspektorit për kryerjen e mbikëqyrjes mbrojtëse duhet të mbahet llogari për përmbajtjen e obligimeve të shqiptuara. Gjatë kohës së implementimit të masës ekzistojnë tre lloje të obligimeve të Qendrës për punë sociale:

-lloji i parë paraqet punë me fëmijën e cila përbëhet nga ndihma dhe mbrojtja, por edhe mbikëqyrja dhe mbrojtja në përmbushjen e obligimeve, gjatë së cilës fëmijës duhet t'i jepen këshilla praktike për atë si duhet të veprojë drejtë, të nxitet për përmbushjen e obligimeve në mënyrë të drejtë, në kohë dhe kryerjen e plotësishme të tyre. Por, njëkohësisht të punohet edhe në tejkalimin e vështirësive të cilat mund të paraqiten për shkak të sjelljes jo serioze të fëmijës, shkallës së pamjaftueshme të pjekurisë përballë grupit të moshës së cilës i takon. Në fakt, personi përgjegjës i Qendrës për punë sociale duhet t'i kryejë punët që janë në sferën e veprimit të nëpunësit të probacionit i cili duhet të ushtrojë përpjekje, aftësi, durim dhe përvojë me qëllim të përmbushjes së suksesshme të masës¹⁰⁷.

-lloji i dytë janë obligimet të cilat përbëhen nga bashkëpunimi me prindin/ërit ose tutorin/ët, me çka duhet të kihen parasysh dy gjëra: faktin se ata kanë bërë lëshime në kujdesin prindëror andaj fëmija ka kryer sjellje kriminale dhe nevojën që edhe atë të jenë të njoftuar me përmbajtjen e obligimeve, mënyrën e zbatimit të tyre dhe pasojat nga mospërmbushja e obligimeve;

-lloji i tretë i obligimeve kanë të bëjnë me raportin e gjykatës, me atë që Ligji parasheh që së paku një herë në tre muaj Qendra për punë sociale duhet ta njoftojë gjykatën për rrjedhën e zbatimit të masës.

Gatë kohës së zbatimit, e në varësi nga rrjedha e saj dhe suksesi i arritur, ekipi në emër të Qendrës për punë sociale do të dorëzojë propozim deri të gjykata të cilat mund të jenë në 4 drejtime: zëvendësim i obligimeve të shqiptuara me obligime tjera; vazhdimin e kohëzgjatjes së

¹⁰⁷ Лажетик – Бужаровска, Гордана, Овластувањата на центрите за социјална работа и на јавниот обвинител во малолетничката правда, Zbornik PFZ, 61, (2) 441-468 (2011), fq. 454

mbikëqyrjes mbrojtëse në suaza të kohëzgjatjes së paraparë me ligj të kohës së kontrollit (nga 1 deri 3 vjet); revokim të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse; ndërprerjen e parakohshme të masës në qoftë se vlerëson se janë arritur qëllimet e saj¹⁰⁸.

Pas përfundimit të zbatimit të masës, inspektori përpilon raport përmbyllës.

Nga të dhënat e Raporteve vjetore të Këshillit shtetëror për preventimin e delikuencës së fëmijëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku si indikator merren gjykatat me kompetencë të zgjeruar mund të konstatojmë se kjo masë është shqiptuar në vitin 2016 dhe atë ndaj dy fëmijëve dhe atë një me vendim të gjykatës së Shkupit dhe një me vendim të gjykatës së Ohrit dhe në vitin 2018 janë sjellë gjithsej 8 vendime për dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse.

3.2. Ndërprerja me kusht e procedurës

Kjo masë alternative ka karakter procedural dhe dallon nga llojet tjera të masave alternative pasi që qëllimi i shtyrjes me kusht të procesit është e kushtëzuar me përmbushjen e kushteve të përcaktuara me Ligjin për drejtësi për fëmijë. Natyra e kësaj mase është të kontribuojë që kryesi të përmbahet nga kryerja e mëtejme e veprave penale, gjegjësisht nga kryerja e serishme e sjelljeve kriminale, mirëpo edhe në përfundimin e përgjegjësisë personale të tij. Gjykata mund të vendosë që kushtimisht ta ndërpresë procedurën ndaj fëmijës për veprë penale për të cilën është e paraparë dënim me para ose dënim me burg deri më pesë vjet nëse është përmbushur njëri prej kushteve në vijim: a) nëse fëmija ka shprehur pendesë për veprën e kryer; b) i ka evituar pasojat e veprës; c) e kompenson dëmin ose d) ka arritur pajtim me të dëmtuarin, i cili është pajtuar me ndërprerjen e procedurës, me kusht që në afat prej dy vitesh të mos kryej veprim tjetër që me ligj është paraparë si veprë penale¹⁰⁹.

Nga të dhënat e Raporteve vjetore të Këshillit shtetëror për prevencionin e delikuencës së fëmijëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku si indikator merren gjykatat me

¹⁰⁸ Neni 374 i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 99/19...220/19))

¹⁰⁹ Neni 63 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

kompetencë të zgjeruar mund të konstatojmë se kjo masë është shqiptuar në vitin 2015 dhe atë në 29 raste të gjitha me vendime të gjykatës së Shkupit..

3.3. Puna në dobi të përgjithshme

Puna në dobi të përgjithshme përbëhet nga kryerja e punës pa pagesë në dobi të bashkësisë gjatë numrit saktësisht të caktuar të orëve gjatë kohës së lirë të fëmijëve, pas marrjes së pajtimit paraprak nga ana e tij. Angazhimi në punë për nga natyra ka veprim dënues, terapeutik, por edhe reparativ me përmbajtje të theksuara edukative, rritjen e shkathtësive dhe aftësive tek fëmija. Puna kryhet nëpër institucione mjekësore, organizata humanitare, ndërmarrje publike dhe komunale në bashkëpunim me shkollat, institucionet për edukimin e fëmijëve dhe ngjashëm.

Gjykata mund që fëmijës mbi moshën 16 vjeçare penalisht përgjegjës i cili ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë dënim me para ose dënim me burg deri tre vjet t'i shqiptojë masë punë në dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej pesë deri në njëqind orë, në rastet kur është e nevojshme me këtë masë të bëhet ndikim edukativ ndaj personalitetit dhe sjelljes së fëmijës. Mbikëqyrje ndaj përmbushjes së obligimeve të punës së fëmijës kryen qendra për punë sociale, e cila është e obliguar që së paku një herë në muaj ta njoftojë gjykatën për zbatimin e masës. Nëse fëmija nuk i përmbush obligimet ose këtë nuk e bën në mënyrë të duhur, gjykata do ta zëvendësojë këtë masë me masës dërgim në qendër për fëmijë ose me masë të mbikëqyrjes së përforcuar, nën kushtet e parapara për shqiptimin e tyre, duke e pasur parasysh pjesën e obligimeve të cilat tani më janë plotësuar.

Për zbatimin e punës në dobi të përgjithshme, Drejtoria për zbatimin e sanksioneve lidh marrëveshje për punë në interes të përgjithshëm me organ shtetëror, ndërmarrje publike, institucion, njësi të vetëqeverisjes lokale ose me organizatë humanitare në të cilin fëmija do t'i zbatojë obligimet e tij të punës. Për lidhjen e këtyre marrëveshjeve Drejtoria për zbatimin e sanksioneve penale e njofton Qendrën për punë sociale dhe gjykatësin për ekzekutimin e sanksioneve. Gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve e dorëzon vendimin deri të Qendra për punë sociale, ku formohet ekip multidisiplinar i cili do të përgatisë plan për realizimin e

obligimeve të punës, duke caktuar ditën dhe kohën kur fillon zbatimi i masës si dhe vendin ku do ta zbatohet puna në dobi të përgjithshme. Gjatë kësaj, parashihet edhe intervali kohor gjatë ditës kur zbatohet puna dhe orari javor në qoftë se puna kryhet në ndërrime

Njësia e Qendrës për punë sociale më së voni në afat prej 15 ditësh do të përcaktojë inspektor i cili do të kryejë mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë ndaj zbatimit të punës së përgjithshme. Personi i caktuar nga ana e Qendrës për punë sociale kontrollon nëse fëmija është paraqitur në kohë në vendin për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme, por edhe kontakton me udhëheqësin e organit, organizatës ose shoqatës ku kryhet puna në dobi të përgjithshme me qëllim që të marrë informata për sjelljen e fëmijës dhe raportit të tij ndaj punës.

Në qoftë se fëmija nuk i plotëson ose këtë nuk e bën në mënyrën e duhur, njësia, gjegjësisht ekipi në koordinim me inspektorin për zbatim i ndërmerr masat në vijim: në fillim do ta paralajmërojë fëmijën, dhe për paralajmërimin e tillë e njofton gjykatën; në qoftë se mosrespektimi vazhdon, vijon vërejtje me shkrim me akcentim të pasojave të mundshme nga mosrealizimi i suksesshëm i punës në dobi të përgjithshme; Në qoftë se fëmija edhe pas vërejtjes me shkrim nuk i plotëson ose jorregullisht i plotëson obligimet e punës, Qendra për punë sociale dorëzon propozim deri të gjykata edhe atë: a) për rritjen e numrit të orëve për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme; b) vazhdimin e kohëzgjatjes së masës ose c) zëvendësimin e kësaj me masën mbikëqyrje në qendër për më fëmijë ose me masën e mbikëqyrjes së përforcuar, nën kushtet e parapara për shqiptimin e tyre, duke mbajtur llogari për pjesën e obligimeve që janë plotësuar¹¹⁰.

Nga të dhënat e Raporteve vjetore të Këshillit shtetëror për prevencionin e delikuencës së fëmijëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku si indikator merren gjykatat me kompetencë të zgjeruar mund të konstatojmë se kjo masë nuk është shqiptuar nga ana e gjykatave të vendit në periudhën të cilën e analizojmë në këtë punim.

¹¹⁰ Лажетик – Бужаровска, Гордана, Овластувањата на центрите за социјална работа и на јавниот обвинител во малолетничката правда, Zbornik PFZ, 61, (2) 441-468 (2011), fq. 455

4. Masat e sigurisë

Ligji për drejtësi për fëmijë në aspekt të masave të sigurisë udhëzon në kushtet e parapara në Kodin penal kur ndaj fëmijës në bashkëngjitje të masës edukative ose dënimit mund t'i shqiptohet masa e sigurisë:

1. mjekim i obligueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor,
2. mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri ose
3. mjekim i detyrueshëm i alkoolikëve dhe narkomanëve.

Në pajtim me Kodin penal, qëllimi themelor i masave të sigurisë është të mënjanoen gjendjet ose kushtet të cilat kanë ndikuar për kryerjen e veprës penale dhe me largimin e tyre mund të besohet se fëmija në të ardhmen do të përmbahet nga kryerja e veprave penale. Koha e kaluar në institucion për zbatimin e masës së sigurisë llogaritet në dënimin e shqiptuar me burg për fëmijë ose masës së entit¹¹¹. Pas zbatimit të masës së sigurisë, gjykata do të vendosë nëse do të vazhdojë realizimi i dënimit me burg për fëmijë dhe masa e entit.

4.1. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe qëndrimi në institucion shëndetësor

Ndaj fëmijës të papërgjegjshëm nën kushtet e parapara me Kodin penal mund të shqiptohet masa e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe qëndrim në institucion shëndetësor. Kodi penal parasheh se fëmijës i cili ka kryer vepër penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose përgjegjshmërisë së zvogëluar, gjykata do t'i shqiptojë mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe qëndrim në institucion shëndetësor nëse konstaton se për shkak të gjendjes së tillë mund të kryejë sërish vepër penale dhe se për largimin e këtij rreziku është i nevojshëm shërimi i tij dhe qëndrimi në institucion shëndetësor. Këtë masë gjykata do ta ndërpresë kur do të konstatojë se është ndërprerë nevoja për shërim dhe ruajtje të fëmijës në institucion shëndetësor.

Nga të dhënat e Këshillit shtetëror për preventimin e delikuencës së fëmijëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku si indikator merren gjykatat me kompetencë të zgjeruar

¹¹¹ Neni 65 paragrafi 5 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

mund të konstatojmë se kjo masë është shqiptuar një herë në vitin 2015 ndaj një fëmijë me vendim të gjykatës së Ohrit, në vitin 2017 ndaj një fëmije me vendim të gjykatës së Koçanit dhe në vitin 2018 ndaj një fëmije me vendim të gjykatës së Gostivarit.

4.2. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri

Ndaj fëmijës të papërgjegjshëm nën kushtet e parapara me Kodin penal mund të shqiptohet masa e sigurisë shërim i detyrueshëm psikiatrik në liri i cili në pajtim me dispozitat e Kodit penal mund t'i shqiptohet fëmijës i cili në gjendje të papërgjegjshmërisë ose përgjegjësisë së zvogëluar ka kryer vepër penale, nëse konstaton se për shkak të gjendjes së tillë mund që sërish të kryejë vepër penale, ndërsa për largimin e këtij rreziku mjafton mjekimi i tij në liri. Kjo masë mund t'i shqiptohet kryesit të papërgjegjshëm ose me përgjegjësi të zvogëluar penale ndaj të cilit është shqiptuar mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësor, kur gjykata në bazë të rezultateve të mjekimit do të përcaktojë se nuk është i nevojshëm ruajtja e tij dhe mjekimi në institucion shëndetësor, por vetëm në liri. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri në rastet kur shqiptohet kryesit me përgjegjësi të zvogëluar nuk mund të jetë më e gjatë se dy vjet.

4.3. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolikëve dhe narkomanëve

Në pajtim me dispozitat e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut fëmijës i cili ka kryer vepër penale për shkak të varësisë nga përdorimi i vazhdueshëm i pijeve alkoolike, drogave dhe substancave tjera psikotrope kur ekziston rreziku për shkak të kësaj varësie edhe më tej të kryejë vepra penale, gjykata mund t'i shqiptojë masë të mjekimit të detyrueshëm, i cili zbatohet në institucion për zbatimin e dënimit ose në institucion shëndetësor ose në institucion tjetër të specializuar gjatë së cilës koha e kaluar në institucion llogaritet në sanksionin e shqiptuar. Masa mjekim i detyrueshëm i alkoolikëve dhe narkomanëve mund të shqiptohet

edhe pa shqiptimin e masës edukuese ose dënimit, ndërkaq nëse shqiptohet se bashku me masën edukuese ose dënimin, ajo të zbatohet në njësinë e specializuar të institucionit¹¹².

¹¹² Neni 65 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 148/13...152/19)

KAPITULLI VII

Praktikat e institucioneve kompetente për ekzekutimin e masave/sanksioneve penale ndaj fëmijëve

Institucioni ndëshkimor-përmirësueses Burgu Ohër paraqet institucion ndëshkimor përmirësues në të cilin dërgohen fëmijë të gjinisë mashkullore për mbajtjen e dënimit me burg për fëmijë, të rritur të rinj të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për mbajtjen e dënimit me burg, si dhe për persona të gjinisë mashkullore dhe femërore ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit për rrethinën e gjykatave themelore Dibër, Ohër dhe Strugë, përveç për paraburgimin e përcaktuar për vepra penale për të cilat është e paraparë së paku 10 vjet burgim ose burgimi i përjetshëm¹¹³.

Institucioni ndëshkimor-përmirësueses Burgu për fëmijë Ohër sipas shkallës së sigurimit, nivelit të kufizimit të lirisë paraqet institucion ndëshkimor-përmirësues të tipit gjysmë të hapur në të cilin sigurim kryesor paraqet sigurimi fizik të cilin e realizojnë pjesëtarët e sektorit të sigurimit.

Objekti i burgut është i ndarë fizikisht në dy pjesë: pjesa ku mbahet dënimi me burg dhe pjesa ku janë të vendosur personat të cilët gjenden në paraburgim

Nga viti 2015 në kuadër të objektit të Institucioni ndëshkimor-përmirësueses Burgu për fëmijë Ohër funksionon edhe Shtëpia edukuese-përmirësuese Tetovë. Shtëpia edukuese-përmirësuese funksionin e saj e kryen përmes: repartit për pranim, grupit të parë edukues, grupit të dytë edukues, repartit me ndikim pedagogjik të përforcuar dhe hapësirën për masë disiplinore. Me Shtëpinë edukuese-përmirësuese udhëheq drejtori dhe zëvendësdrejtori, tre udhëheqës të reparteve, komandanti dhe komisari.

Pjesa në të cilën janë vendosur fëmijët të cilët e mbajnë masën e entit-dërgim në shtëpi edukuese-përmirësuese gjendet në vetë objektin ku janë të vendosur edhe fëmijët të cilët janë të dënuar me burg për fëmijë, me atë që fëmijët e Shtëpisë edukuese-përmirësuese janë të

¹¹³ Решение за распоредување на осудените, казнетите и малолетните лица во казнено-поправните и воспитно-поправните установи („Службен весник на Република Македонија“ бр. 84/2008)

vendosur në katin e parë në pjesën e parme të institucionit, e cila me derë është e ndarë nga pjesa e burgut.

Kushtet e zbatimit të masës edukuese dërgim në Shtëpi edukuese përmirësuese dhe zbatimit të dënimit burg për fëmijë mund të konstatohen nga raportet e organeve kompetente të cilat veprojnë në fushën e mbrojtjes, ndihmës dhe përkrahjes së fëmijëve dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve të cilët gjenden nëpër institucione.

Në bazë të Raportit të veçantë për konstatimin e gjendjes në Shtëpinë edukuese-përmirësuese Tetovë dhe Burgun për fëmijë Ohër të Avokatit të popullit të muajit korrik të vitit 2019 në punën e tyre janë hasur më shumë lloje të mangësive për të cilat Avokati i popullit ka dalë me konstatime dhe vërejtje. Në raport theksohet se gjendja thuhet se aspak nuk ka nëse bëhet krahasimi me raportin e Avokatit të popullit të vitit 2016.

Kështu Avokati i popullit del me vërejtje lidhur me lokacionin objekti të burgut për fëmijë në Ohër i cili gjendet në afërsi të qendrës së qytetit dhe kjo e vë në pikëpyetje funksionimin e procesit riedukues, ndikon në tundimin për arratisje të fëmijëve si dhe rrezikimin e privatësisë së fëmijëve.

Në Raport theksohet se oborri i institucionit ndëshkimor-përmirësues është i ndarë në dy pjesë me gardh kallaji dhe atë një pjesë për Shtëpinë edukuese-përmirësuese dhe një për fëmijët të cilët e mbajnë masën e burgut për fëmijë. I njëjti shfrytëzohet për aktivitete sportive dhe lëvizje në ajër të pastër. Vërejtja e Avokatit të Popullit qëndron në faktin se fëmijët e Shtëpisë edukuese-përmirësuese vështirë mund të mbahen të ndarë nga fëmijët tjerë të cilët e mbajnë masën burg për fëmijë dhe ata janë në kontakt të vazhdueshëm që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Për shkak të situatës së këtillë, përkatësisht përzierjes së fëmijëve me personat e dënuar, nuk ka kushte për zhvillimin normal të aktiviteteve sportive, të njëjtat zhvillohen nën mbikëqyrje rigoroze dhe të vazhdueshme të shërbimit për sigurim, me qëllim që të evitohen konfliktet ndërmjet tyre dhe ndikimi ndaj fëmijëve, si dhe konfliktet eventuale.

Fëmijët e Shtëpisë edukuese-përmirësuese e mbajnë masën edukuese në tre hapësira, të shpërndarë në dy grupe edukuese: një grup edukues me ndikim të përforcuar dhe një grup edukues i tipit të hapur. Në hapësirën e parë kanë qenë të vendosur 2 fëmijë, dhe në të dytën

dhe të tretën nga 5 fëmijë që është në pajtim me nenin 341 të Ligjit për zbatimin e sanksioneve, i cili përcakton se grupet edukuese mund të përfshijnë nga 5 deri 7 fëmijë.

Avokati i popullit në Raport ka konstatuar se nuk ekziston qasje multidisiplinare në trajtimin me fëmijët. Kuadri i vetëm profesional i cili është i involvuar në dhënien e ndihmës dhe trajtimit profesional me fëmijët janë dy psikologë, të cilët sipas sistematizimit evidentohen si edukator. Ata kryejnë funksionin e edukatorëve dhe të punonjësve social, për shkak të mungesës së këtij lloji të kuadrit profesional. Mungojnë profile tjera profesionale, si dhe pedagogë special, edukatorë dhe rehabilitues, psikoterapeut dhe persona tjerë profesional të cilët do të mund të japin qasje më gjithëpërfshirëse në trajtimin me fëmijë.

Mbrojtja shëndetësore e fëmijëve sigurohet nëpërmjet Shtëpisë së shëndetit Ohër, prej ku një herë në javë vjen mjeku i cili i kontrollon fëmijët të cilët kanë nevojë për kontroll mjekësor. Sipas nevojës mjeku vjen edhe në mënyrë plotësuese edhe me thirrje.

Nga këqyrja e dosjeve mjekësore Avokati i Popullit ka konstatuar se të gjithë fëmijët e Shtëpisë edukuese përmirësuese Tetovë dhe Burgut për fëmijë Ohër pranojnë terapi të fortë me sedativë të dhënë nga mjeku amë i Shtëpisë së shëndetit Ohër ose nga ana e mjekut specialist neuropsikiatër/psikiatër. Terapia përbëhet nga doza të shumëfishta brenda ditës (e veçanërisht të natës) të medikamenteve për qetësim: “Diazepam”, “Heleks”, “Risperidon” dhe ngjashëm nga 5 deri 20 mg në ditë, që duke pasur parasysh moshën e tyre është shumë e madhe. Avokati i popullit del me vërejtje se është e papranueshme të mos ndiqet gjendja e fëmijëve me terapi të tillë dhe të mos ju kushtohet vëmendje simptomave, e në këtë kontekst të kërkohet mendim i dytë për terapinë e këtillë të dhënë nga ana e mjekut specialist.

Gjithashtu Avokati i Popullit ka dalë më vërejtje se nuk janë të kyçur edukator special dhe rehabilitues në kuadër të shtëpisë edukuese përmirësuese edhe pse pjesa më e madhe e fëmijëve janë me pengesa (fëmijë me pengesa intelektuale të lehta ose të moderuara, e cila nuk është vërtetuar me ekspertizë ose mendim të komisionit relevant ose organit profesional, ndërsa një pjesë e fëmijëve janë me pengesa të kombinuara (krahas pengesave intelektuale tregojnë edhe shenja të çrregullimeve psikike, një pjesë e fëmijëve janë me diagnozë të Klinikës për psikiatri të fëmijëve, por ka edhe fëmijë të cilët nuk janë të diagnostikuar). Psikologët e punësuar në institucion nuk përdorin teste ose metoda të standardizuara të punës, por kanë

qasje intuitive në punë dhe përdorin përvojat nga përvoja e kaluar me kategorinë e këtillë të fëmijëve. Ata përgatisin mendim dhe ekspertizë psikologjike, por i njeti është i mangët dhe përmban informata minimale. Nga këqyrja në dosje Avokati i Popullit ka konstatuar se bëhet fjalë për fëmijë me “çrregullime në sjellje, sjellje antisociale, çrregullime të personalitetit, me shkallë të ulët të tolerancës, fëmijë impulsiv të ndjekur me sjellje devijuese, si dhe me status të ulët edukativ dhe social”. Çrregullimet e këtilla janë shpesh rezultat i lënies pas dore për vite me radhë, keqpërdorimit fizik dhe emocional nga ana e familjeve të tyre, por edhe në institucionet në të cilat kanë qenë të vendosur paraprakisht.

Nga këqyrja në evidencën e masave disiplinore, nga ana e Avokatit të Popullit është konstatuar se shqiptohet masa disiplinore-qeli në kohëzgjatje prej 5 deri 10 ditë që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare¹¹⁴. Avokati i Popullit sugjeron në të ardhmen të mbahet llogari se me Ligjin e ri për zbatimin e sanksioneve penale i cili hyri në fuqi në maj të vitit 2019 është i ndaluar zbatimi i masës-qeli ndaj fëmijëve.

Ligji për arsim fillor përcakton që çdo fëmijë ka të drejtë për arsim fillor i cili realizohet në shkollë fillore, ndërsa me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 49/2007) e vitit shkollor 2008/2009 edhe arsimi i mesëm është i detyrueshëm dhe falas. Në nenin 347 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve është përcaktuar se puna në Entin Edukues përmirësues organizohet në mënyrë që fëmijës i sigurohen kushte për arsim fillor dhe të mesëm dhe edukim, për marrje dhe zhvillim të shprehive pozitive, të vetive me vlerë dhe për aftësim dhe trajnim për punë në profesione të ndryshme. Në Raport Avokati i Popullit konstaton se në institucion nuk është organizuar shkollim formal i fëmijëve. Gjatë viti shkollor 2017/2018 është realizuar projekt i USAID, nëpërmjet të cilit fëmijët kanë ndjekur program të adaptuar për gjuhë maqedonase dhe matematikë, ndërsa në fund të vitit u është dhënë certifikatë për kurs të kryer. Megjithatë ky projekt nuk mund të përfshihet nën nocionin “shkollim”.

Në bazë të Raportit, për integrimin social dhe risocializimin e fëmijëve është e një rëndësie të veçantë është mbajtja e raporteve personale dhe kontakteve me familjen, të

¹¹⁴ <http://ombudsman.mk/upload/NPM-dokumenti/2019/Posebni%20izvestai/Poseben%20izvestaj%20-VPD%20Tetovo%20i%20Zatvor%20Ohrid.pdf>

afërmit dhe miqtë. Në institucion ka kabinë telefonike, por për përdorimin e të njëjtës, me shpenzime personale duhet të furnizohen me kartelat telefonike, të cilat kohë pas kohe nuk gjenden në shitje, për shkak të së cilës, jo çdoherë mund të realizohet kontakti telefonik. Fëmijët i kanë në dispozicion edhe telefonat zyrtar të edukatorëve, në prezencë të tyre. Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë materiale të familjeve të fëmijëve të cilët e mbajnë masën edukuese në institucion, vizitat e familjarëve dhe kontaktet midis tyre nuk janë të shpeshta. Për këtë Avokati i Popullit konsideron se duhet të njoftohet Qendra për punë sociale dhe në këtë kontekst të shqyrtohet mundësia multisektoriale për ndihmë financiare të familjeve, me qëllim konkret-vizitë dhe mbajtjen e kontakteve me fëmijën i cili e mban masën edukuese, si dhe përkrahje pas daljes së fëmijës nga institucioni për integrimin e suksesshëm të tij në shoqëri.

Sipas nenit 310 të Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, gjatë ekzekutimit të masave edukuese, të vepruarit ndaj fëmijëve duhet të jetë human dhe dinjitoz, t'i përgjigjet moshës, shkallës së zhvillimit psikologjik, dhe të aftësive dhe paradispozitave të fëmijës, tek fëmijët duhet të zhvillohet ndjesia e përgjegjësisë personale dhe të nxiten që edhe vetë të marrin pjesë në edukimin dhe riedukimin personal të tyre. Njëkohësisht, në nenin 15 të ligjit ndalohet secila formë e torturës, trajtimit jonjerëzor, nënçmues dhe ndëshkues, gjatë të cilës duhet të sigurohet e drejta e sigurisë personale e personit të dënuar dhe vetërespektit të personalitetit të tij. Në raport theksohet se mes fëmijëve ka raste të dhunës në formë të përleshjes fizike, ofendime dhe të ngjashme, në raste të tilla ndodh që pjesëtarët e sektorit të sigurimit të përdorin forcë me qëllim që t'i largojnë dhe ndajnë fëmijët e përfshirë në përleshje.

Në pajtim me Udhëzimin për procedurën e evidentimit të shenjave të dhunës në Institucion tek personat e dënuar dhe ata që janë në paraburgim, në rast të regjistrimit të lëndimeve trupore dhe shenjave tjera të dhunës fizike, psikike ose seksuale gjatë mbajtjes së dënimit me burg për fëmijë, të paraqitura nga ana e fëmijës së dënuar ose nga ndonjë person tjetër të njejtat evidentohen në karton shëndetësor. Në karton evidentohet koha kur janë shkaktuar lëndimet, lloji dhe pesha e lëndimeve, për çka mjeku përpilon procesverbal me përshkrim të detajuar të këndimeve dhe mënyrën dhe mjetet me të cilat janë shkaktuar lëndimet, pas çka me informatë me shkrim njoftohet Drejtori i institucionit, me qëllim të ngritjes së procedurës disiplinore ndaj kryesit. Gjatë këqyrjes në evidencës shëndetësore dhe

dokumentacionin e fëmijës, Avokati i popullit ka konstatuar se nuk janë evidentuar të dhëna të tilla.

Sa i përket të drejtës së praktikimit të religjionit, Avokati i popullit konstaton se në institucion nuk ekziston hapësirë e vetë drejtës së praktikimit të religjionit, Avokati i popullit konstaton se në institucion nuk ekziston hapësirë e veçantë për praktikimin e riteve fetare.

Avokati i popullit konstaton se fëmijët nuk janë të informuar me lidhur me mundësitë e mbrojtjes së të drejtave tyre, andaj rekomandon që institucionet të ndërmarrin aktivitete me të cilat fëmijët do të njoftohen dhe informohen, në mënyrë të përshtatshme për moshën e tyre, për mundësinë ku dhe si t'i adresojnë ankesat dhe parashtrësat në rastet kur konsiderojnë se u janë cenuar të drejtat e tyre. Avokati i popullit rekomandon të realizohet këshillim tematik me fëmijët, si dhe t'ju shpërndahen informatat për sistemin e ankesave të cilat i kanë në dispozicion, si ato interne deri te udhëheqësia e institucionit, ashtu edhe ato të jashtme – parashtrësë deri te Avokati i popullit dhe institucionet ndërkombëtare.

Në Analizën e gjendjes me vendosjen e fëmijëve që kanë rënë ndesh me ligjin në Shtëpinë edukuese përmirësuese dhe Burgun për fëmijë në Ohër të Shoqatës maqedonase të penologëve të vitit 2018 ndaj fëmijëve të cilët e mbajnë dënimin me burg për fëmijë, konstatohet se është zbatuar forcë dhe trajtim i papërshtatshëm nga ana e policisë së burgut. Sipas intervistave të zhvilluara me fëmijët është konstatuar se një pjesë e të punësuarve iu kanë dhënë numër të madh të urdhrave ndaj fëmijëve, me çka ju është kufizuar koha e lirë, dhe kanë qenë të detyruar të bëjnë punë të rënda fizike. Gjithashtu fëmijët janë ankuar edhe për kushtet e këqija materiale dhe higjienike të institucionit¹¹⁵.

Në Analizën e Shoqatës maqedonase të penologëve të vitit 2018, nga bisedat e zhvilluara me psikologët e punësuar konstatohet se për riedukimin efikas të fëmijëve, psikologët i shfrytëzojnë metodat në vijim: biseda individuale dhe grupore, këshillim, bindje, intervistë motivuese, shpërblim dhe dënim dhe mjete për psikodiagnostikë. Psikologët e kanë vërtetuar gjendjen e keqe të burgut për fëmijë, i cili e kufizon qasjen e tyre për implementimin e aftësive dhe njohurive të tyre në këtë problematike për dhënien e ndihmës së nevojshme ndaj fëmijëve. Ata janë ankuar se nuk kanë hapësira dhe kapacitete të mjaftueshme për punë,

¹¹⁵ <https://www.msp.mk>

ndërsa kanë vëllim të madh të punës dhe se ju mungojnë mjete financiare për realizimin e trajtimit ndaj fëmijëve. Në bazë të rezultateve të anketës të zhvilluar me psikologët e institucionit konstatohet se sipas tyre ndihma e pamjaftueshme postpenale dhe mungesa e strategjisë për fëmijët të cilët kthehen në bashkësinë shoqërore janë shkaqe për risocializimin e pasuksesshëm të fëmijëve, e njëkohësisht dhe rrezik i madh për recidivizëm.

Nga Raporti për gjendjen e institucioneve ndëshkuese-përmirësuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut i Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të muajit shtator 2019, mund të konstatohet se janë konstatuar gjendjet e njejta siç janë konstatuar në Raportin e Avokatit të Popullit të vitit 2019 dhe Analizën e Shoqatës maqedonase të penologëve të vitit 2018. Si dhe se nga vizita e realizuar në shtator të vitit 2019 në grupet edukuese me fëmijë është rritur numri i fëmijëve në 9, që është në kundërshtim me nenin 341 të Ligjit për zbatimin e sanksioneve penale, i cili përcakton se grupet edukuese mund të përfshijnë nga 5 deri 7 fëmijë.

Konstatime përmbyllëse

Nëpërmjet analizës së të dhënave të Entit shtetëror për statistikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilat kanë të bëjnë me shqiptimin e sanksioneve penale ndaj fëmijëve për periudhën kohore 2009-2018, mund të konstatohet se në sistemin e sanksioneve më së shumti shqiptohen masa/sanksione që nuk përfshijnë heqjen e lirisë (masa edukuese), që korrespondon me qëllimet e Ligjit për drejtësi për fëmijë. Kështu nga numri i përgjithshëm i sanksioneve penale të shqiptuara ndaj fëmijëve në periudhën 2009-2018 nga ana e gjykatave më së shumti janë shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes (përqindja lëviz nga 39% deri 54%), pastaj masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e qendrës për punë sociale (përqindja lëviz nga 25% deri 39%), pastaj masa edukuese qortim (përqindja lëviz nga 10,2% deri 22,7%), masa dërgim në qendër edukuese-përmirësuese (përqindja lëviz nga 0,9% deri 4,9%), masa dërgim në institucion edukues përmirësues (përqindja lëviz nga 0,1% deri 2,4%) dhe dënimi me burg për fëmijë (përqindja lëviz nga 0,3% deri 2,2%)

Masa edukuese dërgim në qendër është shqiptuar vetëm dy herë dhe atë një herë në vitin 2014 dhe një herë në vitin 2016 dhe kjo ka ardhur si rezultat i mosfunksionimit të qendrës pasi që objekti i saj ishte i kapluar nga zjarri dhe jashtë funksionit.

Fakt brengosës paraqet konstatimi se në periudhën e analizuar dhjetëvjeçare 2009-2018 nga ana e gjykatave nuk është shqiptuar asnjë masë e mbikëqyrjes mbrojtëse nga ana e familjes përkujdesëse. Në këtë drejtim paraqitet nevoja që Qendra për punë sociale të ndërmarrë aktivitete për njoftimin e opinionit me formën e vendosjes së fëmijëve në familje përkujdesëse dhe motivimin e familjeve për të aplikuar si kandidat për të realizuar mbikëqyrje të përforcuar.

Shumë zgjidhje ligjore të cilat i ofron Ligji për drejtësi për fëmijë thuajse aspak nuk shfrytëzohen nga ana e gjykatave, siç janë masat alternative.

Nga analiza e numrit të përgjithshëm të sanksioneve penale të shqiptuara nga ana e gjykatave në periudhën 2009-2018 mund të konstatojmë se sanksionet penale më së shumti janë shqiptuar ndaj fëmijëve të grupmoshës 16 deri 18 (përqindja lëviz nga 69% deri 77%), andaj mund të vijmë në përfundim se në aspekt të moshës ata më shpesh paraqiten si kryes më të shpeshtë të veprave penale.

Rol dominant në sferën e ballafaqimit dhe luftimit të delikuencës së të miturve kanë institucionet e zbatimit të sanksioneve penale (shtëpitë edukative-përmirësuese, institucionet ndëshkimore-përmirësuese) dhe administratës publike-ministritë, institucionet e arsimit, shëndetësisë. Këta institucione nga njëra anë ballafaqohen me dobësimin e parimit të solidaritet shoqëror, përgjegjësisë shoqërore të të gjitha subjekteve që kanë të bëjnë me problemet e fëmijëve, e nga ana tjetër ballafaqohen me proceset bashkëkohore të shkatërrimit të familjes tradicionale dhe funksioneve themelore të saj për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Krahas kësaj, duke e realizuar rolin e intervenimit të përforcuar dhe ndërmarrjen e obligimi të shtetit për kujdesin ndaj fëmijës dhe zhvillimit të tyre, ballafaqohen me mungesë të mjeteve buxhetore për financimin e tyre.

Ekzistojnë një sërë mangësish të sistemit institucional të kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijëve-rrjet i institucioneve me kapacitete kadrovike të pamjaftueshme, pajisje materiale dhe profesionale të mangëta, mungesa e koordinimit nëpërmjet institucioneve të cilat funksionojnë nën ministri të ndryshme (Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e shëndetësisë,

Ministria e arsimit dhe shkencës dhe Ministria e drejtësisë), mosekzistimi i kritereve të unifikuara lidhur me punën e tyre, burimet e ndryshme të financimit, mosekzistimi i bazës unike të të dhënave.

Kriza institucionale reflektohet drejtpërdrejtë në gjendjet e institucioneve të drejtësisë për fëmijë-qendrat për punë sociale, institucionet ku zbatohen masat ndaj fëmijëve. Margjinalizimi i këtyre institucioneve shprehet nëpërmjet ndihmës së pamjaftueshme financiare, kuadrit të pamjaftueshëm dhe jo përkatës i cili punon me to, mosekzistimin e mbikëqyrjes dhe koordinimit, mostransparencës, papërgjegjësisë dhe dezavuimin e normave ligjore dhe standardeve ndërkombëtare për drejtësi për fëmijë,

Rekomandime

Duke pasur parasysh të dhënat të cilat u shtjelluan në këtë punim, parashtrohet pyetja nëse dënimi, gjegjësisht masa edukuese e shqiptuar e realizon qëllimin e saj, dhe nëse shteti ka aftësi të përballet me problemin e delikuencës së të miturve.

Edhe pse Ligji për drejtësi për fëmijë është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare në shumë aspekte, identifikohen shumë vështirësi në aspekt të procesit të zbatimit të Ligjit.

Në aspekt të përparimit të sistemit të drejtësisë për fëmijë, nevojitet përmirësimi i kushteve hapësinore për zbatimin e masave institucionale në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Duhet të ndërmerren masa për vënien sa më të shpejtë në funksion të objektit të ri të Shtëpisë edukuese përmirësuese në fshatin Vollkovi të Tetovës, e cila ka ngecur për shkak të mos dhënies së lejes nga ana e Ministrisë së transportit dhe lidhjeve për ujë dhe energji elektrike.

Ministria e Arsimit duhet të ndërmarrë masa që në kohën derisa gjenden në institucione, fëmijët duhet të kyçen në sistemin e rregullt shkollor, por edhe aftësim profesional për punë për të qenë anëtar të dobishëm të komunitetit dhe për këtë t`ju jepen dëftesa dhe çertifikata.

Ministria e shëndetësisë duhet të sigurojë mbrojtje adekuate shëndetësore në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve e cila duhet të jetë efektive dhe

preventive. Në këtë kontekst duhet të organizohen ligjerata dhe lloje të tjera të përmbajtjeve edukative për fëmijët lidhur me rreziqet nga droga, alkooli, sëmundjet infektive dhe ngjashëm.

Duhet të zhvillohet rrjet i Qendrave për fëmijë në nivel rajonal me çka do të nxitet edhe shqiptimi i masës edukuese-dërgim në qendër për fëmijë nga ana e gjykatave.

Të definohen kushtet të cilat duhet t'ia përmbushë familja përkujdesëse për zbatimin e masës edukuese ndaj fëmijëve ndaj të cilit i është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e familjes përkujdesëse, e me çka do të nxitet edhe shqiptimi i saj nga ana e gjykatave.

Nevojitet përforsimi i qasjes multisektoriale (i pranishëm në shume shtete të përparuara), të cilin e realizon ekip i përbërë nga psikologë, pedagogë, punëtor social, defektolog, psikiatër dhe ngjashëm. Përbërja e ekipit duhet të jetë në varësi me nevojat e fëmijës dhe për realizimin më të suksesshëm të planit individual me masa dhe aktivitete. Kuadri i institucioneve ku zbatohen masat edukuese dhe burgu për fëmijë duhet t'i nënshtrohet trajnimeve të vazhdueshme me çka do të përmbushen standardet vendore dhe ndërkombëtare. Numri i pamjaftueshëm i kuadrit profesional nëpër institucionet ku zbatohen masat e enteve dhe dënimi me burg për fëmijë rezulton me trajtim jo të përshtatshëm ndaj fëmijëve dhe mungesën e suksesit në realizimin dhe zbatimin e sanksioneve ndaj fëmijëve.

Institucionet edukuese gjatë krijimit dhe realizimit të planeve individuale për punë me fëmijë duhet t'i përfshijnë edhe prindërit (në rastet kur kjo është e mundur) me qëllim zhvillimin e raporteve më cilësore familjare dhe sanimin e problemeve ekzistuese familjare.

Shteti ynë duhet ta ndjekë shembullin e Kroacisë, Sllovenisë dhe Serbisë ku ekziston program studimor interdisiplinar (profil arsimor) i cili përfshin disa lëndë të drejtësisë, disa lëndë të shkencave mjekësore, lëndë pedagogjike dhe sociologjike me çka do të formohen kuadro cilësore për punë me këtë grup fëmijësh.

Bibliografia:

I

1. Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2008
2. Kambovski, Vllado, E Drejta Penale – Pjesa e Përgjithshme, Shkup, 2006
3. Milutinović, Milan, Kriminologija (6. izd.), Beograd, 1990
4. Nikolić-Ristanović, Vesna; Konstantinović- Vilić Slobodanka, Kriminologija, Beograd, 2018
5. Jašović, Žarko, Kriminologija maloletničke delikvencije, Beograd, 1991
6. Нанев, Лазар, Кошевалиска, Олга, Малолетничко казнено право, Штип, 2018
7. Алексоски, Стеван, Криминологија, Штип, 2009
8. Сулејманов, Зоран, Македонска криминологија, Скопје, 2010
9. Камбовски, Владо: Компаративна анализа на малолетничкото законодавство, Скопје, 2004
10. Камбовски, Владо; Велкова, Татјана, Малолетничка правда, Скопје, 2008
11. Лажетиќ-Бужаровска, Гордана, Овластувањата на центрите за социјална работа и на јавниот обвинител во малолетничката правда, PFZ, 61, (2) 441-468 (2011)
12. Лажетиќ-Бужаровска, Гордана; Нанев, Лазар; Кошевалиска, Олга, Меѓународни документи за спроведување на малолетничката правда, Современи текови во постапувањето со малолетниците, Кавадарци, 2012
13. Институт за социолошки и политичко-правни истражувања, Малолетничкиот криминалитет во транзицијата на Република Македонија, Скопје, 2007
14. Уницеф, Министерство за образование и наука, Образование базирано на правата на детето (УН Конвенција за правата на детето), Скопје
15. Çilingiri Julinda, Vlerësim i faktorëve të rrezikut si parashikues të sjelljeve antisociale dhe delinkuente të të miturve në qarkun e Durrësit, Tiranës, Elbasanit, fq. 20, Tiranë, 2016
16. ЈУ Завод за социјални дејности, Стандарди и процедури за постапување на центрите на социјална работа, Скопје, 2014

17. ЈУ Завод за социјални дејности-Скопје, Извештај за функционирањето и предлози за трансформација на ЈУ за згрижување деца со воспитно-социјални проблеми и нарушено поведење-Скопје, Скопје, 2018
18. Уницеф, Правда за децата-Прирачник, 2010
19. Kultura juridike, doracak i përgatitur nga PH International, në kuadër të Programit për socializim juridik, me mbështetje financiare nga Departamenti Amerikan i Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe shkencës dhe Ministrinë për punë të brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2013

II

1. Convention on the Rights of the Child, UN General Assembly, 20 November 1989
2. UN Standard Minimal Rules for the Administration of Juvenile Justice ("The Beijing Rules"), General Assembly resolution 40/30, 29 November 1985;
3. United Nations Standard Minimum Rules for Non-custodial Measures (The Tokyo Rules), UN General Assembly, 14 December 1990
4. United Nations Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency (The Riyadh Guidelines), UN General Assembly, 14 December 1990
5. United Nations Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty, UN General Assembly, 14 December 1990
6. Council of Europe Recommendation R(87)20 on social reactions to juvenile delinquency, Committee of Ministers, September 1987
7. Council of Europe Recommendation Rec(2003)20 to member state concerning new ways of dealing with juvenile delinquency and the role of juvenile justice, Committee of Ministers, September 2003
8. Council of Europe Recommendation CM/Rec(2008)11 to member states on the European Rules for juvenile offenders subject to sanctions or measures, Committee of Ministers, November 2008

9. Кривичен законик "Службен весник на Република Македонија", бр.37/1996...245/2018)
10. Ligji për të drejtën e të miturve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/2007)
11. Ligji për drejtësi për fëmijë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 148/13...152/19)
12. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 99/19...220/19")
13. Ligji për mbrojtje sociale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.104/19...275/19)
14. Решение за распоредување на осудените, казнетите и малолетните лица во казнено-поправните и воспитно-поправните установи („Службен весник на Република Македонија“ бр. 84/2008).
15. Të dhëna zyrtare nga Enti Shtetëror për statistikë
16. Avokatit të popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Raport i veçantë për konstatimin e gjendjes në Shtëpinë edukuese-përmirësuese Tetovë dhe Burgun për fëmijë Ohër , korrik 2019
17. Македонско пенолошко друштво, Анализа на состојбата во установите за сместување деца во ризик и деца со судир со законот во Република Македонија, Скопје 2018
18. Државен совет за превенција на детското престапништво, Годишен извештај за работата на ДСПДП за 2013 год
19. Државен совет за превенција на детското престапништво, Годишен извештај за работата на ДСПДП за 2014 год
20. Државен совет за превенција на детското престапништво, Годишен извештај за работата на ДСПДП за 2015 год
21. Државен совет за превенција на детското престапништво, Годишен извештај за работата на ДСПДП за 2016 год

22. Државен совет за превенција на детското престапништво, Годишен извештај за работата на ДСПДП за 2017 год
23. Државен совет за превенција на детското престапништво, Годишен извештај за работата на ДСПДП за 2018 год
24. Хелсиншки комитет за човековите права на Република Северна Македонија, Извештај за состојбата и условите во казнено-поправните установи во Република Северна Македонија, септември 2019